

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

Kalendari albanologjik -IV-

(Përmbledhje e aktiviteteve të vitit 2021)



Shkup, 2022

Botues:

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

KALENDARI ALBANOLOGJIK -IV-

(Përmbledhje e aktiviteteve të vitit 2021)

Për botuesin:

Skender ASANI

Përgatiti për botim:

Sevdail DEMIRI

Redaksia:

Zeqirija IBRAHIMI

Sefer TAHIRI

Emin AZEMI

Asistentë:

Sali ISLAMI

Gëzime NAIPI

ISBN: 978-608-4897-50-7

www.itsh.edu.mk

Të drejtat autoriale janë të rezervuara për botuesin

Copyright©ITSHKSH, 2022

Shtypi i këtij botimi financohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV - Shkup



KALENDARI ALBANOLOGJIK – IV –
(Përmbledhje e aktiviteteve të vitit 2021)

P Ë R M B A J T J A

NË VEND TË HYRJES	7
ITSHKSH, INSTITUCION SHKENCOR QË DI MIRËFILLI ÇFARË VEPRON DHE ÇKA SYNON.....	8
KALENDARI I NGJARJEVE	15
Holokausti, u promovua “Fëmijëria e humbur” e Shela Altarac	17
Në Ferizaj u ngrit pllaka përkujtimore në kujtim të Holokaustit.....	20
Tribunë dhe trajnim mbi Holokaustin në Universitetin e Gjakovës	22
Isamet Bakiu, doktor i shkencave humane	24
Viti 2021, do të jetë në shenjë të 100-vjetorit të Hasan Prishtinës – Kryeministër.....	25
Puna e Institutit u promovua në përvjetorin e Besëlidhjes së Lezhës.....	27
Tribunë shkencore për 7 Marsin - arsimi dhe pandemia	29
Promovim libri dhe fidanesh, në kujtim të 7144 hebrenjve nga Maqedonia.....	32
11 marsi 1981, kufiri që ndan inferioritetin nga ndërgjegjësimi kombëtar!	34
U zyrtarizua bashkëpunimi në mes të ITShKSh-së dhe Arkivit të Kosovës	36
U promovua vepra “Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare”	38
Nisën aktivitetet për 100-vjetorin e kryeministrimit të Hasan Prishtinës	40
Jahja Lluka promovoi librin “Kosova nga ‘Naçertanie’ deri te Pavarësia”	42
U inauguruan “Muri i Kujtesës” dhe parku “Hasan Prishtina”	44
Edhe një alumni nga ITShKSh, me mbështetje amerikane	47
Konferenca shkencore “Kënga folklorike – vlerë e trashëgimisë kulturore”	49
Bashkëpunim ndërkombëtar me rastin e 9 majit – Ditës së Evropës.....	51
SHBA vlerëson kontributin e ITShKSh-së në forcimin e lirisë së besimit	53
Aty ku ruhet fryma atdhetare e Hasan Prishtinës	56
Akademi solemne në 109-vjetorin të Kuvendit të Junikut	58
Fatmir Toçi promovoi ‘Ditarin e përballjes me Koronavirusin’	60
ITShKSh me elaborat për shpalljen e Nënës Tereze “Pasuri kombëtare”	62
Konferencë shkencore kushtuar historianit Ramiz Abdyli	65
ITShKSh dhe QSPA nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.....	67
U dhuruan libra nëpër shkolla e biblioteka me emrin e Hasan Prishtinës	69
U prezantuan relikte banimi nga treva e Karadakut të Kumanovës	71
Arkeologu Sali Islami në projektin e Kalasë së Prizrenit	73
Shkupi i adresave të reja shqiptare, në frymën e Marrëveshjes së Ohrit.....	74
U promovua libri “Luboteni 2001” dhe emisioni “Kur Luboteni digjej...”	76
Përvjetori i Çlirimit të Shkupit, kauzat shqiptare – para dhe pas Hasan Prishtinës	78
Me ministrin Mehaj, nderime për Nënë Tereze.....	80
Manifestimi “Drita e Gonxhes”, Shenjtorja jonë nën mbrojtjen e shtetit!.....	81

Kryeministri Kurti, nderime për shenjtoreshën Nëna Tereze	83
Konferencë kushtuar figurës poliedrike të profesor Xhevat Gegës.....	84
U nda nga jeta historiani prof. dr. Naim Halimi	86
Botimet e ITShKSh, në Bibliotekën e Kongresit Amerikan.....	88
ITShKSh, në fokusin e interesimit të Departamentit të Shtetit Amerikan.....	90
Valdeta Kasapi mori titullin doktore e komunikologjisë.....	92
ITShKSh dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, me strategji të re bashkëpunimi.....	94
U promovua romani “Udhëkryqi” i shkrimtarit Ramadan Rexhepi	96
ITShKSh thëllon bashkëpunimin me Aleancën Franceze në Tetovë	98
Vepra e Jusuf Buxhovit sfidon makinerinë e deformimit të historiografisë.....	100
Konsultë në Shkodër - drejt një strategjie të albanologjisë	102
Konferenca “Ballkani midis integritetit evropian dhe bashkëpunimit rajonal”.....	104
Konferencë shkencore kushtuar gjuhëtarit të shquar Qemal Murati	107
Maqedonia e Veriut bëhet anëtare e plotë e IHRA-s, meritore ITShKSh-ja	109
ITShKSh promovon ditarin dyvëllimësh të shkrimtarit Fejzi Bojku.....	111
Tirana, Prishtina dhe Shkupi, drejt një strategjie të përbashkët për albanologjinë.....	113
Manifestimi tradicional “Ditët e Alfabetit”-2021, kushtuar arbëreshëve	115
Letërsia arbëreshe në rrjedhë të shekujve në “Ditët e Alfabetit”	117
Gjuha arbëreshe, dëshmi e mbijetesës në “Ditët e Alfabetit”	119
Françesko Altimari, në fokusin e interesimit shkencor	121
Mateo Mandala, mjeshër i letërsisë dhe i filologjisë arbëreshe.....	123
Profili shkencor e letrar i Anton Nikë Berishës.....	125
Kënga dhe vallja arbëreshe ndër shekuj	127
Në Muzeun e Alfabetit bartet “kauza arbëreshe për shqipen”	129
Ditëlindja e Alfabetit dhe e Institutit në një festë!.....	131
ITShKSh sublimon aktivitetet në festën e Pavarësisë në Vlorë	133
Delegacioni i ITShKSh-së u prit nga kreu i BFI-së.....	135
Drejtori Asani u prit nga ipeshkvi i Kosovës Dodë Gjergji.....	136
Dy promovime në Prishtinë të librit me 200 këngë të Ilir Shaqirit	138
Në Shkup-Prishtinë-Tiranë, 100-vjetori i kryeministrit të Hasan Prishtinës....	140
Ekspozitë dhe 100 libra shqipe të Institutit për Ulqinin	142
U nënshkrua strategjia e re e bashkëpunimit të tri qendrave albanologjike	144
Krishtlindjet kremtohen shqip edhe në Shkup.....	146
Përkujtohet jeta dhe vepra e historianit Naim Halimi	149
BOTIMET E VITIT 2021	151

NË VEND TË HYRJES

Ky është numri i katërt i edicionit të veçantë të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup - “Kalendari albanologjik” (IV).

Duke e vazhduar traditën e mbarë që për çdo vjet të kemi nga një edicion më vete, ku do të paraqesim aktivitetet tona më të rëndësishme kulturore e shkencore të regjistruara dhe të realizuara brenda vitit, në këtë botim gjeni informatorin e aktiviteteve vjetore të ITShKSh-së për vitin 2021.

Fatkeqësisht, edhe viti 2021 kaloi në shenjë të luftës mbarëbotërore me pandeminë e shkaktuar nga virusi Korona. Gjatë këtij viti humbëm edhe një koleg tonin, të nderuarin, historianin Naim Halimi, këshilltar shkencor në ITShKSh. Megjithatë, u desht të vazhdojmë punën tonë, në rrethana specifike, duke realizuar shumë konferenca shkencore, promovime librash, takime pune apo marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shumta në mbarë hapësirën shqiptare.

Rikujtojmë se qëllimi i këtij botimi, është që brenda këtyre kopertinave të memorizohet dhe dokumentohet angazhimi i parezervë i drejtuesve dhe punëtorëve shkencorë e administrativë të Institutit, për të ndriçuar aspekte të reja kulturore e shkencore të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, dhe më gjerë. Në këtë kuptim, ky botim është edhe dokument i llogaridhënies së punës së menaxhmentit dhe punëtorëve të Institutit për vitin 2021.

Viti 2022 qoftë më i mbarë!

Redaksia

Anton Nikë Berisha

ITSHKSH, INSTITUCION SHKENCOR QË DI MIRËFILLI ÇFARË VEPRON DHE ÇKA SYNON



Në shtegtimin e vet shkencor, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup si synim kryesor pati dhe ka punën e mirëfilltë hulumtuese dhe shkencore për ndriçimin e rrjedhave dhe të dukurive që e përcollën dhe e përcjellin botën shqiptare në përgjithësi, me përqendrim të veçantë të rrjedhave të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Mirëpo, duhet thënë, po ashtu, se ky Institut fushëveprimtarinë e vet shkencore e shtrin dhe në hulumtimin dhe vështrimin e dukurive të popujve e të kulturave të tjera që në një mënyrë ose në një tjetër përkohë me dukuritë e botës shqiptare ose e ndihmojnë njohjen e tyre.

Ky përcaktim i Institutit mbështetet në faktin se afrimi i popujve të ndryshëm bëhet më së miri duke i njohur rrjedhat dhe ngjarjet më të rëndësishme që kanë qenë vendimtare dhe e kanë bërë historinë e tyre. Në të vërtetë, njohja e

jetës dhe e historisë së një populli tjetër i hap shteg njohjes së vetë popullit shqiptar dhe anasjelltas: njohja e mirëfilltë, shkencore e botës shqiptare mundëson dhe njohjen më të mirë dhe të botës së popujve të tjerë. Asnjë popull s'ka jetuar i izoluar, vetëm për vete e me veten, por në marrëdhënie me popujt e tjerë.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup me punën e vet hulumtuese, shkencore dhe botuese ka dëshmuar se është i hapur ndaj të gjitha atyre rrjedhave e çështjeve që shkojnë në të mirë të njeriut, kudo qoftë ai dhe kudo që ai jeton dhe vepron, në të mirë të afrimit e të mirëqenies midis popujve dhe kulturave të ndryshme. Politika e lakolizmit, e interesave grupore ose asosh që kanë ngjyrimin e punës ditore ose ngjyrim politik, ka qenë e mbetet e huaj për këtë Institut.

Ajo që në veprimtarinë e këtij institucioni shkencor ngrihet mbi të gjitha, është ndriçimi i së vërtetës kulturore e historike, mbështetur në dokumente e argumente të verifikuara e të besueshme, në të vërtetën që përligjet përmes hulumtimeve dhe argumentimit shkencor, e jo përmes pohimeve e deklaratave. Them kështu për arsye se gjithë puna e Institutit konkretizohet përmes takimeve, konferencave, tribunave të hapura e të organizuara me përkushtim, me pjesëmarrje të bashkëpunëtorëve të brendshëm e të jashtëm si dhe përmes botimeve të ndryshme.

Më duhet të përmend këtu vetëm dy veprimtari të rëndësishme të Institutit: mbajtja e edicionit të dytë të manifestimit kulturor-shkencor "Ditët e Alfabetit", me rastin e 112-vjetorit të Kongresit të Manastirit, të mbajtur në Shkup e të vazhduar në Strumicë, brenda të cilit u bënë shumë takime e aktivitete dhe ku për herë të parë u bënë homazhe tek varri i iluministit Gjerasim Qiriazit si dhe shënimi i përvjetorëve të Nënë tonë Terezë, më 6 gusht dhe më 5 shtator. Instituti është i vetmi institucion që merret denjësisht me ndriçimin e veprës së saj.

Duhet thënë se edhe botimet e bëra gjatë vitit 2020 përlijin mirëfilli përcaktimin dhe veprimtarinë e pasur e për shumëçka të vlefshme. Nëpërmjet këtyre librave shkencorë dëshmohet dija shkencore dhe e vërteta shkencore dhe kjo dije përçohet dhe dhurohet përmes këtyre botimeve.

Edhe hapja ndaj institucioneve të tjera të natyrës hulumtuese shkencore dhe bashkëpunimi me një numër të mirë sosh në Maqedoninë e Veriut ose të shteteve të tjera, sidomos atyre fqinje, po dhe me studiues dhe personalitete të

veçanta, tregon mirëfilli përcaktimin e Institutit që ta lartësojë dhe ta pasurojë veprimtarinë e vet.

Viti 2020, jo vetëm e dëshmoi përsëri përcaktimin e Institutit që gjatë veprimtarisë së tij të hulumtojë e të ndriçojë një varg dukurish të qenësishme, po e pasuroi edhe më tej, duke i hapur shtigje, që mundësojnë veprimtari dhe rezultate edhe më të mëdha.

Është e njohur se idetë e mëdha shpesh ballafaqohen me kundërshtime të natyrave të ndryshme, sidomos nga ata që punët i shohin përmes interesave vetjake ose nuk vërejnë, siç thuhet, përtej hundës së tyre, po ato (idetë e mëdha) krijojnë të tashme dhe hapin udhën për të ecur përpara, për të përparuar. Mbi këtë strategji ngrihet dhe vepron Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Për këtë arsye Instituti s'ka tema të mëdha e të vogla, por ka hulumtim shkencor, ka gjurmim të së vërtetës së argumentuar, pra ndriçim shkencor dhe i çështjeve të ashtuquajtura "të vogla", ku fshihen të vërteta të mëdha e të rëndësishme.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup është shndërruar në një qendër të denjë hulumtuese dhe shkencore për tematika që asnjëherë në të kaluarën nuk janë studiuar në atë përmasë dhe thellësi, duke shërbyer edhe si shembull për institucionet e ngjashme, por duke krijuar dhe traditë. Me pak fjalë, është bërë vatër e fuqishme, ku vëzhgohen edhe me rrjedhat e jetës së përditshme; përfilllet ajo që është përparimtare, e drejtë e denjë, dhe u kundërvihet ideve që zgjojnë tundime, urrejtje dhe synojnë ta t'i ndalin rrjedhat që përlligjin rëndësinë e ndriçimit të së vërtetës, siç ka ngjarë me reagimin kundër gjuhës së urrejtjes ndaj Holokaustit dhe antisemitizmit. Me këtë mënyrë veprimi, Instituti vetvetiu përlligj mbrojtjen e të drejtave dhe të dinjitetit njerëzor, pa marrë parasysh se kjo ka të bëjë me tragjiken e një populli tjetër, në rastin konkret me popullin hebre, që sipas Biblës është popull i zgjedhur i Hyjit.

Duhet përmendur edhe këmbënguljen e organeve të Institutit për mbrojtjen dhe afirmimin e barazisë kulturore e gjuhësore të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, siç ishte rasti me vendosjen e pllakës përkujtimore edhe në gjuhën shqipe për Nënë Terezë në Sheshin e Shkupit.

Se përcaktimi dhe veprimtaria e Institutit ngrihet mbi bazat e përmendura përligjet edhe nga themelimi i dy departamenteve sa të veçanta, aq dhe të rëndësishme: Departamenti për hulumtimin e trashëgimisë shpirtërore të Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze, tashmë e shpallur shenjtëreshë nga Vatikani, dhe i Departamentit për edukimin dhe hulumtimin e Holokaustit, që i kanë dhënë një peshë të veçantë pasurimit të veprimtarisë së këtij Instituti.

Të merresh me trashëgiminë e Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze, të cilën bota e quajti Nënë dhe e shpalli të shenjtë dhe sa ishte gjallë– pikërisht për flijimin e saj për tjetrin, pa bërë dallim besimi, race, krahine, Nëna Tereze gjithë jetën e vet e flijoj për njerëzit e varfër e të braktisur, për ata që shoqëria njerëzore kishte hequr dorë. Këta njerëz ajo i donte me dashurinë e Hyjit. Pra, të bësh të njohur, përmes aktiviteteve dhe botimeve, rëndësinë e veprimit të një personi që jetën e vet e flijoj për tjetrin, domethënë të ngrihesh në rrafshin më të lartë të përkushtimit njerëzor dhe hyjnor.

Edhe hapja e Departamentit për edukimin dhe hulumtimin e Holokaustit, e vë Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup në rrafshin që e synojnë dhe institucionet më të shquara në botë. Po kujtoj këtu vetëm botimet “Manual për mësimdhënien dhe mësimnxënien e Holokaustit” dhe “Legjislacioni bazik antisemitik i Mbretërisë Bullgare” nga autorët Skender Asani, Nora Maliqi-Zylali dhe Vllado Popovski.

Më duhet të përmend se thelbin e punës së Institutit të Shkupit e përbëjnë, pos të tjerash, katër fushëveprimtari të rëndësishme:

1. Puna e mirëfilltë hulumtuese shkencore, që përmbushet përmes projekteve të përbashkëta ose të veçanta,
2. Konferencat, simpoziumet, tribunat e takimet shkencore, që i japin sa një gjallëri aq edhe dëshmojnë lidhshmërinë me kohën në të cilën jetojmë,
3. Botimet shkencore dhe ato të karakterit njohës e informues dhe
4. Bashkëpunimi me institucionet e ngjashme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të shteteve fqinje ose edhe më gjerë, në rrafshin evropian dhe botëror.

Bazuar në konceptin që e përmenda, sa të hapur aq dhe modern, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup do të vazhdojë hulumtimin dhe ndriçimin e çështjeve të historisë e të kulturës së shqiptarëve në përgjithësi, edhe ato bashkëkohore, në mënyrë të veçantë të shqiptarëve të

Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa lënë anash dhe figurat që kanë bërë emër dhe kanë krijuar histori.

Në këtë Institut vetëm një qëllim është i pandryshuar: puna e mirëfilltë shkencore dhe hulumtimi dhe ndriçimi i së vërtetës. Pikërisht për këtë arsye organet përkatëse shtetërore të Maqedonisë së Veriut duhet ta përkrahin dhe ta ndihmojnë veprimtarinë e tij në mënyra të ndryshme. Këtë duhet ta bëjnë sidomos institucionet që e kanë për detyrë ta bëjnë këtë. Me këtë veprim ata mundësojnë dhe nxisin përparimin e shkencës e njehërit edhe mirëkuptimin midis njerëzve, kulturave dhe popujve, dhe i japin jetë të mirëfilltë bashkëveprimit dhe bashkëjetesës në vend.

Për punën e mirëfilltë dhe për qëndrimin e denjë të këtij Instituti dëshmojnë edhe mirënjohtët e bëra nga institucionet, personat dhe organet, qoftë të Republikën e Maqedonisë së Veriut, qoftë të shteteve të tjera. Po përmend këtu vetëm Departamentin e Shtetit Amerikan. Në raportin ndërkombëtar për liritë fetare, për vitin 2019 në Maqedoninë e Veriut, përmendët dhe ndihmesa e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Të njëjtën gjë e dëshmon dhe përkrahja dhe bashkëpunimi me ambasadorin e Izraelit në Maqedoninë e Veriut, Dan Oryan.

Duke pasur parasysh atë që thash më lart dhe të arriturat e deritanishme, mund të them me bindje se Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, ka krijuar një bazë e përvojë të mirëfilltë për ta vazhduar e pasuruar veprimtarinë hulumtuese e shkencore dhe të jetë edhe më tej një vatër dhe një pikë referimi e pikësynimeve dhe e shtegtit drejt përparimit të jetës së njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe të përfshihet më me lehtësi në rrjedhat e qytetërimit evropian dhe më gjerë.

Më duket me vend që ta mbyll këtë qasje timen për ndriçimin e përcaktimit e të konceptit të veprimit hulumtues e shkencor të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup me fjalët e drejtorit të saj, dr. Skender Asanit, të thëna në simpoziumin me rastin e shënimit të 552-vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar – Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, të organizuar nga Kolegji ILIRIA në Prishtinë me temën: “Skënderbeu në dokumente të panjohura arkivore të vendeve të huaja”: “Shqiptarëve u duhet sot një Skënderbe i Rilindjes Kombëtare, një Skënderbe që i bashkon shqiptarët, që i rrafshon dallimet krahinore e fisnore, një Skënderbe që i shkrin përkatësitë religjioze dhe një Skënderbe që nuk na përplas me asnjë

komb tjetër. Në këtë kontekst, Skënderbeu i flet edhe Ballkanit, duke bërë ftesë për paqe dhe bashkëjetesë mes popujve, ndërsa po ky Skënderbe i flet dhe Evropës së shqiptarët, por edhe të tjerët në këtë rajon, do të duhet t'i kthehen origjinës së tyre të qytetërimit Perëndimor”.

(Fjalë rasti në promovimin e veprimtarisë kërkimore, shkencore dhe botuese të ITShKSh - Shkup, më 2 mars 2021)

KALENDARI I NGJARJEVE

Holokausti, u promovua “Fëmijëria e humbur” e Shela Altarac



Shkup – Më 26 janar 2021 u promovua libri “Familja Altarac, FËMIJËRIA E HUMBUR, Rrëfim mbi jetën dhe mbijetesën”, botim i ITShKSh - Shkup në bashkëpunim me Shoqatën “Acta Non Verba”, në vigjilje të 27 janarit, Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Holokaustit.

Drejtori Skender Asani tha se ITShKSh tashmë ka projektuar një strategji mbi Holokaustin dhe në kuadër të kësaj strategjie është edhe publikimi i dëshmimeve dhe evokimeve të të mbijetuarve dhe të atyre që kanë ndihmuar hebrenjtë të shpëtojnë nga kthetrat e vdekjes.

“Familja Altarac, FËMIJËRIA E HUMBUR, Rrëfim mbi jetën dhe mbijetesën” është përmbledhje përjetimesh, i shkruar në formë evokimesh. Në qendër të rrëfimit të këtij libri ndodhet Shela, e lindur si Rashela Cion, rreth vitit 1934, në Shtip. Ajo përshkruan me nota të ngrohta jetën e saj fëmijërore në një familje tradicionale dhe të pasur. Mirëpo kjo ngrohtësi familjare prishet në

mëngjesin e 11 marsit 1943, kur ushtarët gjermanë dhe ata bullgarë, nisin aksionin famëkeq për grumbullimin e hebrenjve të Shtipit... Mirëpo këtu ndodhë edhe ndarja e familjes së Shelës, pasi që ajo me të motrën e saj Bela, arrijnë të kapërcejnë telat e kampit dhe të fshihen diku në afërsi, prej nga kanë parë skenat e trishtimit se si hebrenjtë e kampit, duke përfshirë dhe anëtarët e familjes së tyre, janë hipur e ngarkuar në vagonë mallrash, për t'i dërguar në kampin famëkeq Treblinka në Poloni”, u shpreh drejtori Asani.

Sipas tij, ky libër kujtimesh kap një hark të gjatë ngjarjesh dramatike, duke filluar nga Shtipi dhe duke përfunduar në Jerusalem, ku Shela bashkë me bashkëshortin Braco kishin krijuar familje, tre fëmijë dhe 10 nipër e mbesa. Historia e Shelës si një fëmijë i braktisur, që vjen në këtë libër, e cila i kishte humbur gjithë anëtarët e familjes së saj, dhe e ngelur e vetme gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, deri në emigrimin e saj në Izrael, është testament i gjallë i një kujtese njerëzore që na bën më të ndërgjegjshëm për pasojat e ngjarjeve tragjike në jetën e njerëzve.

Zëvendëskryeministri i Parë i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, u shpreh se dinjiteti njerëzor i hebrenjve u shkel në mënyrë më ç'njerëzore nga ana e nazistëve në llogoret e vdekjes. “Gjëja më e mirë është që të marrim mësim nga e kaluara dhe që ato vuajtje të mos përsëriten më kurrë. Shpreh respektin e thellë për ata njerëz trima që rrezikuan jetën e tyre për të shpëtuar jetën e tjerëve. Ngjarjet e tilla si kjo e sotmja janë mundësi që ne ta kuptojmë se humanizmi është një nga trashëgimitë tona më të vyera”, tha Zëvendëskryeministri Grubi.

Përmes një video-mesazhi të shkurtër dhe shumë emocionues, u drejtua edhe vetë Rashela Altarac, e cila në moshë të shtyrë jeton në Izrael. Ajo bëri falënderimet e veçanta ndaj drejtorit Asani dhe hulumtueses shkencore Maja Susha, për kontributin e dhënë në zbardhjen e historisë së saj të dhimbshme familjare.

Ambasadori i Izraelit në Shkup, Dan Oryan, po ashtu përmes një video-mesazhi, u falënderua për këtë kontribut të Institutit dhe ‘Acta Non Verba’, si një rast i shkëlqyer për të kujtuar të gjitha viktimat e Holokaustit. Ndërsa, zëvendësambasadori i Gjermanisë në Shkup, Otto Graf, tha se është posaçërisht e rëndësishme që këto ngjarje të përcillen tek gjeneratat e reja, në mënyrë që e kaluara kurrë më të mos përsëritet.

Aktivitetin e përshëndeti përfaqësuesi i Ambasadës amerikane në Shkup, Andrew Moffat, si edhe përfaqësuesi i Komunitetit Hebre të Kosovës, Flori Dedeni. Ndërsa, fare në fund asistentja hulumtuese e Institutit, Maja Susha, foli për historinë e dhimbshme të familjes Altarac dhe projeksionet e së ardhmes të Departamentit për edukimin dhe hulumtimin e Holokaustit, që kanë të bëjnë me zbardhjen e të vërtetave të reja të shpëtimit të hebrenjve nga këto troje gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në Ferizaj u ngrit pllaka përkujtimore në kujtim të Holokaustit



Ferizaj – Më 27 janar 2021, në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, në stacionin hekurudhor në Ferizaj, u ngrit pllaka përkujtimore si shenjë kujtimi për hebrenjtë të cilët nga aty kishin përfunduar nëpër kampet e vdekjes, por edhe për shumë të mbijetuar tjerë falë dorës së ngrohtë shqiptare në momentet më të vështira në pranverën e vitit 1943.

Pllaka përkujtimore u shpalos nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, drejtori i ITSHKSH-së Skender Asani, dhe kryetari i Bashkësisë Hebraike “Bet Izrael Kosova” Ruzhdi Shkodra.

Me këtë rast, drejtori i Institutit, Skender Asani, si njëri nga nismëtarët për vendosjen e kësaj pllake, tha se “sot në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Holokaustit, ndodhemi në Ferizaj, para kësaj pllake e cila nuk është thjesht një objekt i ngurtë, por mbi të gjitha është pjesë organike e kujtesës sonë mbi një të kaluar të hidhur të popullit hebre, i cili pati fatin e keq

të sprovohet me murtajën vdekjeprurëse të holokaustit. Vendndodhja e kësaj pllake na kujton ditët kur ky stacion hekurudhor ishte bërë dëshmia më rrëqethëse e deportimit të hebrenjve”.

Asani më tej shtroi se “Mbi binarët e këtij stacioni ishin derdhur lot pikëllimi e trishtimi nga ata që po ndaheshin prej të afërmve të tyre. Shqiptarët vajtonin familjarët e tyre që po degdiseshin shkretëtirave të Anadollit, kurse hebrenjtë po i fiksonin në kujtesë fytyrat e të afërmve që nuk i panë më asnjëherë. Duke qenë koshient për pasojat që sjell robëria dhe dhuna, shqiptarët më mirë se kushdo tjetër i kishin kuptuar vuajtjet e hebrenjve, prandaj kishte edhe jo pak zyrtarë shqiptarë në administratën fashiste italiane këtu në Ferizaj e gjetiu, që ndihmonin hebrenjtë të dalin nga burgjet dhe të kalojnë në zonat e sigurta, siç ndodhi me Kamhi Ergas – Faraxhi, e cila gjeti strehim në Shkodër”, u shpreh ai.

Dy vjet më parë, kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, priti në një takim vajzën e familjes hebreje, Ita (Drita) Bartuv, familje kjo e cila falë ndihmës dhe sakrificës së ofruar nga shqiptarët arriti të shpëtoj nga depërtimi në kampin famëkeq Aushvic. Ita Bartuv, mysafire e Institutit, ishte tepër e emocionuar, duke kujtuar rrëfimet që i kishte dëgjuar nga e ëma, Mimi Kamhi Ergas-Faraxhi, për ndihmesën dhe përkrahjen që u kishin dhënë popullata shqiptare.

Në vitin 2017, ITShKSh-ja Shkup botoi librin memoaristik të Kamhi Ergas – Faraxhi “Udhëtimi”, ku tregon të gjitha vuajtjet e saj që nga Shkupi, Ferizaj e deri në Shkodër, ku kishte shpëtuar familja Faraxhi nga ndjekja naziste.

Tribunë dhe trajnim mbi Holokaustin në Universitetin e Gjakovës



Gjakovë – Më 28 janar, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë u mbajt një tribunë shkencore dhe një trajnim me studentët dhe stafin akademik të këtij universiteti. Këto aktivitete u organizuan në kuadër të bashkëpunimit në mes të ITShKSh-së në Shkup, Universitetit “Fehmi Agani” si dhe “Kosovo Jewish Organization”, ku në qendër të vëmendjes ishte Holokausti dhe trajtimi i tij në aspektin mësimor e metodik. Me këtë rast u organizua edhe trajnimi që u udhëhoq nga Maja Susha, bashkëpunëtore shkencore e Departamentit për hulumtimin dhe edukimin e Holokaustit pranë ITSHKSH-së.

Mikpritës i këtyre aktiviteteve ishte rektori Artan Nimani, i cili në fjalën e tij të rastit falënderoi ITSHKSH-në në Shkup dhe drejtorin Asani, për gatishmërinë e ofrimit të përvojës dhe të bashkëpunimi sa i përket edukimit dhe mësimin të Holokaustit. Rektori Nimani shprehu interesim që kjo problematikë të përfshihet në kurrikulat e Universitetit “Fehmi Agani”, kurse në të ardhmen në

bashkëpunim me ITSHKSH-në do të vazhdojnë trajnimet mbi trajtimin e temave të Holokaustit.

Tribuna shkencore si figurë qendrore pati albanologun austriak me prejardhje hebraike Norbert Jokli.


Studiuesi Anton Nikë Berisha vuri në dukje se studimet e Joklit në albanistikë kanë peshë të shumëfishtë, qoftë ato në fushën e fonetikës historike, të përcaktimit të kronologjive të ndryshimeve fonetike të mundshme, në studimet e morfologjisë historike, në historinë e fjalëve, në etimologji, qoftë përgjithësisht, në fushën e historisë së gjuhës. Duke iu referuar kujtimeve të Stevan Zweigut, prof. Berisha nënvizoi se pa asnjë dyshim Jokli është një nga emrat më të shquar në gjuhësi, sidomos në fushën e albanologjisë, të këtij qarku krijuesish të mëdhenj hebrejsh.

Mbi kontributin e shqiptarëve në shpëtimin e hebrenjve, përfshi edhe albanologun Norbert Jokli, foli drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, sipas të cilit përpjekjet e shqiptarëve në Shkup gjatë Luftës së Dytë Botërore në shpëtimin e hebrenjve përkojnë me angazhimet e intelektualëve të shquar shqiptarë si Ernest Koliqi, Gjergj Fishta, Eqrem Çabej, LasgushPoradeci etj., të cilët u përpoqën në forma të ndryshme për mbrojtjen e Joklit, një nga albanologët më të shquar, krahas Hanit, Meyerit, Pedersenit. Jokli u ndoq dhe u persekutua për shkak të origjinës së tij hebraike. “Sa i përket angazhimit të shkrimtarëve dhe intelektualëve shqiptarë për t’i dalë në ndihmë gjuhëtarit të famshëm, të rrezikuar, Norbert Joklit, po përmend një letër të Gjergj Fishtës drejtuar Jakomonit, përmes së cilës mësojmë se Shqipëria ishte vërtet vendi që u tregua i gatshëm ta strehonte, por Jokli kërkonte të nisej për Amerikë. Letra drejtuar Jakomonit është e datës 23 shtator 1939”, tha Asani.

Ky aktivitet u ndoq edhe nga disa përfaqësues të jetës publike të Gjakovës, si dhe drejtues të universiteteve në Pejë dhe Mitrovicë. Në mesin e të pranishmëve pati edhe nga stafi ambasadës bullgare në Prishtinë.

Në mbyllje të aktivitetit u dorëzuan edhe disa certifikata për ndjekësit e trajnimit mbi mësimin dhe edukimin e Holokaustin, kurse të pranishmit patën rastin të shohin edhe një ekspozitë autentike me fotografi nga trashëgimia materiale e kulturore e hebrenjve në Kosovë.

Isamet Baku, doktor i shkencave humane



Shkup – Më 1 shkurt, asistenti hulumtues i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Isamet Baku, në Institutin e Historisë Nacionale – Shkup, mbrojti disertacionin e doktoraturës në temën “Udro Uilson dhe e drejta e vetëvendosjes të popujve të vegjël, me vështrim të posaçëm tek shqiptarët dhe maqedonasit”.

Baku doktoraturën e punoi nën mentorimin e profesorit Marjan Dimitrijevski, ndërsa mbrojtja e doktoraturës u mbajt në formatin online, për shkak të masave kundër virusit Covid-19, para komisionit në përbërje: Gabriela Topuzovska, kryetare e komisionit dhe anëtarët Aleksandar Simonovski, Marjan Ivanovski, Vera Gosheva dhe Marjan Dimitrijevski.

Kandidati në hulumtimin e tij shkencor disavjeçar nëpër arkiva të ndryshme, ka trajtuar rolin historik të presidentit të 28-të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Vudro Villson (1856 – 1924), sa i përket realizimit të një të drejte themelore njerëzore të popujve, siç është ajo e vetëvendosjes.

Dr. Isamet Baku, është i punësuar në ITShKSh, përkatësisht në Departamentin e Lidhjeve të ndërsjella gjuhësore, historike dhe kulturore midis popullit maqedonas dhe shqiptar, si dhe popujve tjerë në rajon.

Viti 2021, do të jetë në shenjë të 100-vjetorit të Hasan Prishtinës - Kryeministër



Prishtinë – Më 9 shkurt në Prishtinë u formua Këshilli organizativ për shënimin e 100-vjetorit të ardhjes së Hasan Prishtinës në krye të Qeverisë shqiptare në Tiranë. Bartës i këtij manifestimi do të jetë ITShKSh-ja në Shkup, në bashkëkoordinim me Shoqatën për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta, dhe nga familja e Hasan Prishtinës, përfaqësuar nga Mehmet Prishtina.

Për profilin politik, institucional e patriotik të Hasan Prishtinës si kryeministër do të organizohen konferenca, akademi, promovime librash në Prishtinë, Shkup, Tiranë, Vushtri, Junik, Polac, Bllacë, me ç'rast figura eminente nga jeta publike dhe studiues të shquar vendor dhe ndërkombëtar do të shpalosin detaje të panjohura nga jeta dhe vepra e Hasan Prishtinës.

Të gjitha këto aktivitete do të fillojnë në prill dhe do të përfundojnë me një akademi shkencore në dhjetor të këtij viti.

Sikundër dihet, Qeverisa e Hasan Prishtinës (7 dhjetor 1921), përbëhej nga emrat më të çmuar që kishte politika shqiptare e asaj kohe: Hasan Prishtina – Kryeministër, Luigj Gurakuqi – ministër i Punëve të Brendshme, Fan Noli – ministër i Punëve të Jashtme, Zija Dibra – ministër i Luftës, Ahmet Dakli – ministër i Financave, Hoxhë Kadri Prishtina – ministër i Drejtësisë, Haki Tefiku – ministër i Punëve Botore, Kristo Dako – ministër i Arsimit.

Për fat të keq kjo qeveri pati një jetë shumë të shkurtër sepse menjëher pas emërimit të kësaj përbërje, autoritetet sllave e kundërshtuan fuqishëm dhe përmes bashkëpunësorëve shqiptar filluan një fushatë të egër të ndjekjes dhe shantazhit ndaj Kryeministrit Hasan Prishtina dhe ministrave të tij. Në ndërkohë qarqet sllave përkrahnin dhe shtyenin agjendat për formimin e një qeverie me udhëheqës Ahmet Zogun, andaj për të shmangur një vëllavrasje midis shqiptarëve, Kryeministri Hasan Prishtina, dha dorëheqje vetëm pesë ditë pas marrjes së detyrës si Kryeministër.

Puna e Institutit u promovua në përvjetorin e Besëlidhjes së Lezhës



Shkup – Më 2 mars 2021, në shenjë të përkujtimit të 577-vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës, si njëri nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë tonë, me Skënderbeun si kryeprijës, u promovua veprimtaria e bujshme hulumtuese-shkencore dhe botuese e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup për vitin 2020, me ç’rast në mënyrë të veçantë u fol rreth librit të autorit Bajram Kosumi: “Letërsia nga burgu”.

Me këtë rast, drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, tha se zhvillimi i ideve dhe projekteve nga ana e hulumtuesve tanë shkencorë ka pasur si pikësynim ngritjen e vëmendjes publike në nivelet e duhura të formimit të mendimit kritik për tema të caktuara. “Duke e pasur për objektiv këtë pikësynim, Instituti ynë ka hapur me sukses tema me interes shoqëror, dhe ka trajtuar guximshëm çështje që në të kaluarën kanë vuajtur nga stereotipet e caktuara”, tha Asani. Më tej ai shtoi se “nëse i hedhim një sy raportit në mes të vëllimit dhe cilësisë së punëve që kemi bërë si Institut dhe fondeve financiare që ndahen, do të shohim një shpërputhje të theksuar në dëm të projekteve e

aktiviteteve hulumtuese-shkencore. Me shpresë se politika financiare dedikuar fushëveprimit shkencor në të ardhmen do të ketë një trajtim më dinjitoz, dua të shprehi publikisht gatishmërinë time si drejtues i këtij Instituti që veprimtaria shkencore e hulumtuese do të jetë edhe më mobilizuese dhe më kreative, duke arsyetuar, fundja edhe objektivin madhor për të cilin ekziston ky Institut”, u shpreh Asani.

Me një fjalë rasti përshëndeti edhe drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, Ylber Sela. Ndërsa, me praninë e tyre aktivitetin e sotëm e nderuan zëvendëskryeministri i parë dhe njëherësh ministër i Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, Artan Grubi, ambasadori i Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj, pastaj profesorë, studiues, drejtorë, etj.

Një emër i njohur i letrave shqipe që vjen nga Kosova, Anton Nikë Berisha, në cilësinë e promotorit të veprimtarisë së përgjithshme hulumtuese-shkencore dhe botuese të ITSHKSH-së gjatë vitit 2020, tha se “Instituti është shndërruar në një qendër të denjë hulumtuese dhe shkencore për tematika që asnjëherë nuk janë studiuar në atë përmasë dhe thellësi, duke shërbyer edhe si shembull për institucionet e ngjashme, por duke krijuar dhe traditë”. Sipas Berishës, edhe botimet e bëra gjatë vitit 2020 përligjin mirëfilli përcaktimin dhe veprimtarinë e pasur e për shumëçka të vlefshme. “Nëpërmjet këtyre librave shkencorë dëshmohet dija shkencore dhe e vërteta shkencore dhe kjo dije përçohet dhe dhurohet përmes këtyre botimeve”, tha ai.

Gjatë vitit 2020, në mesin e 20 botimeve të reja nga shumë fusha shkencore, Instituti në Shkup, nxori edhe librin e autorit Bajram Kosumi me titull “Letërsia nga burgu – kapitull më vete në letërsinë shqipe”. Libri në fjalë është mirëpritur nga publiku dhe kritika shkencore, prandaj për të dhanë vlerësimet e tyre recensentët Emin Azemi dhe Bashkim Musliu. Më tutje, auditorit iu drejtua edhe autori i librit në fjalë, studiuesi dhe veprimtari Bajram Kosumi, njëherësh rektor i Universitetit “Kadri Zaka” të Gjilanit, i cili theksoi përkushtimin në përpilimin e këtij libri, i cili përmban disa specifika të veçanta në mënyrën e trajtimit të lëndës dhe autorëve që janë objekt studimi.

Sekretari shkencor i Institutit, Sefer Tahiri, paraqiti një pasqyrë të plotë për gjithë veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe botuese të Institutit gjatë vitit 2020. Ndërsa, një letërnjoftim po ashtu i rëndësishëm dhe argumentues i punës njëvjeçare, dhe njëkohësisht një lloj llogaridhënie e punës së këtij institucioni, gjendet në botimin e ri të veçantë “Kalendari albanologjik” nr. 3.

Tribunë shkencore për 7 Marsin - arsimi dhe pandemia



Shkup – Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, më 7 mars 2021, përmes një tribune shkencore shënoi 134-vjetorin e Ditës së Arsimit Shqip. Aktiviteti në fjalë u organizua sipas masave shtrënguese për parandalimin e përhapjes së Virusit COVID 19, ndërsa tema e tribunesë së këtij viti ishte në përputhje të plotë me situatën e krijuar.

Edhe pse arsimi është një veprimtari e gjerë e cila ndërthret në veten e saj shumë problematika dhe çështje me interes të gjerë publik, këtë vit, sikurse tha koordinatori për organizimin e tribunesë, Laura Papraniku Bejtullau, ka qenë e pamundur të shmanget diskutimi rreth Pandemisë, respektivisht impaktit që ka pasur dhe vazhdon të ketë edhe sot e kësaj dite në sferën e arsimit. Duke iu referuar peshës historike që ka shkolla e Korçës, e themeluar

më 7 mars të vitit 1887, Bejtullau e cilësoi atë “margaritar të çmuar në gjerdanin e vlerave historike që kanë prodhuar ndër shekuj shqiptarët”, ndërsa organizmin e aktiviteteve që përkujtojnë ngjarje të këtilla si “pjesë të detyrimit dhe punës për rruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë sonë kulturore”.

ITShKSh-ja, sikurse tha drejtori Skender Asani, “jo vetëm që është e vendosur të kontribuojë në zhvillimin e debatit shkencor për të gjitha ngjarjet dhe personalitetet që me madhësinë e tyre i kanë vënë vulën historisë dhe kulturës shqiptare, por do të shfrytëzojë të gjitha kapacitetet intelektuale dhe shkencore për ti promovuar ato vlera edhe në rrafshin ndërkombëtar”. Historia e shkollave shqipe, plotësoj më tej drejtori Asani, është një faqe e ndritur që na bën krenarë të gjithëve, prandaj e kemi për nder të organizojmë aktivitete si kjo tribunë e 7 marsit, e cila tanimë po kthehet në aktivitet tradicional të Institutit. “Siç ndodh rëndomë, nga fatkeqësitë e mëdha të nxirren mësimet tepër të vlefshme, edhe në rastin e kësaj pandemie nuk duhet të mungojnë përpjekjet për të kërkuar ‘fat në fatkeqësi’, pra për të nxjerrë platforma dhe strategji të reja, të cilat do të ndryshojnë platformat e deritanishme konvencionale. Pandemia, erdhi si një goditje e fuqishme për këndelljen e sistemit tonë arsimor, i cili e kishte thuar se të pa mundur të ndryshojë filozofinë e konceptimit edhe pse dekada me radhë në qarqet akademike diskutohen problemet dhe defektet e njëjta”, nënvizoi ai.

Ekspertët e arsimit, Xheladin Murati dhe Avzi Mustafa, dhanë vështrimet analitike për ndikimet që ka Pandemia në “jetën shkollore” të gjithë aktorëve të sistemit arsimor. “Pandemia Covid-19 bëri që arsimiti të nënshtrohet një kaosi të madh të dijes e të organizimit të shkollës. Një nga arsyet kryesore e këtij kaosi dhe kësaj krize është edhe mungesa e një strategjie korrekte për qasjen ndaj virusit dhe për organizimin e shkollës. Mësimi on-line mund të jetë një formë shumë e mirë për sistemin e arsimit universitar. Përmes platformave të këtilla mund dhe duhet të organizohet mësimi nëpër universitete, por kur behet fjalë për arsimim parauniversitar, pra për shkollat fillore dhe të mesme, gjërat ndryshojnë, sepse nuk kemi as kushtet dhe as mundësitë që të pajisim nxënësit me dijet, kompetencat dhe shkathtësitë të cilat përfitohen në shkollë”, vërejtje prof. dr. Murati. Ndërkaq, prof.dr. Mustafa tha se “situata me Pandeminë përkeqësoi dhe thelloi ende me shumë problemet në sistemin tonë arsimor, sepse ishim të pa përgatitur për të përshtatur procesin mësimor nga format konvencionale në format e mësimimit përmes teknologjisë informatike”.

Me mjaft interes ishte edhe paraqitja e Lulzim Mehmetit, ligjërues në Universitetin e Tetovës, i cili iu referua sfidave për organizimin dhe menaxhimin e mësimit të arsimit parauniversitar. “51.4% e mësimeve të përgatitura për mësime në distancë, 33.7% përgatitën plotësisht, ndërsa nuk përgatitën vetëm 9.8% e tyre”. Kjo, sikurse plotësoi ai, nënkupton se arsimit parauniversitar e gjeti RMV-në të përgatitur. Më tej, ligjëruesja e shkencave sociale në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, Elisabeta Bajrami Ollogu u ndal në përvojat dhe praktikat e mësimit online në arsimit universitar. Përvojat e përfituara sipas saj, mund të shërbejnë si bazament i shëndoshë për krijimin e modeleve alternative për të ardhmen, ndërsa mësimi online tha se nuk duhet parë vetëm me ngjyrat “bardh e zi”, aq më tepër kur bota po mbështet çdo ditë e më shumë tendenca që mësimi online të shërbejë si model për organizimin e arsimit të lartë.

Të gjitha analizat dhe paraqitjet e tribunës së dytë shkencore dedikuar 7 marsit, me temën “Arsimi dhe pandemia”, ITShKSh-ja pritet t’i botojë në një edicion të veçantë.

Promovim libri dhe fidanesh, në kujtim të 7144 hebrenjve nga Maqedonia



Shkup – Përvjetorin e 78-të të deportimit të hebrenjve të Maqedonisë për në Treblinka, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve më 10 mars 2021 e shënoi me dy aktivitete. Së pari, në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, u promovua librin tri gjuhësh “Legjislacioni bazik antisemitik i Mbretërisë Bullgare”, nga autorët Vllado Popovski, Skender Asani dhe Nora Maliqi Zylali.

Promotori i veprës, akademik Vllado Kambovski, bëri një prezantim të zgjeruar të veprës në fjalë me dokumente, e cila sipas tij, e plotëson shkencën historiografike në dritën e dokumenteve të reja të hulumtuara dhe sistemuara nga ana e punëtorëve shkencorë të ITSHKSH-së. Këtë vepër ai e cilësoi edhe si

një homazh për të gjitha viktimat e Holokaustit dhe mirënjohje për ata që ndihmuan në shpëtimin e hebrenjve të këtushëm.

Skender Asani, drejtor i Institutit dhe njëri nga autorët e veprës, tha se “Legjislacioni bazik antisemitik i Mbretërisë Bullgare” është vepër unike e këtij karakteri në rajonin tonë dhe më gjerë, për arsye se për herë të parë merret me interpretimin studimor të legjislacionit të një shteti të ççantë, siç ishte Mbretëria Bullgare, për dalim nga ligjet e Nyrnbergut të cilët kishin karakter të përgjithshëm që sanksiononin kryerësit e krimeve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

“ITShKSh përmes veprave të tilla synon të konsolidojë mendimin kritik – shkencor mbi proceset e ndërlikuara historike të së kaluarës, duke duke promovuar dioptrinë objektive e të paanshme në tabllonë komplekse të së kaluarës. Ky është edhe një nga objektivat shkencore e hulumtuese në kuadër të Departamentit për Studimin dhe Edukimin e Holokaustit, i pari i këtij lloji në rajon, që funksionon në kuadër të Institutit tonë”, u shpreh Asani.

Rreth librit në fjalë foli edhe bashkautori Vllado Popovski, i cili bëri një vështrim më të zgjeruar të lëndës, duke potencuar se Mbretëria e Bullgarisë së asaj kohe, aksionin e asgjësimit të hebrenjve e kishte ndërmarrë me vetëiniciativë dhe pa presione nga ana e Gjermanisë fashiste, meqë nga kjo e fundit priste benefite tjera.

Për veprën folën edhe recensentët Ylber Sela dhe Maja Susa, të cilët e theksuan rëndësinë e këtij botimi tregjuhësh, i cili është një ndihmesë e madhe për qartësimin e të vërtetave historike.

Ngjarja tjetër u zhvillua në oborrin e Institutit, ku u mbollën disa fidane, në kuadër të projektit “Fidanë përkujtimi”, në kujtim të 7144 jetëve të humbura të hebrenjve të Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilët përfunduan në kampin Treblinka. Në këtë aktivitet u bashkëngjit edhe zëvendëskryeminstri i parë i Qeverisë së Maqedonisë, Artan Grubi. Iniciativa vjen nga Ministria e Punëve të Jashtme e Izraelit, e cila në vendin tonë realizohet në bashkëpunim me Institutin dhe organizatën civile “Acta non verba”.

11 marsi 1981, kufiri që ndan inferioritetin nga ndërgjegjësimi kombëtar!



Shkup - Drejtori i ITShKSh-së në Shkup, Skender Asani, më 11 mars 2021 pati një fjalë rasti në solemnitetin me titull *“Pranvera e dinjitetit 1981”*

Sipas tij, demonstratat studentore që ndodhën para plot 40 viteve, konkretisht më 11 mars të vitit 1981 hapën një proces të pandalshëm në zhvillimin e betejave vetëdijësuese politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Këto ngjarje epiqendrën e patën në Kosovë, por ato e zgjeruan ndikimin e tyre edhe në hapësirat tjera shqiptare në ish –Jugosllavi.

“Viti 1981 përpos që shënon fillimin e një epoke të re në vetëdijësimin kombëtar të shqiptarëve, ai shënon edhe kufirin në mësy mentaliteteve politike të asaj kohe: në njërën anë kishim mendësinë burokratike të politikanëve të etabluar në sistemin ish-Jugosllav që angazhoheshin për njëfarë status-quoje, të cilët kundërshtonin çfarëdo lloj ndyrshimi dhe, në anën tjetër kemi rininë studentore të prirë nga një shtresë revolucionarësh politikë që ishin kalitur në ilegalitet, të cilët më vonë do të bëhen edhe bartës të proceseve të rëndësishme, që u kurorëzuan me kryengritjen e armatosur, fillimisht në Kosovë, dhe pastaj në Maqedini dhe në Luginë të Preshevës.

Pëpjeket e shqiptarëve për liri e pavarësi nuk kanë pushuar asnjëherë, prandaj edhe politikat hegjemoniste të fqinjëve tanë ishin të orientuara drejt ngulfatjes së këtyre përpjekjeve. Shikuar historikisht, ballafaqimi i shqiptarëve me fqinjët grabitqarë ka ndodhur në ato momente kur thyheshin shtizat e gjeopolitikës ballkanike, duke filluar që nga Beteja e Kumanovës e tetorit të vitit 1912, e cila shënon ngritjen e hegjemonisë serbe në kufinj të vizatuar në hartën e re ekspansioniste, ku trojet shqiptare iu nënshtruan një ripushtimi arbitrar pas ikjes së forcave osmane nga kjo pjesë e Ballkanit”, u shpreh Asani.

Sipas tij, gjenerata të tëra shqiptarësh u rritën duke rezistuar dhe kundërshtuar këta kufinj arbitrarë, prandaj ne sot kujtojmë vitin 1981, i cili erdhi si rrjedhojë e këtyre aspiratave kombëtare të shqiptarëve, kurse Kumanova sërish u rikthye si nocion gjeopolitik në vitin 1999, por me një simbolikë tjetër, sepse aty u gjuhëzua ajo krijesë që ishte ngritur padrejtësisht mbi tokat shqiptare.

Asani tha se 40-vjetori i demonstratave të 81-shit, sivjet përkon edhe me një iniciativë të Qytetit të Shkupit, që tashmë është shëndërruar në vendim, për riemërtimin e rrugëve dhe bulevradeve, me ç’rast një nga rrugët e kryeqyteti do të mbajë emrin “11 Marsi”, si datë që memoron lavdinë dhe krenarinë tonë, dhe në këtë mënyrë po e institucionalizojmë kujtesën historike, jo thjeshtë si një material arkivor, por më tepër si motivim për ide e punë produktive që do të jenë në interes të gjeneratave që do të vinë pas nesh.

U zyrtarizua bashkëpunimi në mes të ITShKSh-së dhe Arkivit të Kosovës



Prishtinë – Më 23 mars u nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi në mes të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Me këtë rast nga ana e të dy institucioneve u shpreh gatishmëria për të hapur shtigje të reja hulumtimi shkencor mbi bazën e bashkëpunimit reciprok, duke i përdorur njohuritë dhe resurset që posedojnë këto dy institucione të rëndësishme.

“Ne i jemi mirënjohës Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe drejtorit Bedri Zyberajt që po i hap sirtarët e vet për hulumtuesit tanë shkencorë, duke ofruar një mbështetje konkrete në begatimin dhe avancimin e njohurive tona mbi bazën e një opusi të pasur arkivor që posedon ky institucion. ITSHKSH edhe këtë vit do të shënojë një ngritje substanciale në pasurimin e veprimtarisë hulumtuese, duke shfrytëzuar edhe dokumentet që posedojnë

arkivat e Kosovës, të cilat do të përplotësojnë kriteret bazike të argumentimit shkencor. Bashkëpunimi në mes nesh nuk ka munguar edhe në të kaluarën, por tash e tutje ai po vendoset mbi disa binarë të mirëfilltë të këmbimit të njohurive e përvojave, kurse për neve si ITSHKSH kjo është e mirëseardhur për arsye se vjen si mbështetje direkte në punën tonë hulumtuese-shkencore edhe për projektet të cilat ne presim t'i realizojmë në të ardhmen, siç janë Historia e shqiptarëve të Maqedonisë, Fjalori enciklopedik mbi shqiptarët në Maqedoni, Monografia mbi Shkupin etj. Presim që këto dhe projekte të tjera të jenë pjesë e studimeve dhe kërkimeve tona mbi ndriçimin e traditës materiale e shpirtërore iliro- arbërore-dardane në trevat tona, duke pasur si pikënisje argumentimin shkencor që do të na ofrojë opusi arkivor i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës”, tha drejtori i ITShKSh-së, Dr. Skender Asani.

Aktiviteti i mësipërm u zhvillua në kuadër të shënimit të 70 vjetorit të themelimit të Arkivit të Kosovës, me ç'rast u hap edhe ekspozita „70 Vjet Arkiv“, si pjesë e Javës së Arkivave të Hapura (sot: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës), si dhe u promovua libri „Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare“, përkthyer dhe përgatitur nga Dr. Hatixhe Ahmedi. Ky libër së shpejti do të promovohet edhe në ITSHKSH në Shkup.

Të pranishëm në këtë eveniment ishin përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, përfaqësues të Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësues të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore.

Aktivitetet me një fjalë rasti i hapi drejtori i AShAK-së Bedri Zyberaj, i cili falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre.

U promovua vepra “Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare”



Shkup – Në kuadër të bashkëpunimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh) me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK), më 5 prill u promovua vepra “Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare” e autorit Tahir Sezen, e përkthyer dhe përgatitur për botim në gjuhën shqipe nga Hatixhe Ahmedi.

Drejtori i Institutit Skender Asani, tha se pa një hulumtim të mirëfilltë të periudhës pesëshekullore të Perandorisë Osmane, dhe sidomos të marrëdhënieve të shqiptarëve me osmanët, nuk do të mund të shkruhet historia e shqiptarëve. Andaj kjo vepër është e një rëndësie të veçantë për historiografinë tonë. Në këtë mënyrë ne po shënojmë edhe punën e Departamentit të Studimeve Shqiptaro-Osmane në Institutin tonë, dhe njëherazi po shprehim në

vepër bashkëpunimin me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, u shpreh Asani.

Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Bedri Zyberaj, tha se ndjehet i gëzuar që këtë vepër po promovohet në një nga qendrat e vilajeteve shqiptare, përkatësisht në Shkupin e Vilajetit të Kosovës. Sipas tij, vepra në fjalë është e një rëndësie të veçantë, e cila hedh dritë mbi të kaluarën tonë historike, konkretisht mbi emërvendet e vilajeteve shqiptare që ishin në kuadër të Perandorisë Osmane, dhe në këtë aspekt paraqet një vepër me interes të veçantë për të sotmen dhe të ardhmen tonë.

Më pas, pikëpamjet e tyre rreth veprës “Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare”, i paraqitën dy studiues të kësaj fushe shkencore, Sadik Memeti nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Murtezan Idrizi nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Ata iu qasën në mënyrë koncize strukturës së kësaj vepre, si dhe rëndësisë që ka ajo për fusha të reja të studimit të kësaj periudhe historike, për të cilët ka edhe shumë hapësirë që të hulumtohet e studiohet nga specialistët e kësaj disipline shkencore.

Në fund të promovimit, Hatixhe Ahmedi, përkthyesë dhe përgatitëse e veprës, falënderoi Arkivin dhe Institutin për mundësinë e promovimit në Shkup, si dhe të gjithë ata që kishin kontribuar në forma të ndryshme, që kjo vepër të botohet sa më e kompletuar.

Ky aktivitet u zhvillua për nder të 70-vjetorit të themelimit të Arkivit të Kosovës, me të cilin kohë më parë ITSHKSH-ja nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi, për fusha me interes të përbashkët.

Nisën aktivitetet për 100-vjetorin e kryeministrit të Hasan Prishtinës



Polac – Më 7 prill 2021, në Polac të Drenicës filluan aktivitetet për shënimin e 100-vjetorit të Hasan Prishtinës – Kryeministër i Shqipërisë.

Me këtë rast, drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, bashkë me kreun e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, si dhe me Jahja Llukën, Mehmet Prishtinën dhe përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta, nderuam të rënë për liri me homazhe dhe lule të freskëta.

“Ky ishte një rast i mirë të përkujtojmë të gjithë dëshmoret e luftërave tona për liri, komandantët legjendarë Adem Jashari, Shaban Polluzha, dhe sidomos figurën emblematike të Hasan Prishtinës, i cili vazhdon të jetë burim frymëzimi për gjeneratat në përpjekjet për shtetndërtim dhe status dinjitoz të shqiptarëve kudo që janë. Shihemi në Bllacë, më 10 prill, ku do të përurojmë “Murin e Kujtesës” dhe Parkun “Hasan Prishtina”! Lavdi të rënëve për liri!”, ka shkruar Asani.

Në dhjetor të këtij viti bëhen 100 vjet nga zgjedhja e Hasan Prishtinës për Kryeministër të Shqipërisë, me ç'rast do të organizohen disa aktivitete shkencore dhe botuese.

Jahja Lluka promovoi librin “Kosova nga ‘Naçertanie’ deri te Pavarësia”



Shkup – Në kujtim të vuajtjeve të shqiptarëve të dëbuar nga vatrat e tyre nga regjimet serbe, më 9 prill në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, u promovua libri faktografik “Kosova nga ‘Naçertanie’ deri te pavarësia (1844–2008)” i autorit Jahja Lluka.

Drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, theksoi se Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Trojet e Veta, të cilën e drejton Jahja Lluka, është një shembull shumë i mirë i bashkëpunimit institucional, për të bërë aktivitete me peshë kombëtare, siç janë hulumtimet, botimet apo edhe projektet konkrete, siç është Qendra Përkujtimore “Bllaca ‘99”. Duke folur për librin, Asani tha se “përderisa fqinjët tanë historikisht kanë projektuar elaborate antishqiptare dhe antinjerëzore me përmasa gjenocidale, shqiptarët gjithmonë kanë qenë në pozita mbrojtëse në trojet e veta, dhe fatmirësisht

kanë arritur të mbijetojnë deri në ditët e sotme, meqë kanë qenë në anën e drejtë”.

Rreth rëndësisë së librit me referate u paraqitën studiuesit Zeqirija Ibrahimimi dhe Sevdail Demiri, sipas të cilëve, “Serbia pushtuese, qëllimin kryesor për të krijuar Serbinë e Madhe, përmes daljes në Detin Adriatik, synonte ta realizonte pikërisht përmes zhbërjes së shqiptarëve nga trojet e veta. Këtyre veprimeve antinjerëzore i kishin paraprirë programe dhe elaborate të shumta shtetërore që vinin nga majat e politikës dhe akademive serbe, e që në mënyrë mjaft korekte janë pasqyruar në këtë botim”.

Autori i librit “Kosova nga Naçertania deri te Pavarësia (1844–2008)”, Jahja Lluka, foli për programet dhe elaboratet e shumta serbe dhe antishqiptare, të cilat për bazë e kishin Naçertanien e Garashaninit. Ai falënderoi Institutin dhe drejtorin Asani, për bashkëpunimin e sinqertë, veçanërisht në projektin për ngritjen e Qendrës Përkujtimore të Bllacës '99, e cila do të inaugurohet ditën e nesërme.

Libri faktografik “Kosova nga Naçertania deri te Pavarësia (1844–2008)” nga Jahja Lluka, është përkthyer edhe në gjuhën angleze, dhe deri më tani është shpërndarë nëpër shumë përfaqësi diplomatike, për të dalë në shesh e vërteta për shqiptarët dhe Kosovën.

U inauguruan “Muri i Kujtesës” dhe parku “Hasan Prishtina”



Bllacë – Më 10 prill në brezin ndërkufitar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, Në Bllacë - aty ku para 22 viteve kishte ndodhur dëbimi masiv i mbi 400 mijë kosovarëve si pasojë e veprimeve gjenocidale të forcave pushtuese serbe, u inaugurua Muri i Kujtesës (vepër autoriale e piktorëve Festim Kabashi dhe Luan Tashi), dhe parku “Hasan Prishtina” në kuadër të Qendrës Përkujtimore “Bllaca ‘99”.

Jahja Lluka, kryetar i Shoqatës për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur, njëri prej organizatorëve të kësaj ngjarjeje, tha se para 22 viteve Millosheviqi me bandën e tij u përpoq të pastrojë Kosovën nga shqiptarët, por ishte UÇK e ndihmuar nga NATO që pengun këtë plan fashist. Kriza humanitare që u shkaktua në Kosovë ndikoi që bashkësia ndërkombëtare të ndërtojë në

krye me NATO-n, duke shpëtuar një popull të tërë nga shfarnosja. Sipas tij, “dëbimi i mbi 440 mijë shqiptarëve në drejtim të Maqedonisë, kishte ndikuar që në “Bllacë të ngrihen kampe të përkohshme për shpëtim, kurse vuajtjet e shqiptarëve të dëbuar më së miri janë shprehur në mozaikun që sot po promovojmë, ku në qendër të tij ndodhet nëna shqiptare, simboli i përtëritjes së popullit shqiptar, e cila me qumështin e saj mbajti gjallë atë”, tha Lluka.

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, u shpreh i kënaqur që pikërisht në territorin e komunës së tij po inaugurohet Muri i Kujtesës dhe parku “Hasan Prishtina”, duke theksuar se kjo është mirënia më e mirë për të gjithë ata që kontribuuan në menaxhimin krizave humanitare dhe në çlirimin përfundimtar të Kosovës, pa harruar UÇK-në, NATO-n dhe popullatën civile, bashkë me shoqatat humanitare nga Maqedonia që ndihmuan në strehimin dhe sistemimin e të dëbuarve.

Ndëkaq Skender Asani drejtor i ITSHKSH në Shkup, vuri në dukje se para 22 viteve, pikërisht këtu ku ndodhemi sot, gjeopolitika po shkruante një kapitull të ri në ribërjen e hartës së Ballkanit. Në vend të përrallave të vjetra sllave që kishin përvetësuar sallonet diplomatike të Evropës së shekullit 19, pikërisht këtu në Bllacë komuniteti ndërkombëtar, i udhëhequr nga SHBA, NATO dhe BE, po rivendoste për herë të parë një drejtësi të munguar në favor të shqiptarëve. “Lufta heroike e UÇK-së, e udhëhequr nga bijtë dhe bijat më të zgjedhor të kombit, projektoi në vëmendjen diplomatike e ushtarake ndërkombëtare nevojën për të ndërhy në një territor të pushtuar arbitrarisht nga forcat pushtuese serbe. Më 24 mars të vitit 1999, NATO filloi të veprojë nga ajri, duke hedhur bomba mbi objektet vitale ushtarake e shtetërore të Serbisë, si pika problematike prej ku buronte fuqia pushtuese e hegjemoniste serbe. Muri i Kujtesës dhe Parku Hasan Prishtina, tash e tutje i shërbejnë kujtesës sonë, jo vetëm për të freskuar të kaluarën, por për të mësuar edhe hapat nga duhet të shkojmë në të ardhmen”, nënvizoi Asani.

Për të evokuar disa momente dhe ngjarje nga to ditë të vështira të pranverës së vitit 1999, foli edhe Agron Dida i cili përshkoi në detaje atmosferën rrëqethëse nëpër rrugët e Prishtinës si dhe udhëtimin e gjatë e të mundimshëm të të dëbuarve deri në kampin e Bllacës. Ai shprehu mirënjohje për mikërpitjen e ngrohtë e vëllazërore të shqiptarëve të Maqedonisë që treguan ndaj të dëbuarve nga Kosova.

Me një fjalë rasti u paraqit edhe studiuesi Mehmet Prishtina, i cili tha se kjo Qendër përkujtimore ngërthen në vete semantikën e vuajtjeve të shqiptarëve si pasojë e dëbimeve dhe veprimeve gjenocidale të pushtuesve grabitqarë.

Në mesin e të pranishmëve ndodhej edhe protagonistja e portretit që është gdhendur në mozaikun e Murit të Kujtesës, Sherife Luta, bashkë me vajzën e saj Besianën. Në fund u ndanë mirënjohje për të gjithë kontribuesit e kësaj qendre përkujtimore.

Edhe një alumni nga ITShKSh, me mbështetje amerikane



Shkup – Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve i shtohet edhe një alumni nga Programi ndërkombëtar për Leadership i Departamentit të shtetit amerikan.

Blerta Zeqiri, punonjëse e ITShKSh-së, nga 5-30 prill 2021, ndoqi Projektin rajonal për Evropën me titull “Ballafaqimi me Shtrembërimin dhe Mohimin e Holokaustit”, financuar nga Departamenti amerikan i shtetit dhe administruar nga World Learning.

Fushëveprimi i këtij projekti kishte një dedikim specifik tematik, në të cilin u trajtuan çështje me interes, siç janë: Diskutimi për hapjen e burimeve arkivore dhe programet muzeve në mënyrë që të rritet qasja publike; Eksplorimi i përdorimit të mjeteve multimediale, mbledhja e tregimeve të mbijetuarve dhe dëshmitarëve me qëllim që të paraqitet historia e saktë e Holokaustit në mënyrë që të luftohet antisemitizmi në botën modern; Strategjia e komunikimit

dhe arsimit e cila duhet përdorur për të nxitur njohuritë e publikut për saktësinë e historisë së Holokaustit dhe të njohin e të përballen me shtrembërimin dhe mohimin e Holokaustit, etj.

E veçanta e këtij projekti ishte përfshirja e zyrtarëve të lartë amerikanë në trajtimin e temës së Holokaustit nga Zyra e të Dërguarit special të çështjeve të Holokaustit në Departamentin e Shtetit si dhe nga Zyrës e të Dërguarit special për monitorimin dhe Luftimin e Antisemitizmit, siç janë: Ambasadori Philip T. Reeker, ambasadorja Michaela Küchler, Dr. Yehuda Bauer, kryetar nderi i Aleancës Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit IHRA, Irene Weiss, një e mbijetuar e kampit nazist të Auschwitz, Dr. Robert Williams, zëvendës drejtor për Programet Ndërkombëtare në Muzeun Memorial të Holokaustit të SHBA-së, ambasadori i Izraelit në SHBA Gilad Erdan, senatorët amerikanë Jacky Rosen dhe James Lankford, si dhe sekretari shtetëror i SHBA-ve Antony Blinken.

Me qëllim të trajtimit sa më profesional të kësaj teme, një ndihmesë të pakursyer dhanë edhe: U.S. Holocaust Memorial Museum (Muzeu Memorial i Holokaustit në SHBA) me seli në Uashington, në bashkëpunim me muzetë dhe institutet e shteteve tjera të SHBA-ve siç janë Muzeu i Trashëgimisë Hebraike në Nju Jork, Muzeu Maltz i Trashëgimisë Hebraike & Holokaustit në Ohajo si dhe USC Shoah Foundation Institute Los Angeles, CA.

Një kontribut të jashtëzakonshëm në mbarëvajtjen e Projektit rajonal për Evropën – “Ballafaqimi me Shtrembërimin dhe Mohimin e Holokaustit”, kanë dhënë edhe znj. Cherrie Daniels, e Dërguara speciale për Çështjet e Holokaustit, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve si dhe z. Mark Weitzman – drejtor në Qendrën Simon Wiesenthal dhe anëtar i delegacioni zyrtar amerikan në IHRA.

Pjesëmarrja e Blerta Zeqirit në këtë projekt të rëndësishëm vjen si nevojë e profesionalizimit të trajtimit në nivel botëror të çështjes së Holokaustit nga ana e studiuesve dhe hulumtuesve të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në kuadër të të cilit funksionon edhe Departamenti për studimin dhe edukimin e Holokaustit.

Konferenca shkencore “Kënga folklorike - vlerë e trashëgimisë kulturore”



Shkup – Në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, më 6 maj u mbajt konferenca shkencore me temën boshte “Kënga folklorike – vlerë e trashëgimisë kulturore” në kuadër të aktivitetit të përvitshëm “Java e Trashëgimisë Kulturore”. Në këtë konferencë morën pjesë studiues nga hapësira të ndryshme gjeografike shqiptare dhe studiues nga ITShKSh, Universiteti i Tetovës dhe institucione të tjera të rëndësishme.

Drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe kulturore të Shqiptarëve-Shkup, Skender Asani, në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh se “Qëllimi i kësaj konference është ruajtja, mbrojtja, kultivimi, por edhe promovimi dhe afirmimi i vlerave muzikore, sidomos folklorit shqiptar në kohën kur përballet me armikun më të madh për asimilim, që është globalizimi, e jo shtetet fqinje”. Asani u shpreh se në kuadër të Departamentit të Folklorit dhe Etnologjisë do

të ketë prurje të reja nga fusha e etnomuzikologjisë, të cilët do të mund të mbledhin materialin folklorik në krahina të ndryshme dhe i cili më pas do të interpretohet dhe analizohet nga studiuesit e fushës.

Pas fjalëve të drejtorit filloi sesioni shkencor, të cilën e drejtoi Sefer Tahiri, i cili është njëkohësisht edhe koordinator i kësaj konference shkencore.

Studiuesja nga Universiteti i Tetovës, Besiana Mehmeti, në punimin e saj analizoi këngët autentike të cilët në një farë mënyre arkivojnë të kaluarën historike të popullit shqiptar në përgjithësi por dhe rajoneve të caktuara në veçanti. Ajo u fokusua edhe tek kontributi e heronjëve historik për të cilët jehon kënga. Pasi Ragip Gjoshi nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", i cili nëpërmjet të punimit të tij pasqyroi këngët historike si dhe këngëtarët të cilët e përçuan këtë porosi nga të parët për ndërgjegjësimin e popullit shqiptar nëpërmjet kushtimit të këngëve. Etnologu nga ITSHKSH, Rini Useini përshkroi disa këngë, të cilët e veçojnë individin apo familjen dhe statusin e saj ekonomik gjatë ceremonialit të dasmës, nëpërmjet këngëve të dasmës, të cilët përmbajnë ironi, sarkazëm apo metafora, por dhe hiperbollizime. Më pas Krenar Doli nga Instituti Albanologjik i Prishtinës foli për disa këngë rituale në trevën e Gjakovës. Jesir Hoxha nga Shkolla e Mesme e Mjekësisë nëpërmjet qasjes analitike dhe teorike i përshkroi këngët e rajonit të Dërvenit, kurse Bekim Ramadani nga Universiteti i Tetovës, i vuri në dukje këngët, të cilët pasqyrojnë veprimtarinë e SHKA Xheladin Zeqiri nga Tetova. Shkëlzen Baftjari, profesor i pianos u paraqit me temën "Folklori në veprat pianistike të kompozitorëve shqiptarë", punim i përgatitur në bashkëpunim me Besiana Mehmedin. Agona Çupi, poashtu nga Universiteti i Tetovës u paraqit me temën "Ndikimi i muzikës folklorike në veprat korale të Lorenc Antonit". Arijana Kuriu Grubi prezantoi punimin me temë "Muzika shkodrane në fund të shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX". Ndërsa Besnik Rahmeti nga ITShKSh-ja me temën "Analiza e këngëve popullore dhe lirike në veprat dhe hulumtimet e Dr.Ibrahim Krosit".

Në fund Ardian Ramadani nga ITShKSh-ja bëri një krahasim ndërmjet folklorit francez dhe shqiptar me temën "Këngët dhe vallet e rajonit të Bretanjes në Francë dhe krahasimi i tyre me këngët shqipe".

Punimet e prezantuara shkencore do të botohen në numrin e rradhës të revistës shkencore "SCUPI".

Bashkëpunim ndërkombëtar me rastin e 9 majit - Ditës së Evropës



Shkup – Departamenti për Hulumtimin dhe Edukimin për Holokaustin pranë ITShKSh-së Shkup dhe ekspertja në studimet e Holokaustit - Klodeta Cane, e diplomuar në Programin Ndërkombëtar të Masterit Weiss-Livnat në Studimet e Holokaustit në Universitetin Haifa, filloi takimin e parë për Bashkëpunimin Arsimor Ndërkombëtar Izraelito-Maqedonas me rastin e 9 majit – Ditës së Fitores mbi Fashizmin dhe Ditën e Evropës.

Gjatë takimit online të mbajtur pikërisht më 9 maj, Skender Asani, drejtori i Institutit, prezantoi arritjet e deritanishme në edukimin mbi Holokaustit, duke iu referuar posaçërisht botimeve të ITShKSh-së.

Në bisedë me ekspertin Cane, u shqyrtuan gjithashtu mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe projekteve si afatshkurtra dhe afatgjata që mund të zbatohen së bashku në të ardhmen e afërt.

Programi Ndërkombëtar Weiss-Livnat në Studimet e Holokaustit ka dëshmuar arritje profesionale në krijimin dhe edukimin e një brezi të ri të studiuesve dhe edukatorëve të Holokaustit. Ne u njohëm me punën e tyre dhe gëzuam mbështetjen e tyre për arritjet tona.

U diskutuan gjithashtu hapat e ardhshëm të nënshkrimit të një Memorandumi të Mirëkuptimit të përbashkët që hap rrugën për bashkëpunimin midis dy institucioneve tona arsimore.

SHBA vlerëson kontributin e ITShKSh-së në forcimin e lirisë së besimit



U.S. DEPARTMENT *of* STATE



2020 Report on International Religious Freedom

Shkup – Departamenti Amerikan i Shtetit të mërkurën më 14 maj 2021, publikoi raportin e tij vjetor mbi gjendjen e lirisë së besimit në botë, që përfshinë të dhëna për gjendjen e lirisë së besimit në 200 shtetet e territore dhe dokumenton shkeljet e kryera nga qeveritë, grupet terroriste dhe individët. Aty analizohet në kapituj të veçantë edhe gjendje e lirisë së besimit edhe në Maqedoninë e Veriut.

Duke iu referuar Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut, Raporti vë në dukje se ajo ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon lirinë e fesë dhe shprehjen fetare. Kushtetuta iu jep barazi para ligjit të gjithë individëve, pavarësisht nga besimi fetar dhe përmend pesë komunitete fetare: Kisha Ortodokse Maqedonase, Komuniteti Fetar Islam në Maqedoninë e Veriut (IRC), Kisha Katolike, Kisha Metodiste Ungjillore dhe Komuniteti Hebre, të cilat janë të liruar nga taksat, ndërkohë që grupet e tjera fetare duhet të regjistrohen për të marrë të

njëjtat përfitime. Në Raport nënvizohet edhe fryma e bashkëpunimit në mes të Ambasadës amerikane dhe institucioneve të shtetit.

Raporti i Departamentit të Shtetit mbi Lirinë Fetare në Botë për vitin 2020 në fokus të interesimit ka edhe problematikat që lidhen mbi mësimin dhe edukimin e Holokaustit, duke theksuar me këtë rast se më 10 mars, qeveria miratoi përkufizimin e punës së IHRA 2013 mbi mohimin dhe shtrembërimin e Holokaustit dhe ngarkoi Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITSH) të përkthejnë, brenda tre muajsh, Rekomandimet e IHRA të Dhjetorit 2019 për Mësimdhënien dhe Mësimin e Holokaustit në gjuhët maqedonase, shqipe, turke dhe serbe për t'u shpërndarë në shkollat në të gjithë vendin.

Ky rekomandim i Qeverisë u përfshi edhe në strategjinë e punës së Departamentit për mësimin dhe edukimin e Holokaustit pranë ITSHKSH-së, me ç'rast në një afat rekord u përgatitën Rekomandimet e IHRA të Dhjetorit 2019 për Mësimdhënien dhe Mësimin e Holokaustit në gjuhët maqedonase, shqipe, turke dhe serbe.

Krahas trajnimeve për arsimtarë dhe edukatorë në bashkëpunim me Jad Vashem nga Izraeli, Departamenti e përpilon e dhe Strategjinë për edukimin mbi holokaustin në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kontributin e ekspertëve, edukatorëve dhe institucione botërore me renome të cilat e trajtojnë këtë tematikë.

Raporti gjithashtu potencon se në muajin qershor, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve filloi një kurs trajnimi katër-ditor në internet mbi edukimin dhe mësimin e Holokaustit për 45 mësues të shkollës fillore dhe të mesme nga i gjithë vendi, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punëve të Jashtme të Izraelit dhe Yad Vashem – Qendra Botërore e Përkujtimit të Holokaustit në Jerusalem. Raporti përmend edhe ish ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, i cili ka folur për rëndësinë e partneritetit mbi mësimin dhe edukimin e Holokaustit në Ballkan, sipas të cili kjo ngjarje ishte pjesë e strategjisë për të përfshirë edukimin e Holokaustit brenda sistemit zyrtar arsimor shtetëror dhe sigurimin e mjeteve për ta zbatuar atë.

Drejtori i ITShKSh-së, prof.dr. Skender Asani, shprehet i kënaqur me vlerësimin që jepet në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit mbi Lirinë

Fetare në Botë për vitin 2020, duke shtuar se ITShKSh-ja tashmë po afishohet edhe ndërkombëtarisht si një pikë referimi dhe orientimi për mënyrën e menaxhimit të resurseve humane e shkencore në projektet konkrete që mundësojnë një bashkëjetesë komode të përkatësive e afiniteteve fetare, kulturore e etno-psikologjike në Maqedoninë e Veriut.

Aty ku ruhet fryma atdhetare e Hasan Prishtinës



Shkup / Drenicë – Në kuadër të shënimit të 100 vjetorit të ardhjes së Hasan Prishtinës në krye të Qeverisë së Shqipërisë (dhjetor 1921), u zhvilluan disa aktivitete që ndërlihdeshin me veprimtarinë politike e atdhetare të këtij kolosi të kombit.

Një delegacion i kombinuar veprimtarësh e studiuesish, më 20 maj 2021 zbriti në Drenicë, Vushtrri, Skenderaj, Galicë e Boletin, për të vizituar kullat legjendare, të cilat kishin qenë pararojë e zhvillimeve dramatike kombëtare në fillim të shekullit të kaluar.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, fillimisht ishte nikoqir i aktiviteteve të sotme, i cili ndër të tjera vuri theksin tek rëndësia e familjeve atdhetare të cilat kishin ndikuar në ruajtjen e traditave patriotike të popullit tonë. Ai apeloj që në vigjilje të këtyre aktiviteteve që organizohen për nder të Hasan Prishtinës, të ruhet fryma e bashkëpunimit dhe unitetit brendashqiptar.

Në emër të familjeve patriotike, një fjalë rasti mbajti studiuesi Mehmet Prishtina, i cili tha se e gjithë vëmendja këtyre ditëve është përqendruar në shënimin e 100 vjetorit të Hasan Prishtinës-kryeministër i Shqipërisë, që do të përmbillet me një konferencë ndërkombëtare shkencore kushtuar Hasan Prishtinës, duke veçuar me këtë rast edhe aktivitetet e sotme që do të zhvillohen në Drenicë dhe Boletin, me vizitat e kullave të Isa Boletinit, Ahmet Delisë, Tahir Mehës dhe kompleksi memorial 'Adem Jashari' në Prekaz.

Drejtori i ITSHKSH-së, prof. dr. Skender Asani foli për rëndësinë historike të këtyre aktiviteve që si strumbullar kanë figurën madhore kombëtare të Hasan Prishtinës. Ai fillimisht foli për sakrificën sublime të familjes Jashari, e cila paraqet modelin më të përkryer të përkushtimit atdhetar ndaj çështjes kombëtare.

Dr. Asani i njoftoi të pranishmit me idenë e ITSHKSH-së që ky vit të jetë në shenjë të Hasan Prishtinës, me rastin e 100 vjetorit të ardhjes së tij në krye të Qeverisë Shqiptare. Ai tha se jo rastësisht Hasan Prishtina doli në skenë në periudhën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, atëherë kur Aleanca Balknaike donte ta zhbënte nga faqja e dheut elementin shqiptar. Prandaj, jo rastësisht, tha ai, Hasan Prishtinës i ngeli barra të përballet me këto furtuna që solli koha, duke e orientuar popullin shqiptar politikisht, diplomatikisht por edhe duke rrokur armët për të mbrojtur interesat shqiptare.

Dr. Asani tha se Hasan Prishtina pas takimit të famshëm në Taksim të Stambollit, kthehet në Kosovë dhe del në ballë të kryengritjeve shqiptare, duke organizuar edhe Kuvendin e Junikut, si pikënisje e një rrugëtimi të rëndësishëm historik që bënë shqiptarët për të krijuar shtetin e tyre kombëtar. Ishte e domosdoshme arritja e unitetit kombëtar, tha dr. Asani, prandaj Hasan Prishtina me bashkëveprimtarët e tij vizitoi kullat e lavdishme në Drenicë dhe në Boletin, disa prej atyre familjeve ndodhen edhe në këtë sallë, në mënyrë që të arrihet një pajtueshmëri në shkallë kombëtare mbi zhvillimet e bujshme që do të pasojnë.

Akademi solemne në 109-vjetorin të Kuvendit të Junikut



Junik – Më 21 maj 2021, në Junik të Kosovës, me një akademi solemne u përkujtua 109-vjetori i mbajtjes së Kuvendit të Junikut, që konsiderohet njëra nga ngjarjet kryesore që i parapriu Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë të vitit 1912.

Këtë solemnitet e nderuan me fjalë rasti: kryetarja e Kosovës Vjosa Osmani, zëvendëskryeministrja Donika Gërvalla, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, pjesëtarët e familjeve atdhetare që projektuan Pavarësinë e Shqipërisë me në krye Mehmet Prishtina, nikoqir kryetari i Komunës së Junikut Agron Kuçi, etj.

Fjalë rasti pati edhe drejtori i ITShKSh-së në Shkup, Skender Asani, i cili theksoi se ajo çka duhet të nxjerrim si mësim nga mesazhi dhe fuqia ndikuese e Kuvendit të Junikut në përshejtimin e proceseve historike në fillim të shekullit 20-të, është aftësia për t'i shndërruar ngjarjet tona të mëdha kombëtare në fermentuese të ideve të reja, si nga politikanët, ashtu edhe nga studiuesit.

“Kuvendi i Junikut para 109 viteve mblodhi shqiptarët e të gjitha viseve, pa dallim feje, ideologjie apo krahine dhe ky është mesazhi tjetër që mund t’i shërbejë politikës aktuale shqiptare që ta nxjerr politikbërjen nga provincializmi dhe feudalizmi krahinor dhe ta vendos atë në epiqendrën e interesimit gjithëkombëtar, ashtu siç veproi dikur truri i shqiptarizmës – Hasan Prishtina”, u shpreh Asani.

Në përvjetorin e Kuvendit të Junikut, një pjesë e konsiderueshme e botimeve të ITShKSh-së në Shkup, iu dhuruan Bibliotekës Komunale “Din Mehmeti” të Junikut.

Fatmir Toçi promovoi ‘Ditarin e përballjes me Koronavirusin’



Shkup – Më 25 maj në Institutin e Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në bashkëpunim me Shtëpinë Botuese “Toena” dhe Komunën e Çairit, u promovua libri “Ditari i përballjes me koronavirusin” nga autori Fatmir Toçi.

Drejtuesja e Institutit Librit dhe Promocionit si dhe e Botimeve “Toena”, Irena Toçi, theksoi rëndësinë e këtij libri jo vetëm se për artin e kulturën shqiptare, por edhe për ndërgjegjësimin e publikut shqiptar lidhur me temën e koronavirusit që po vazhdon të jetë aktuale edhe sot.

Drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, tha se e gjithë bota hyri në një luftë të përgjithshme nga ky virus vdekjesprurës, i cili i prishi të gjitha balancet shoqërore, duke ndikuar ndjeshëm edhe në veprimtaritë tona kulturore e shkencore. “Vetë prania fizike e miqve tanë nga Tirana, po tregon në njëfarë forme se ky virus po shkon, dhe se bota do të merr frymë më lirisht”, u shpreh Asani me tone optimiste.

Autori fatmir Toçi falënderoi për mikpritjen e shqiptarëve të Shkupit, dhe paraqiti disa sekuenca interesante nga vështirësitë e tij gjatë betejës personale 55-ditore me Covid 19, të cilat janë pjesë e rrëfimit të këtij libri.

ITShKSh me elaborat për shpalljen e Nënës Tereze “Pasuri kombëtare”



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
ИНСТИТУТ ЗА ДУХОВНО И КУЛТУРНО НАСЛЕДСТВО НА АЛБАНЦИТЕ – СКОПЈЕ
INSTITUTE OF SPIRITUAL AND CULTURAL HERITAGE OF THE ALBANIANS – SKOPJE

Република Северна Македонија
 Република Северна Македонија
 Република Северна Македонија

Редовна адреса: 1000 Скопје, Б. П. 4489 (п) 2 5215 361, *309 (п) 2 3215 362, www.itshksh.mk, e-mail: kontakt@itshksh.mk

19.05.2021



Република Северна Македонија
 Република Северна Македонија
 Република Северна Македонија

03-315/1

19.05.2021

Drejtuar: РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
Кувенди të Republikës së Maqedonisë së Veriut
z. Talat Xhaferi, kryetar

До: ДИЈИЈА
Собрание на Република Северна Македонија
Г. Талат Цафери, претседател

Lënda: Dorëzimi i Elaboratit

Својинство	Вид	Термин	Врста
19.05.2021			

Презмет: Доставување на elaborat

Te nderuar,

Në vazhdim ju dorëzojmë elaboratin që Gonxhe Bojaxhiut – Nënën Tereze – tashmë e shpallur e shenjtë nga Vatikani – dhe trashëgiminë e saj ta shpallë “Pasuri kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Me respekt,

Pочитувани,

Во прилог ви доставуваме elaborat со кој што ќе се предложи на Собranето на Република Северна Македонија да донесе одлука со која што наследството на Мајка Тереза ќе се прогласи како национално богатство на Република Северна Македонија.

Shkup – Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITShKSh), përkatësisht Departamentit për Trashëgiminë e Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze, përmes një elaborati të nënshkruar nga drejtori prof. dr. Skender Asani, drejtuar kryetarit Talat Xhaferi, ka inicuar edhe zyrtarisht kërkesën që Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ta shpallë **Nënën Tereze – ‘Pasuri kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut’**.

Më 1 qershor 2021, bashkëngjitur kërkesës në fjalë, ITShKSh-ja dorëzoi dhe elaboratin me të cilin dha një arsytim të thuktë e shkencor mbi domosdoshmërinë e këtij akti.

Në arsytim, ndër të tjera, thuhet se Departamentit për Trashëgiminë e Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze në ITShKSh, është i vetmi institucion shkencor në botë që ka departament të këtyllë shkencor, dhe është krijuar një

pikë referuese që merret me trashëgiminë e kësaj figure markante të flijimit, të bamirësisë dhe të humanizmit. Për rrjedhojë ITShKSh është bartës institucional shkencor i studimit, i njohjes dhe i promovimit të personalitetit dhe të veprës së Nënës Tereze, prandaj e ndjen detyrën, përgjegjësinë dhe kompetencën që ta bëjë edhe këtë propozim.

Nëna Tereze është identiteti më besnik i përfaqësimit të Maqedonisë së Veriut: ajo është edhe shkupjane, edhe e krishterë, edhe shqiptare, një identitet autentik i Maqedonisë shumëtnike dhe shumëreligjioze, thuhet në letrën e Dr. Asanit, duke shtuar se shkupjania Agneze Gonxhe Bojaxhiu – Nëna Tereze është arketip i Maqedonisë së Veriut, në kuptimin shoqëror, ndërsa është sinonim edhe i frymës së dashurisë, paqes, bamirësisë dhe humanizmit që buron nga gjeografia jonë. Misioni i saj është promovimi më i mirë i vendit tonë në botë. Ajo është edhe figurë që na afron e nuk na përplas me askënd, me asnjë fqinj, me asnjë shtet, por edhe me asnjë grup shoqëror, kulturor e religjioz brenda dhe jashtë vendit.

Pas shpalljes për “Pasuri kombëtare”, gjë që nuk e ka bërë askush tjetër deri më tani, Republika e Maqedonisë së Veriut bëhet pronare legale dhe legjitime e trashëgimisë së Nënës Tereze. Në këtë mënyrë RMV-ja bëhet atdheu legal dhe legjitim i trashëgimisë së Nënës Tereze, ndërkohë që, siç propozon ITSHKSH, gjëja e parë që do ta bëjë RMV-ja është brendimi i emrit të saj: shqip “AGNEZE GONXHE BOJAXHIU – NËNA TEREZE”; maqedonisht: АГНЕЗЕ ГОНЦИЈЕ БОЈАЦИЈУ – МАЈКА ТЕРЕЗА“ dhe anglisht: “AGNEZE GONXHE BOJAXHIU – MOTHER TERESA”. Brendimi ligjor dhe patentimi si “Pasuri kombëtare e RMV-së” është mënyra e vetme që emri i saj të ruhet nga shtrembërimet e mundshme, qofshin ato të rastësishme ose të qëllimshme.

Duke e shpallur “pasuri kombëtare”, RMV-ja krijon mundësi që emri, trashëgimia dhe gjithçka që lidhet me të, të vihet nën mbrojtje ligjore, siç ndodhë me secilën pasuri tjetër kombëtare të vendit tonë. Kjo nënkupton që shtëpia e saj, kisha e pagëzimit të saj (Shtëpia Përkujtimore), dokumentet që kanë të bëjnë me të, me familjen e saj, si dhe gjësendet e jetës materiale, madje edhe bredhi i mbjellë prej saj më 1980 në sheshin e Shkupit, të gjitha të jenë nën mbrojtje ligjore si “pasuri kombëtare” e Maqedonisë së Veriut.

ITShKSh vlerëson se pasi të shpallet “Pasuri kombëtare”, Maqedonia e Veriut do të duhet të ofrojë mundësi që, përmes Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, ta avancojë studimin e personalitetit dhe të

veprës së saj, duke mbështetur projekte hulumtuese dhe aktivitetet shkencore e promovuese, ndërsa një detyrë tjetër është edhe fuqizimi i Shtëpisë Përkujtimore të Nënës Tereze me artefakte të reja, dokumente dhe gjithçka që lidhet me emrin e saj.

Kur ta ketë të drejtën e “pronësisë mbi trashëgiminë e Nënës Tereze”, RMV-ja, në mënyrë institucionale, mund të kërkojë që secili shtet i botës të jetë i obliguar që gjithçka që ka për Nënë Tereze ta deponojë në Shkup.

Si “Pasuri kombëtare”, emri i Nënës Tereze do të duhej të jetë i shpërndarë nëpër shkolla, spitale, ente shëndetësore, aeroporte, sheshe, autostrada e institucione të tjera publike, nëpër gjithë vendin, në mënyrë që kudo që të kalojë një vizitor i huaj ose një qytetar i vendit, të mund ta ndeshë emrin e saj. Në të vërtetë, sot në shumë vende të botës, përfshirë edhe SHBA-të e Kanadanë, e kanë emrin e saj në pikat më frekuentuese publike, thuhet në elaboratin e ITShKSh-së, drejtuar Talat Xhaferit, kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Konferencë shkencore kushtuar historianit Ramiz Abdylit



Shkup – Më 10 qershor 2021, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në përvjeorin e 143-të të Lidhjes së Prizrenit, u mbajt konferenca shkencore “Ramiz Abdylit, profesori dhe studiuesi model i historiografisë shqiptare”.

Konferencën e hapi drejtori i Institutit, Skender Asani, i cili theksoi se sot na ka bërë bashkë prof.dr. Ramiz Abdylit dhe 143 vjetori i Lidhja Shqiptare e Prizrenit. “Jo rastësisht po e vendosi në një korrelacion emrin e profesorit me këtë ngjarje të lavdishme të popullit shqiptar, për arsye se ishte pikërisht ai që injektoi në formimin tim nervin e reagimit profesional ndaj proceseve historike që ishin të lidhura ngushtë me Shkupin dhe ngjarjet që e bënë dikur këtë qytet një amfiteatër të madh ku ballafaqohej Lindja dhe Perëndimi, robëria dhe liria, lufta për shtet kombëtar dhe ikja në periferi të atij shteti”, tha Asani. Sipas tij, prof. Ramiz Abdylit paraqet aktualisht një prej emrave më

emblematic në historiografinë shqiptare, vepra e të cilit do të mbetet një prej dhuratave më të çmuara në trashëgiminë tonë të shkruar. Ai pati një qëndrim konstant ndaj të vërtetës historike, duke i dhënë asaj bazën e argumentimit shkencor, që e mbështeti në hulumtime disadekadëshe.

Aktivitetin e përshëndetën deputeti Arbër Ademi, drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, Ylber Sela dhe stërnipi i Hasan Prishtinës, studiuesi Mehmet Prishtina.

Më pas u zhvillua konferenca shkencore, ku me temat e tyre u paraqitën studiuesit: Marenglen Verli nga Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë: "Ramiz Abdyli, profesori dhe miku i nderuar"; Naim Halimi – ITShKSh në Shkup: "Kontributi i prof. dr. Ramiz Abdylit në historiografinë shqiptare"; Fehari Ramadani nga Universiteti "Fadil Sulejmani" në Tetovë: "Ramiz Abdyli, profesori që motivonte"; Qerim Dalipi nga Universiteti "Fadil Sulejmani" në Tetovë: "Ramiz Abdyli dhe kontributi i tij për historiografinë shqiptare (deri në Lidhjen e Prizrenit)", Isamedin Azizi – ITShKSh në Shkup: "Kontributi shkencor i profesor Ramiz Abdylit në Institutin e Historisë Nacionale në Shkup"; Emin Azemi nga ITShKSh në Shkup: "Mbi profilin intelektual, shkencor e akademik të prof.dr. Ramiz Abdylit"; Fitim Rifati nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë: "Vështrimi mbi veprat e botuara të prof. dr. Ramiz Abdylit, në kuadër të Institutit të Historisë në Prishtinë"; Alban Dobruna nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë: "Kontributi i prof. dr. Ramiz Abdyli në revistën shkencore 'Kosova'", dhe Besnik Rameti nga ITShKSh në Shkup: "Prof. dr. Ramiz Abdyli, si ligjërues dhe rektor i Universitetit të Tetovës".

Më pas u bë promovimi i dy veprave të reja shkencore të autorit Ramiz Abdyli, botuar nga ITSHKSH – Shkup: "Shkupi në Lidhjen e Prizrenit 1878-1881" dhe "Veprimtaria e Klubit të Shkupit 1908-1012". Me këtë rast, referuan studiuesit Skender Asani, Sevdail Demiri dhe Emin Azemi.

Në fund, të pranishmit i përshëndeti autori Ramiz Abdyli , i cili e falënderoi Institutin dhe studiuesit për referimet e tyre dhe nderin e bërë.

ITShKSh dhe QSPA nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi



Shkup – Në kuadër të këmbimit të dijeve e përvojave me institucione të tjera rajonale, më 16 qershor në Shkup është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Institutit i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) nga Tirana.

Udhëheqësit e këtyre dy institucioneve – Prof.dr. Skender Asani, drejtor i ITSHKSH dhe Dr. Diana Kastrati, drejtoreshë e QSPA, u zotuan se ky memorandum bashkëpunimi do të jetë jo vetëm formal, por edhe përmbajtësor, me aktivitete e projekte konkrete që do të realizohen bashkërisht në të ardhmen.

Një letërnjoftim mbi punën e ITSHKSH paraqit fillimisht Dr. Asani, i cili e njoftoi kolegën nga Tirana mbi profilin e këtij Instituti, duke folur konkretisht për departamentet ekzistuese si dhe përgjithësisht për veprimtarinë shkenco-

re e botuese. Ai gjithashtu bëri të ditur se edhe sivjet do të ketë përmbajtje tematike në kuadër të Ditëve të Alfabetit, që fillojnë më 14 nëntor të këtij viti, e që do t'iu kushtohet Arbëreshëve të Italisë, përfshi gjithë krijimtarinë dhe potencialin krijues të tyre në të kaluarën dhe sot.

Dr. Asani me këtë rast foli edhe për rëndësinë që kishin arbëreshët në shek. 19, atëherë kur po finalizohesh formimi i kombeve në Europë.

“Arbëreshët ishin ura që lidhte shqiptarët me Europën dhe përmes tyre transmetoheshin idet europiane në hapësirën shqiptare. Me krijimtarinë dhe kreativitetin e tyre krijues, arbëreshët ruajtën frymën evropiane brenda trungut etnik shqiptarë dhe kjo është arsyeja që ne sivjet do ta trajtojmë rolin e arbëreshëve pikërisht në këtë prizëm”, nënvizoi Dr. Asani.

Dr. Diana Kastrati, drejtoreshë e QSPA, gjithashtu i bëri një përshkrim telegrafik punës njëvjeçare e gjysmë të kësaj qendreje, e cila, siç tha ajo, ka mision studimet e specializuara për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit mes studiuesve të fushës vendas dhe në diasporë e më gjerë, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e strukturës së studimeve mbi komunitetin arbëresh. Pjesë e misionit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) është vlerësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me komunitet arbëresh në botë, përmes organizimit të aktiviteteve dhe konferencave shkencore.

U dhuruan libra nëpër shkolla e biblioteka me emrin e Hasan Prishtinës



Shkup / Prishtinë – Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 100-vjetorit të Hasan Prishtinës-Kryeministër i Shqipërisë (1921), m; 17 qershor u organizua një aksion për dhurimin librave në disa shkolla dhe institucione që mbajnë emrin e këtij kolosi tonë kombëtar. Ideatori i këtyre aktiviteteve është Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, i cili në bashkërendim me veprimtarin dhe studiuesin Mehmet Prishtina, ishin bartës të këtij aksioni.

Në dhurimin librave, përpos ITSHKSH janë bashkangjitur edhe shtëpitë botuese “Armagedoni” (Berat Dakaj) dhe “Faik Konica” (Nazmi Rrahmani) nga Prishtina si dhe shkrimtari dhe gazetari Arben Veselaj.

Bashkë me librat, Mehmet Prishtina ka dhuruar për çdo shkollë edhe një portret të Hasan Prishtinës, punuar nga piktori Bashkim Kabashi me origjina nga Polaci i Drenicës.

Karvani i dhuruesve të librave ka filluar me Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Hasan Prishtina" në fshatin Llugaxhi të Lipjanit, ku është pritur nga drejtoresha e kësaj shkolle, Drita Islami, e cila ka falënderuar dhuruesit përmes mirënjohjeve. Aksioni ka vazhduar në Prishtinë, në shkollën me të njëjtin emër, me ç'rast drejtoresha e kësaj shkolle, Sofie Bunjaku, ka nderuar gjithashtu me mirënjohje dhuruesit e librave. Edhe biblioteka e shkollës "Drenica" në Polac, është pasuruar me një fond të konsiderueshëm librash dhe kjo është vlerësuar lart nga drejtori Gëzim Gashi, i cili ka nderuar dhuruesit e librave me mirënjohje.

Vizita në Skenderaj përkonte me 22-vjetorin e çlirimit të qytetit, dhe ky ishte një rast i mirë që kjo festë të urohet nga dhuruesit e librave për bibliotekën e këtij qyteti, kurse drejtori i Drejtorisë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Skenderaj, Abdyl Imeri, falënderoi donatorët për dhurimin e librave. Libra të dhuruara shkuan edhe për ShFMU "Hasan Prishtina" në fshatin Tërpezë të Malishevës, ku drejtoresha Emine Krasniqi shprehu falënderimin në emër të nxënësve dhe arsimtarëve përmes mirënjohjeve.

Në Mitrovicë, karvani i dhuruesve të librave ndaloi në Shkollën e Mesme Ekonomike "Hasan Prishtina" në Mitrovicë, ku drejtori Avdulla Bejtullahu gjithashtu ndau mirënjohje për donatorët.

Ndalesa e fundit ishte në Vushtrri, kurse aksioni për dhurimin e librave edhe në këtë qytet përkonte me ditën e çlirimit. Drejtoresha e Kulturës e Komunes së Vushtrrisë, Arta Ismaili dhe drejtori i bibliotekës së "Naim Frashëri", Izet Miftari, pranuan pakon me libra dhe ndanë mirënjohje.

Prof. dr. Skender Asani duke sublimuar qëllimet fisnike të këtij aksioni gjatë vizitave që iu bënë shkollave dhe institucioneve me emrin e Hasan Prishtinës, vuri në dukje rëndësinë që ka për kulturën dhe arsimin edukimi i mirëfilltë përmes leximit. Ai me këtë rast përçoi mesazhe për unitet dhe mirëkuptim në mes të shqiptarëve, duke thënë se shqiptarët si komb dhe sidomos elitat politike, duhet t'i lënë inatet dhe egoizmat partiake që të punojnë në favor të një mendimi dhe veprimi që i bën ata më serioz para faktorëve vendimmarrës.

U prezantuan relikte banimi nga treva e Karadakut të Kumanovës



Shkup – Më 30 qershor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, u bë prezantimi i ekspozitës dhe katalogut me titull “Relikte banimi nga treva e Karadakut” përgatitur nga autori Sevdail Demiri. Projekti kishte për qëllim hulumtimin, evidentimin, dokumentimin dhe prezantimin e disa ekzemplarëve të objekteve të vjetra të banimit nga treva e Likovës dhe Kumanovës, aty ku prej në kohërat më të lashta lulëzonte jeta. Duke mos e kufizuar hulumtimin në kohë, autori iu është qasur mbetjeve nga lokalitetet e vjetra arkeologjike e deri te shtëpitë e vjetra fshatare me objektet e tyre përcjellëse të banimit, të cilat paraqesin vlera të mirëfillta të trashëgimisë sonë kulturore.

“Kemi insistuar në këtë dokumentim, meqë derisa një pjesë e vogël e tyre aty-këtu ende qëndrojnë në këmbë, në anën tjetër, shumica është duke u zvetënuar nga ‘dhëmbi i kohës’. Për arritjen e këtij qëllimi, fillimisht e kemi observuar

gjithë rajonin e Karadakut të Likovës dhe Kumanovës, e posaçërisht atë malor, ku kemi hasur në thesare të paçmueshme të trashëgimisë sonë kulturore, kemi hasur në relikte arkeologjike të banimit, por edhe shtëpi banimi qindravjeçare, të cilat mezi i rezistojnë kohës”, tha autori Demiri. Sipas tij, më atraktive mbetet zona e Likovës, me varrimet e mumifikuara në lokalitetin arkeologjik i njohur si ‘Uji i Thartë’, ku pas 2500 vjetëve na përcillen informacione të ekzistencës së një popullsie vendase me rite krejt të veçanta të mënyrës së varrimit. “Më tej, në këtë dokumentim kemi vënë në dukje edhe asete tjera të mëdha të trashëgimisë sonë kulturore materiale, të cilat nuk janë hulumtuar fare. Është Kalaja e Hotlës që gjendet në mes fshatit Hotël e Strimë e pagëzuar si Refugium, është Kalaja e Hisarit në Sllupçan nga periudha e Antikitit të vonshëm, si dhe shpella e Orkocit e njohur nga banorët vendas si Skutella, që paraqet një thesar të pahulumtuar deri më tani dhe të pavalorizuar të trashëgimisë sonë natyrore”, u shpreh studiuesi Demiri.

Më tej, si relikte të vjetra të banimit në këtë trevë, autori ka dokumentuar disa shtëpi të vjetra fshatare, të cilat kanë mbetur ende në këmbë. Ndër to nga më të vjetrat dhe më karakteristike të kësaj treve është shtëpia e familjes Ismaili në Orkoc, e ndërtuar me dru, gurë dhe lloç, e cila ka një vjetërsi që shkon në mbi 150 vjet. Autori ka propozuar restaurimin dhe konservimin e saj dhe ngritjen në një muze etnografik të zonës së Likovës. Gjatë këtij hulumtimi janë dokumentuar edhe disa shtëpi interesante që ndodhen në Presnicë, Goshincë, Sllupçan, Orizare, Nikushtak, etj.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se ky hulumtim i prof. Sevdail Demirit, i prezantuar në këtë ekspozitë, ka një rëndësi të madhe për trashëgiminë tonë kulturore. Sipas tij, përmes Departamentit të kulturës materiale në ITShKSh, dhe veçanërisht përmes Qendrës rajonale të trashëgimisë kulturore që do të ngritet në Kumanovë, në kuadër të ITShKSh-së, të gjitha këto vlera të kulturës materiale do ta marrin trajtimin e duhur. Prandaj, në të ardhmen do të ndërmerren edhe projekte tjera që kanë për qëllim hulumtimin, studimin, dokumentimin dhe ekspozimin e vlerave të tilla të trashëgiminë tonë kulturore.

Projekti “Relikte banimi nga treva e Karadakut” i studiuesit Sevdail Demiri, është mbështetur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me programin nacional të vitit 2021. Materiali i ekspozitës i dorëzohet Institutit dhe në hapësirat e tij do të qëndrojë si ekspozitë e përhershme.

Arkeologu Sali Islami në projektin e Kalasë së Prizrenit



Shkup / Prizren– Gjatë muajve korrik dhe gusht të vitit 2021, arkeologu nga Departamenti i Kulturës Materiale në ITShKSh – Shkup, Sali Islami, është angazhuar profesionalisht në projektin e Kalasë së Prizrenit.

Saliu është pjesë e ekipit të arkeologut dr. Shafi Gashi, në këtë projekt të Institutit Arkeologjik të Kosovës që nga viti 2014. Aktualisht janë duke punuar me materialin arkeologjik i dalur nga ekspeditat arkeologjike të viteve të fundit, si dhe janë duke përgatitur katalogun e ekspozitës arkeologjike në Kalanë e Prizrenit.

Siç dihet, kjo ekspozitë është hapur për vizitorët në gusht të vitit 2019 në Muzeun e Kalasë së Prizrenit dhe ka një interesim të jashtëzakonshëm nga vizitorët e huaj dhe vendas.

Shkupi i adresave të reja shqiptare, në frymën e Marrëveshjes së Ohrit



Shkup – Në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, ITShKSh-Shkup në bashkëpunim me Ministrinë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, më 3 gusht u mbajt tribuna me temë: “Shkupi i adresave të reja shqiptare, reflektim i frymës së Marrëveshjes së Ohrit”.

Drejtori i ITShKSh – Shkup, Skender Asani, tha se emërtimi i më se 150 rrugëve, shesheve, e bulevardeve me emra shqip në Shkup me frymën e Marrëveshjes së Ohrit, është një nga të arriturat më të mëdha të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Ai theksoi nevojën që kjo përvojë e Qytetit të Shkupit, të reflektojë edhe në komunat tjera, ku shqiptarët duhet ta ndijnë si pjesë të veten çdo qytet, fshat, rrugë, rrugicë, shesh a bulevard. Duke qenë se thelbi i Marrëveshjes së Ohrit është trashëgimia kulturore, Asani tha se Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, është gardian i

mbrojtjes së trashëgimisë tonë kulturore në Maqedoninë e Veriut dhe i vetë Marrëveshjes së Ohrit.

Zëvendëskryeministri i Parë i Qeverisë, Artan Grubi, tha se këto ditë po shënohet dinjitetshëm 20-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit, me aktivitete të shumta, si një ngjarje që e ndryshoi vendin rrënjësisht. Sipas tij, ndryshimi i emrave të rrugëve është një e arritur e prekshme sikurse edhe shumë të arritura tjera që kanë vulën e Marrëveshjes së Ohrit, prandaj kjo marrëveshje meriton që të trajtohet si trashëgimi kulturore, për të cilën do të duhet të bëhen studime të thella duke e krahasuar gjendjen e shqiptarëve me periudhën para dhe pas Marrëveshjes së Ohrit.

Më tutje, publicisti dhe studiuesi Emin Azemi, foli rreth botimit më të ri të Institutit “Adresat e reja të një kujtese”, me autor Skender Asanin, ku në mënyrë të përpiktë jepet argumentimi për mbi 150 emra shqiptarë që tanimë janë pjesë e realitetit të prekshëm të Qytetit të Shkupit.

Mehmet Prishtina, pasardhës i Hasan Prishtinës, me shumë emocione foli rreth emërimit të magjistrales kryesore që e lidhë Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, përkatësisht Hanin e Elezit me Shkupin, me emrin e heroit të kombit Hasan Prishtina.

Koordinatori i këshilltarëve shqiptarë në Qytetin e Shkupit, Besnik Ajeti, tha se nuk ka qenë e lehtë që të bindet shumica e këshilltarëve maqedonas për këtë ndryshim të madh të emrave, por falë këmbëngulësisë së këshilltarëve shqiptarë, me mbështetjen e përfaqësuesve tanë në Qeveri, si dhe me argumentimin shkencor nga ana e Institutit, u arrit ky sukses historik.

Në fund, përmes një video-mesazhi, të pranishmëve iu drejtua edhe studiuesi amerikan nga Tirana, David Hosaflook, i cili zbërtheu në hollësi disa nga emrat e anëtarëve të familjes Qiriazi, të cilët do t'i stolisin rrugët e Shkupit.

U promovua libri “Luboteni 2001” dhe emisioni “Kur Luboteni digjej...”



Shkup – Me rastin e 20-vjetorit të masakrës mbi fshatin Luboten të Shkupit, më 11 gusht në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulture të Shqiptarëve – Shkup u promovua libri “Luboteni 2001” i autorëve Skender Asani, Sevdail Demiri dhe Zeqirija Ibrahim, si dhe emisioni dokumentar “Kur Luboteni digjej”, i realizuar nga Radio-Televizioni Shqiptar.

Në fillim të pranishmit i përshëndeti drejtori i Institutit, Skender Asani, i cili foli për vijimësinë e represioneve dhe vrasjeve ndaj shqiptarëve gjatë historisë, që nga '45-ta e deri në vitin 2001 në fshatin Luboten. Ai theksoi se “Tragjedia e Lubotenis ishte çmimi i arritjes së Marrëveshjes së Ohrit”

Pas tij me fjalë falënderuese u paraqit edhe kryetari i Bashkësisë Lokale të Lubotenis, Rexhep Imeri, i cili falënderoi Institutin për këtë libër dhe Radio-Televizionin Shqiptar për emisionin dokumentar.

Për librin në fjalë me referate u paraqitën Nuridin Ahmeti – historian dhe punonjës nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Sefer Tahiri – hulumtues në ITSHKSH në Shkup. Në fjalën e tij Nuridin Ahmeti theksoi se: “Libri ‘Luboteni 2001-studime, raporte, dokumente dhe fotografi’, i përgatitur nga tre studiuesit Skender Asani, Sevdail Demiri dhe Zeqirja Ibrahim, është prurja më e mirë për këtë ngjarje, e cila ka ndodhur para dy dekadave në një pjesë të territorit të Maqedonisë së Veriut. Ata që janë të interesuar, të lexojnë për këtë ngjarje të bazuar në fakte dhe argumente, tani e kanë këtë mundësi, përmes leximit të këtij libri. Këtë libër duhet ta kenë në dorë të gjithë ata, nga mosha e Erxhan Aliut deri te mosha e Memet Memetit, jo për të ngjallur urrejtje, por për t’ua shpjeguar drejt këtë ngjarje, me qëllim që ajo mos të harrohet, dhe e dimë mirë se ajo që harrohet është e rrezikuar të përsëritet.”

Ndërkaq recensenti tjetër, Sefer Tahiri, përkitazi me librin tha se: “Sulmi policor në Luboten do të mbahet mend në histori si vepër kundër njerëzimit, pasi i njëjti shkaktoi 10 viktima, emrat e të cilëve jo që nuk do hiqen vetëm nga mbamendja e familjarëve dhe të afërmve të tyre, por edhe nga kujtesa e historisë. Monografia e autorëve Asani, Demiri dhe Ibrahim, me një kujdes të posaçëm dhe qasje profesionale shkencore, sjell para lexuesit jetëshkrimet e këtyre njerëzve, që u bënë martirë të betejës përballëse të shqiptarëve me sistemin shtetëror. Autorët e monografisë me një pedanteri kanë gjurmuar në arkiva e më pas i kanë sistemuar raportimet dhe vrojtimitet gazetareske të mediave vendore, që pasqyruan me fjalë dhe imazhe ngjarjen e Lubotinit para opinionit vendas dhe ndërkombëtar.”

Në emër të autorëve, të pranishmit i falënderoi Sevdail Demiri.

Në fund u emetua edhe emisioni dokumentar “Kur Luboteni digej”, i përgatitur nga Genc Ymeraj si produksion i RTSH-së, i cili ngjalli kujtime të dhimbshme të familjarët e viktimave që ishin të pranishëm në sallë, ndërsa u mirëprit me duartrokitje nga të gjithë që ishin në këtë promovim.

Përvjetori i Çlirimit të Shkupit, kauzat shqiptare - para dhe pas Hasan Prishtinës



Shkup – Më 12 gusht, shënimi i 109- vjetorit të çlirimit të Shkupit nga ana e kryengritësve shqiptarë, filloi me nderimet para përmendores së Hasan Prishtinës në Shkup, ku nga disa delegacione institucionale u vendosën kurora lulesh të freskëta. Më pas, në ITShKSh, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e “100 vjetorit – Hasan Prishtina Kryeministër i Shqipërisë”, u mbajt tribuna tematike: “Kauzat shqiptare – para dhe pas Hasan Prishtinës”.

Skender Asani, drejtor i Institutit, tha se sot kur kujtojmë 12 gushtin e famshëm të Shkupit të lirë dhe të administruar për herë të parë nga forcat kryengritëse shqiptare, porosia nuk do të duhej të kufizohet vetëm në peshën dhe rëndësinë që pati kjo ditë në historinë e shtetndërtimit të shqiptarëve, por edhe në një dimension tjetër që duhet patjetër të ketë ky shtetndërtim. “Ajo çka nuk u arrit të realizohej si qëllim madhor në Shkup, u transferua në Vlorë, si amanet i një pune të papërfunduar, ndërkohë që idealistët shqiptarë të ilegales së viteve ‘60, ‘70 e ‘80 në ish-Jugosllavi, ndaheshin dikund – dikund në nuanca ideologjike, por ata sërish bashkoheshin në idenë e pavdekur të bashkimit kombëtar”, u shpreh Asani.

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, tha se gjenerata të tëra janë rritur dhe frymëzuar nga jeta dhe vepra e Hasan Prishtinës, si një shembull më tipik i një atdhetari e dijetari fisnik, i cili flijoi gjithçka që pati për të mirën e kombit shqiptar. “Ndërsa, ne kemi përpara edhe shumë punë për të bërë, misioni ynë akoma nuk ka mbaruar – vazhdon, vendet tona duhet të jenë të anëtarësuara pranë Bashkimit Europian, sepse më europian se ne shqiptarët që kemi dhënë dhe kemi bërë për Europën nuk mund të jenë të tjerët”, u shpreh Ahmeti.

Në pamundësi të pjesëmarrjes fizike në këtë ngjarje, një mesazh e kishte dërguar kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duke uruar për aktivitetet në Shkup, për këtë ngjarje të madhe të historisë sonë kombëtare. Kurti përcolli porosinë e bashkëpunimit dhe koordinimit brendashqiptar në rajon në projekte të përbashkëta, përpara se një gjë e tillë të ndodhë me fqinjët.

Të pranishmit i përshëndeti Andi Hoti, kryesues i komisionit qeveritar të Kosovës për personat e pagjetur gjatë luftës, si dhe veprimtari i çështjes kombëtare Sadri Ramabaja.

Në emër të familjeve atdhetare nga Kosova, folën Mehmet Prishtina dhe Gazmend Boletini, të cilët para të pranishmëve përcollën dëshirën dhe shpresën që amaneti i paraardhësve të tyre, heronjve të kombit Hasan Prishtina e Isa Boletini, të mos shterohet kurrë.

Me këtë rast, para publikut u promovua edhe kënga e re “Shkupi Dardan” e interpretuar nga Shkodran Tolaj, Besiana Mehmeti, Visar Rexhepi e Miranda Hashani, kushtuar pikërisht çlirimit të Shkupit nga ana e kryengritësve shqiptarë mëse një shekull më parë.

Pas tribunës, nderimet u bënë edhe para shtatores së Isa Boletinit në Saraj të Shkupit. Këto aktivitete u zhvilluan sipas protokollit shëndetësor të Institutit të Shëndetit Publik.

Me ministrin Mehaj, nderime për Nënë Tereze



Shkup – Drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, bashkë me ministrin e Mbrotjtjes të Republikës së Kosovës, Armend Mehaj, më 25 gusht vendosën lule të freskëta mbi pllakën përkujtimores të Nënë Tereze në Sheshin e Shkupit.

“Falënderoj ministrin Mehaj për respektin dhe nderimin që po ia bën Shenjtores sonë me rastin e 111 vjetorit lindjes së të saj, duke ndarë bashkë me ne si institucion këtë ceremoni nderimi, që është jo vetëm privilegj, por edhe obligim që të jemi krah njëri tjetrit në punë e ide të mira”, shkroi Asani në profilin e tij në fcb.

Për Shentorën tonë – Nënë Tereze, nesër mbahet një manifestim dinjitoz, në Sheshin e Shkupit, aty ku ndodhen themelet e shtëpisë së saj, ku do të shpaloset projekti i radhës.

Manifestimi “Drita e Gonxhes”, Shenjtorja jonë nën mbrojtjen e shtetit!



Shkup – Në 111-vjetorin e lindjes së shenjtores shqiptare Nëna Tereze, më 26 gusht, para pllakës përkujtimore ku gjendeshin themelet e shtëpisë së saj ku lindi, filloi manifestimi i organizuar nga ITShKSh-ja në Shkup, “Drita e Gonxhes”.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, theksoi se ITShKSh-ja ka inicuar, në formë të një elaborati, idenë për ta vendosur nën mbrojtje të shtetit emrin dhe veprën e Nënës Terezes, duke i dhënë vendin e merituar trashëgimisë së saj në kujtesën tonë kolektive. Prandaj, në kuadër të Departamentit të Trashëgimisë së Gonxhe Bojaxhiut-Nënës Tereze, janë grumbulluar fakte e argumente për ta mbështetur idenë që kjo Shenjtore e jona të vendoset nën mbrojtje të shtetit, me ç’rast është botuar edhe elaborati, i cili tash më ndodhet në zyrat kryesore të instucioneve tona dhe së shpejti edhe në zyrat e diplomatëve të huaj që ndodhen në vendin tonë.

“Dita e sotme që ndërlihet me ditëlindjen e Nënës Tereze, mund të na shërbejë si një shkas për të reflektuar dhe tërhequr, me veprimet tona, gjithë

vëmendjen ndaj kësaj figure kolosale. Shpresoj që kjo vëmendje tash e tutje do të ketë fokusin e merituar në institucionet shtetërore, duke kaluar nga evokimi në materializim të figurës së Nënës Tereze, përmes një kornize juridike e cila do të shpallte atë aset shtetëror nën mbrojtje të ligjit”, potencoi drejtori Asani.

Profesor Anton Nikë Berisha nga Kosova, autor i parathënies së elaboratit “Shenjtoria jonë nën mbrojtjen e shtetit”, tha se me këtë botim Instituti ka dëshmuar një vetëdijesim të lartë për t’u bërë të ditur organeve përkatëse të RMV-së se këtë figurë të madhe duhet ta bëjnë pjesë të jetës shoqërore, kulturore dhe politike, sepse Nëna Tereze është një simbol që i afron kulturat, njerëzit dhe pikëpamjet e tyre, duke mundësuar një veprimtari të përbashkët që është një bazë e mirë për zhvillimin dhe përparimin e shtetit.

Kryetari i shoqatës qytetare “Shkupjanja Nënë Tereza, Dimçe Petrushevski, tha se përmes figurës së Nënës Tereze afirmohemi të gjithë ne si një shoqëri, pa dallim të përkatësisë nacionale dhe fetare, andaj edhe jemi krenar dhe me fat që e kemi bashkëqytetaren tonë përfaqësuese të denjë në mbarë botën.

Publicisti dhe studiuesi Emin Azemi, foli rreth rëndësisë së manifestimit “Drita e Gonxhes”, i cili filloi sot dhe do të zgjasë deri më 5 shtator, kur janë paraparë disa aktivitete kulturore e shkencore në nderim të kësaj figure të madhe të mbarë njerëzimit.

Sopranoja Besiana Mehmedi interpretoi këngën “Lamtumirë”, me tekst të Gonxhe Bojaxhiut (shkruar më 1928 gjatë shkuarjes në mision në Indi) dhe muzikë të Lorenc Antonit, shoqëruar me piano nga Shkëlzen Baftiari.

Në fund, nga disa delegacione u vendosën kurora lulësh të freskëta para pllakës përkujtimore të vendndodhjes së shtëpisë së lindjes së Gonxhe Bojaxhiut – Shën Nëna Tereze.

Kryeministri Kurti, nderime për shenjtoren Nëna Tereze



Prishtinë – Më 26 gusht, pas Shkupit vazhdoi në Prishtinë ceremonia e nderimit të emrit dhe veprës së Shenjttores sonë – Nëna Tereze, me rastin e 111-vjetorit të lindjes së saj.

“Ishim të nderuar që neve si ITSHKSH na u bashkëngjit në këtë ceremoni solemne edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, z.Albin Kurti, bashkë me disa anëtarë të kabinetit të tij, i cili potencoi rolin dhe kontributin e Institutit tonë në promovimin e vlerave dhe ideve të personaliteteve tona të shquara”, thuhet në një deklaratë të drejtorit të Institutit, Skender Asani.

Me këto aktivitete u shënua fillimi i manifestimit kulturor “Drita e Gonxhes”, i cili do të jetë tradicional dhe do te mbahet çdo vit nga 26 gushti deri në 5 shtator në Shkup dhe Prishtinë.

Konferencë kushtuar figurës poliedrike të profesor Xhevat Gegës



Shkup – Më 1 shtator, në ditën e parë të fillimit të vitit të ri shkollor, me një tribunë shkencore, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, u nderua autori i Abetares dhe figura poliedrike e profesor Xhevat Gegës.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se Xhevat Gega paraqet një figurë të spikatur të arsimit dhe kulturës shqiptare, të cilin shumë gjenerata nxënësish do ta mbajnë mend përjetësisht ai autorin e librit të Abetares, prej ku i mësuan shkronjat e para të gjuhës sonë. Sipas Asanit, profesor Gega në shumë fusha dha kontributin e tij të pakursyer, si gjuhëtar, letrar, përkthyes, gazetar dhe hartues tekstesh shkollore, prandaj kontributi i tij mbetet i pazëvendësueshëm.

Udhëheqësi i Katedrës së Gjuhës e Letërsisë Shqipe në Shkup, Ismet Osmani, e kujtoi Gegën si profesor dhe pedagog të veçantë, i cili në mesin e gjeneratave të shumta të studentëve, përçoi dijen, dashurinë dhe vullnin e punës pedagogjike, të cilën e kryente me shumë profesionalizëm dhe pedanteri.

Tribunën e përshëndeti edhe drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, Ylber Sela.

Në emër të familjes, tribunën shkencore e përshëndetën e bija e tij, Leontina Gega – Musa dhe djali Arben Gega, të cilët falënderuan Institutin dhe Katedrën e Gjuhës e Letërsisë Shqipe në Shkup për këtë organizim dhe nderim. Ndërsa, drejtori Asani në emër të Institutit ndau post-mortum një plakët për kontributin e veçantë të prof. dr. Xhevat Gegës në zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare.

Më pas, në sesionin e parë shkencor, u paraqitën kumtesat e studiuesve: Avzi Mustafa – “Prof. dr. Xhevat Gega – model njeriu, pedagogu e shkencëtari”, Haki Ymeri – “Profesor Xhevat Gega – pedagogu si ai”, Hysen Matoshi – “Naim Frashëri dhe Gligor Përliqevi në studimet e Xhevat Gegës”, Xheladin Murati – “Profesor Xhevat Gega, me mision konkret për arsimin, gjuhën dhe kulturën”, Mirlinda Krifca – “Kontributi i profesor Xhevat Gegës në fushën e studimeve letrare”, Asllan Hamiti – “Profesor Xhevat Gega – gojëtar i shquar”, Ajten Hajdari Qamili – “Profesor Xhevat Gega për kulturën e gjuhës dhe normën letrare në RMV”, Zeqirja Ibrahimimi – “Iluministi Xhevat Gega”, Lindita Ahmeti: “Erotika si harmoni e botës njerëzore”.

Ndërsa, në sesionin e dytë shkencor u paraqitën këto kumtesa: Zeqirja Neziri – “Xhevat Gega, profesor dhe studiues i letërsisë shqipe”, Nebi Dervishi – “Strugani prof. dr. Xhevat Gega – një gjysmë shekull jetë duke kalitur gjenerata”, Valbona Toska – “Profesor Xhevat Gega dhe gjuha shqipe”, Berton Sulejmani – “Profesor Xhevat Gega, bashkautor i gramatikave të shkollave fillore”, Ismet Osmani – “Rreth ndihmesave të profesor Xhevat Gegës për gjuhën dhe letërsinë shqiptare”, Afrim Rexhepi “Kritika letrare e Xhevat Gegës”, Shpresa Memedi Purde – “Xhevat Gega kolos i arsimit shqip”, Sevdail Demiri – “Xhevat Gega, gazetar i guximshëm dhe mjeshtër i fjalës së shkruar”, Farketa Dibra – “Zbatimi i metodës analitike-sintetike në Abetaren e Xhevat Gegës”, dhe Hidajete Azizi & Laura Papraniku Bejtullau “Abetarja e Xhevat Gegës vazhdimësi e abetareve shqiptare në Maqedoninë e Veriut”.

Të gjitha kumtesat do të botohen në një nga numrat e ardhshme të edicionit “Scupi”.

U nda nga jeta historiani prof. dr. Naim Halimi



Kumanovë – Më 15 shtator 2021, në moshën 66-vjeçare, u nda nga jeta prof. dr. Naim Halimi, nga fshati Shtrazë i Kumanovës, doktor i shkencave historike, këshilltar shkencor – profesor i rregullt në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Naim Halimi dha një kontribut të çmuar në edukimin e gjeneratave të tëra në frymën kombëtare. Pas mbarimit të Fakultetit Filozofik – dega e Historisë në Universitetin e Prishtinës, punën në arsim e filloi si profesor i historisë në Gjimnazin e Kumanovës (1982-1983). Një kohë të gjatë punoi në Shkollën fillore “Vëllazërimi” (më vonë “Naim Frashëri”) në Kumanovë (1984-1997). Pas mbarimit të studimeve të doktoratës në Institutin e Historisë në Tiranë, u angazhua ligjërues i disa lëndëve të fushës së historisë në Universitetin e Tetovës (1997-2008). Një mandat ishte edhe prorektor i Universitetit të

Tetovës, në kohën më të vështirë, para se ai të legalizohej. Së fundi u angazhua si profesor edhe në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup (2018-2021).

Nga viti 2009 u punësua në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, ku dha një kontribut të madh nëpër aktivitete të ndryshme hulumtuese – shkencore.

Naim Halimi është autor i botimeve shkencore, si: “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në trevën e Karadakut (1908-1912)”, Kumanovë, 2001; “Studime historike dhe etnologjike në trojet tona etnike”, ITShKSh, Shkup, 2017, dhe “Thesare kulturore dhe natyrore të trevës së Kumanovës”, në bashkautorësi me Sevdail Demirin, ITShKSh, Shkup, 2019.

Në dorëshkrim i kishte edhe disa vepra të rëndësishme të historiografisë, si: “Historia e popullsisë së Kumanovës (1600-2000) – disa personalitete të shquara shqiptare”; “Shpërnguljet e shqiptarëve nga Kumanova – shkaqet dhe pasojat”, “Shqiptarët e Maqedonisë në vitet e demokracisë”, “Shtraza”, etj.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes, miqve dhe kolegëve të prof. dr. Naim Halimit.

Botimet e ITShKSh, në Bibliotekën e Kongresit Amerikan



Uashington – Tash e disa vite një katalog i posaçëm i librave të ITShKSh-së ndodhet në Bibliotekën e Kongresit Amerikan. Kjo u bë e ditur gjatë një takimi që patën më 23 shtator përfaqësuesit e ITShKSh-së, të udhëhequr nga drejtori prof.dr. Skender Asani, me dr. Nevila Pahumi, bibliotekare referuese për greqishten e re dhe shqipen dhe mr. Michael Neubert, drejtor i seksionit Evropian të Bibliotekës së Kongresit.

Ky interesim për librin shkencor nga ana e Bibliotekës së Kongresit Amerikan është si rezultat i kureshtjes profesionale që ka treguar kjo bibliotekë e rëndësishme ndaj punës hulumtuese e krijuese të ITShKSh-së. Kjo u bë e qartë edhe në këtë takim, me ç'rast mysafirëve nga Shkupi iu prezantuan një mori botimesh të ITShKSh-së që Biblioteka e Kongresit i kishte siguruar dhe të cilat tash më janë në dispozicion të lexuesve të kësaj biblioteke.

Drejtori i Institutit, Skender Asani u zotua se në të ardhmen fondi i librave, revistave shkencore si dhe publikimeve të specializuara do të jenë në dispozici-

on të Bibliotekës së Kongresit Amerikan, ofertë kjo e cila u mirëprit nga përfaqësuesit e kësaj biblioteke. Gjatë këtij takimi u shqyrtua edhe mundësia e organizimit të një ekspozite fotografike me materiale arkivore të ITShKSh në ambientet e Bibliotekës së Kongresit Amerikan. Përfshirja e botimeve të ITShKSh në fondin librar të Bibliotekës së Kongresit Amerikan, sipas Dr. Skender Asanit, paraqet një nga vlerat më domethënëse në kulturën e komunikimit ndërkontinental, aq më tepër kur në këtë bibliotekë janë përfshirë materiale kërkimore nga të gjitha pjesët e botës, në më shumë se 450 gjuhë.

Të jesh pjesë e fondit librar të Bibliotekës së Kongresit, siç u shpreh dr. Asani figurativisht, i bie që të notosh në një oqean të madh librash, edhe për faktin se kjo është një nga bibliotekat më të mëdha në botë.

Kjo është biblioteka kërkimore që i shërben zyrtarisht Kongresit të Shteteve të Bashkuara dhe është biblioteka kombëtare de facto e Shteteve të Bashkuara. Është institucioni më i vjetër kulturor federal në Shtetet e Bashkuara. Biblioteka është vendosur në tre ndërtesa në Capitol Hill në Uashington, DC, gjithashtu mban një qendër konservimi në Culpeper, Virxhinia. Funkcionet e bibliotekës mbikëqyren nga bibliotekari i Kongresit dhe ndërtesat e tij mirëmbahen nga arkitekti i Kapitolit – Kongresit Amerikan.

ITShKSh, në fokusin e interesimit të Departamentit të Shtetit Amerikan



Uashington – Në përmbyllje të vizitës në Uashington, hulumtuesit shkencor të ITShKSh-së, më 25 shtator patën një takim tepër të frytshëm me Stacy Bernard Davis Zv/drejtoreshë e Zyrës së të Dërguarit Special për Çështje të Holokaustit dhe Joanna Wulfsberg, zyrtare e Zyrës për Maqedoninë e Veriut për liritë fetare pranë Departamentit të Shtetit Amerikan.

Përvoja e ITShKSh-së në trajtimin e liritë fetare dhe të Holokaustit, ishte fokusi i këtij takimi, me ç’rast drejtori i ITSHKSH, prof.dr. Skender Asani, i informoi zyrtarët e lartë amerikanë me disa nga aktivitetet konkrete të Departamentit për edukimin dhe hulumtimin e Holokaustit dhe Departamentit për studimin e figurës së Gonxhe Bojashiut-Nënës Tereze. Në vëmendjen e nikoqirëve u sollën disa botime të këtyre departamenteve, duke veçuar me këtë rast librin “Legjislacioni bazik mbi antisemitizmin i mbretërisë bullgare”,

nga autorët Skender Asani, Nora Maliqi – Zylali dhe Vllado Popovski si dhe disa botime që kanë trajtuar emrin dhe figurën e Nënës Tereze.

Departamenti i Shtetit Amerikan deri më tani e ka përfshi ITShKSh-në në dy raportet vjetore mbi liritë fetare në botë, duke e veçuar kontributin e këtij Instituti në trajtimin e problematikave që inkurajojnë luftimin e antisemitizmit dhe luftimin e mohimit të Holokaustit.

Zyrtarët e lartë të Departamentit Amerikan, gjatë këtij takimi shprehën interesimin e tyre që edhe në të ardhmen të ndjekin nga afër veprimtarinë hulumtuese e shkencore të ITShKSh-së, siç edhe kanë vepruar deri më tani dhe premtuan se ITShKSh në vazhdimësi do ta ketë vëmendjen e tyre.

Thithja e përvojave të avancuara amerikane në fushën e lirive fetare dhe luftimin e devijimeve të ndryshme shoqërore, ka qenë dhe mbetet preokupim i ITShKSh-së, kurse dëshmi e këtyre përvojave është se tre përfaqësuesit e ITShKSh që aktualisht po qëndrojnë në Uashington, janë alumni amerikan, si shprehje përkushtimit dhe vizitave të shumta studimore në qendrat e ndryshme hulumtuese e akademike amerikane.

Valdeta Kasapi mori titullin doktore e komunikologjisë



Shkup – Më 29 shtator, hulumtuesja shkencore e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Valdeta Kasapi mori titullin doktore e shkencave të komunikologjisë. Ajo mbrojti me sukses disertacionin e doktoraturës me temë “Përdorimi i gjuhës në televizionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut – në kontekst të proceseve demokratike në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut (analiza krahasimtare e televizioneve në gjuhën maqedonase dhe shqipe nga viti 200 deri në vitin 2018).

Kasapi, disertacionin e saj e mbrojti para Komisionit në përbërje Prof. dr. Vllado Popovski (mentor- Fakulteti Juridik- Shkup), Prof. dr. Dona Kollar – Panov (profesore e komunikimit), Prof. dr. Irena Rajçinovska – Pandeva (profesore e shkencave politike-Fakulteti Juridik- Shkup), Prof. dr. Sefer Tahiri (këshilltar shkencor – Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të

Shqiptarëve- Shkup) dhe Prof. dr. Jasna Bačevska (profesore e Fakultetit Juridik- Shkup).

Komisioni vlerësoi se punimi i doktoraturës është me vlerë të madhe shkencore dhe ka rëndësi të madhe shoqërore, pasi trajton një temë e cila drejtpërdrejt është e lidhur me ndërtimin e shoqërisë shumë -kulturore dhe ndër -kulturore në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni dhe mentori vlerësuan se doktoratura e Kasapit është tekst i gjallë. Në të ajo krijon relacione me autorë profesional dhe shkencor të fushës, por edhe me publikime shkencore. “Ajo rezonon, asocon, analizon, e shfaq mendimin e saj, jep vlerësime, por edhe konstatime dhe gjykime për qëndrime të personaliteteve të njohura të shkencës. Punimi i saj mund të zgjojë jo vetëm interes, por është edhe provokues, por në asnjë moment nuk është i mërzhitshëm. Karakteri i punimit të Kasapit nxit dhe mobilizon intelektualisht, teorikisht, profesionalisht, por edhe në aspektin veprues dhe praktik. Ky punim është origjinal dhe si i tillë do të zgjojë shumë diskutime dhe polemika”.

Valdeta Kasapi nga viti 2018 është asistente – hulumtuese në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup.

ITShKSh dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, me strategji të re bashkëpunimi



Shkup – Më 28 shtator në ITShKSh u realizua një takim pune me përfaqësuesit e Akademisë së Studimeve Albanologjike nga Tirana, udhëhequr nga drejtorët Skender Asani dhe Luan Përzhita. Ky takim pune u realizua në kuadër të bashkëpunimit institucional, i cili tash e tutje do të vendoset në korniza të mirëfillta të aktiviteteve e projekteve që do të realizohen në periudhën e ardhshme. Për këtë qëllim do të nënshkruhet edhe një memorandum në mes të ITShKSh, Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në takim u konstatua se bashkëpunimi shkencor brendashqiptar duhet të zhvillohet në kuadër të institucioneve, e jo në mes të individëve e klaneve të ndryshme me ç’rast do të formohen grupe punuese të cilët do të përgatisin strategjinë e bashkëpunimit.

Asani i njoftoi kolegët nga Tirana me profilin dhe strukturën organizative e shkencore të ITShKSh – së, duke potencuar me këtë rast se studimet albanologjike kanë nevojë për një trajtim më serioz, për arsye se në të kaluarën ka pasur tendenca që të deformohet e kaluara e shqiptarëve. Kjo ka qenë edhe

arsyeja që ITShKSh-ja ka hapur disa qendra hulumtuese-muzeale, të cilat do të merren kryesisht me trashëgiminë materiale-kulturore të shqiptarëve.

ITShKSh-ja dhe Akademia e Studimeve Albanologjike do t'i koordinojnë aktivitetet në organizimin e konferencave të përbashkëta shkencore si dhe do të bashkëpunojnë në fushën e botimeve, duke i dhënë përparësi me këtë rast edhe paraqitjes së autorëve të të dyja qendrave albanologjike në revistat ekzistuese shkencore që i kanë ato.

U promovua romani “Udhëkryqi” i shkrimtarit Ramadan Rexhepi



Shkup – Më 1 tetor në ITShKSh u promovua romani “Udhëkryqi” i shkrimtarit Ramadan Rexhepi, botuar nga Agoraprint e Shkupit. Me këtë rast, drejtori i Institutit, prof.dr. Skender Asani, nënvizoi se vlerat që mbart në vete romani i tij që po promovohet i karakterizon pasioni i autorit për të gjurmuar thellësinë e problematikave e ngjarjeve nëpër të cilat kalonin shqiptarët në vitet pesëdhjetë e gjashtëdhjetë. Një autori i si Ramadan Rexhepi, tha Asani, është modeli i shkrimtarit të përkushtuar ndaj letrarizimit të tematikës kombëtare në një vepër konkrete, siç është romani “Udhëkryqi”.

Në kuadër të këtij promovimi, drejtori Asani pranoi disa dokumente autentike nga fondi personal i shkrimtarit dhe veprimtarit Ramadan Rexhepi, i cili për gati gjashtë dekada ka mbajtur gjallë shpirtin e mërgatës shqiptare në Skandinavi me veprimtari të larmishme kulturore e politike.

Për rëndësinë e botimit të kësaj vepre në Shkup, foli botuesi Emin Azemi, i cili potencoi se vlera e një shkrimtari matet me prurjet dhe risitë që sjell në veprën e tij, kurse një botues do të vlerësohet për sensin e përzgjedhjes së

veprave që do t'i botojë. "Jam munduar që këtë parim ta zbatoj para se të vendosja ta botoja romanin 'Udhëkryqi' të shkrimtarit tonë disident Ramadan Rexhepi, vepra e të cilit ende ndodhet e shpërndarë nëpër fajle dhe dorëshkrime të autorit. Ky roman, të cilin po e promovojmë sot, ka një histori interesante, siç janë interesante të gjitha ngjarjet që shënojnë një epokë. Në epokën e letrave shqipe, Ramadan Rexhepi, ka qenë një yll i cili ka shndërritur nga një largësi e madhe gati kosmike, për shkak të rrethenave që kaloi autori dhe vepra e tij, e cila nuk arriti të komunikoj në parametra normal me lexuesin atëherë kur ajo u shkrua", tha Azemi.

Këtë roman, Ramadan Rexhepi nisi ta shkruajë që në vitin 1957 dhe vazhdoi me vite të tëra, duke e rimarrë e përpunuar disa herë. E botojmë 2010, me titullin "Stina e emrave të bukur". Dorën e fundit i dha në shtator të vitit 2018, duke kthyer dhe titullin e fillimit "Udhëkryqi", tha studiuesi dhe shkrimtari Anton Nikë Berisha.

Duke folur për vlerat estetike të kësaj veptre, Nehas Sopaj, tha se ngjarjet e romanit zhvillohen në vitet '50 dhe '60 të shekullit të kaluar, kurse ambienti ku i lokalizon shkrimtari ngjarjet, janë Presheva, Kumanova, Gjilani dhe Shkupi, ambienti i Karadakut i cili qindpërqind paraqet kronotopin e temës: udhëkryqi veri – jug, lindje – perëndim me ngjarjet ndër më dramatiket historike shqiptare të kohës së shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi.

Mbi bashkëpunimin dhe raportet e tij profesionale me shkrimtarin Ramadan Rexhepi, foli poeti dhe botuesi nga Gjilani, Sabit Rrusemi, sipas të cilit, ky roman ka fatin e njejtë me atë të popullit shqiptar. Në këtë promovim u lexuan edhe disa fragmente nga romani "Udhëkryqi", të cilat i deklamoi me një ndjeshmëri të lartë artistike Xhezide Selimi.

Vëmendjen e të pranishmëve në këtë promovim e tërhoqi fjala e e autorit Ramadan Rexhepi, i cili tha se fjala "udhëkryq" në kuptimin e figurshëm ka kuptimin e gjendjes ku qëndrojmë aty ku kryqëzohen dy rrugë ose dy botëkuptime dhe duhet të vendosim se ç'drejtim do të marrim. "Unë vendosa ta përdor këtë fjalë si udhëkryq të kombit", nënvizoi autori, duke shtuar se libri që po ua vëmë në dorë sot ishte i ndaluar të shkruhej dikur. Këtë libër s'duhej ta lexonin shqiptarët. Jam fort i lumtur që sot, shqiptarët e rinj mund të lexojnë mbi të shkuarën e tyre por pa i burgosur e keqtrajtuar njeri, u shpreh ai.

Romani "Udhëkryqi" i shkrimtarit Ramada Rexhepi shënon edhe startin e shtëpisë botuese Agoraprint nga Shkupi.

ITShKSh thellon bashkëpunimin me Aleancën Franceze në Tetovë



Shkup – Më 15 tetor në Institutin e Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup, e vizitoi drejtori i Aleancës Franceze në Tetovë, Stephane Aucante (Stefan Okant), i cili u prit nga drejtori i Institutit, Skender Asani, me bashkëpunëtorët e tij, Sefer Tahiri- sekretari shkencor i Institutit, Emin Azemi - udhëheqës i Departamentit të letërsisë, Besnik Rameti - udhëheqës i Departamentit të Historisë, si dhe përkthyesi në Ambasadën e Francës në Shkup, në Institutin Francez dhe në Aleancën Franceze në Tetovë, njëkohësisht hulumtues shkencor në Departamentin e Holokaustit në ITShKSh, Ardian Ramadani.

Aleanca Franceze në Tetovë, është pjesë e mozaikut të rrjetit diplomatik dhe kulturor të Francës në Maqedoninë e Veriut, e mbështetur nga Ambasada e Francës në Shkup dhe Instituti Francez në Shkup.

Drejtori i ITShKSh-së, Asani e njoftoi mysafirin me historikun e themelimit të Institutit si dh me aktivitetet, botimet, sfidat me të cilat ballafaqohet. Sipas tij, Instituti ndjek një politikë të hapur me mundësi kreative për djalje në treg me

vlera eide që janë kompatible me standardet e avancuara të dijes dhe hulumtimit shkencor. Ai vuri në dukje edhe nevojën e bashkëpunimit me institucionet përkatëse franceze, me të cilët mund të zhvillohen ide e projekte të përbashkëta, ku përvoja dhe dija do të kenë mundësi të këmbehen.

Aucante prezantoi aktivitetet e institucionit që drejton, që është edhe promotor i frankofonisë në Tetovë dhe në rajon. Ai është edhe shkrimtar, autor i 8 librave, në mesin e të cilave edhe “Blanche, au fil des jours” (E bardha, nga ditë në ditë), që iu dhurua ITSHKSH-së. Në këtë roman personazh qendror është një zonjë plakë, e cila e kapluar nga sëmundja e Alzajmerit, mezi ia del t'i bëjë ballë ditëve, javëve dhe muajve të ngërthyer nga pandemia COVID-19, e ballafaquar me vetminë dhe me sëmundjen e saj, duke nxjerrë në pah përpjekjen e qenies njerëzore për mbijetesë, në korniza të një lufte me armikun e panjohur.

Ky takim kaloi edhe në shenjë të këmbimit të veprave, me çrast drejtori, Asani i dhuroi Aucante-s një sërë librash të botuara nga instituti, si dhe e ftoi atë për pjesëmarrje në tribuna shkencore, seminare, konferenca. Mysafiri shprehu konsiderata të thella dhe falënderime të posaçme, duke u zotuar se do të merre së shpejti pjesë në një konferencë të Ballkanologjisë, që do të organizohet nga ITShKSh-ja, me një temë mjaft interesante nga krijimtaria e Ismail Kadaresë.

Bashkëbiseduesit u zotuan për thellim dhe forcim të bashkëpunimit dypalësh, mes ITShKSh-së nga njëra anë dhe Ambasadës së Francës në Shkup, Instituti Francez në Shkup dhe Aleancës Franceze në Tetovë, nga ana tjetër. Krejt në fund, Stephane Aucante, vizitoi sallën e konferencave në Institutit, ekspozitën me rastin e 100 vjetorit kushtuar Marrëveshjes së Versajës, ekspozitën kushtuar Kongresit të Manastirit, si dhe ekspozitën kushtuar figurës nobeliste shqiptare, Gonxhe Bojaxhiut - Nënë Terezë.

Vepra e Jusuf Buxhovit sfidon makinerinë e deformimit të historiografisë



Shkup – Më 22 tetor në ITShKSh u promovua vepra "Maqedonia nga antika deri te koha jonë" e autorit Jusuf Buxhovi, ku të pranishëm, përpos studiuesve e dashmirëve të librit, ishte edhe botuesi nga SHBA-të, Ramiz Tafilaj si dhe donatori dhe botuesi Milaim Abdullahu. Me këtë rast drejtori i Institutit, Skender Asani, vuri në dukje se historiografia shqiptare po pasurohet me një horizont të ri pikëpamjesh mbi konceptimin e tërësisë territoriale iliro-arbërore-shqiptare, që nga antika e deri te Ipeshkvia Shkup-Prizren.

Maqedonia antike ishte një nga nyjat kryesore që dëshmon qenësinë e elementit shqiptar, kurse vepra e Buxhovit e argumenton këtë me një pasuri referencash shkencore, kryesisht të autorëve të huaj. Sipas Asanit, qasja e historianëve duhet të ketë si udhërrëfim parimin e shtrirjes horizontale të elementit shqiptar, e jo të bëhen peng i pikëpamjeve të ngushta politike.

Infrastruktura e falsifikimit sllav ka qenë shumë aktive dhe kjo ka ndikuar që vlerësimi mbi proceset e ngjarjet historike të mos përkojnë fare me faktografinë shkencore, tha autori Jusuf Buxhovi, i cili duke u ndërlidhur me promovimin e librit, tha se fatkeqësisht jo pak autorë shqiptarë kanë rënë në grackën e kësaj makinerie falsifikimi. Kjo, sipas Buxhovit, ka ndodhur si pasojë e mungesës së një vlerësimi institucional, ku historianët shqiptarë kanë rënë në dy kurthe: në kurthin idilogjik dhe në kurthin e diktatit serbomadh.

Historiografia e ashtuquajtur zyrtare, tha Buxhovi, ka bërë gabime metodologjike dhe parimore kur është përcaktuar për një histori të cunguar të shqiptarëve, me ç'rast ka ndodhur stërkeqja shkencore e politike e historisë, ku Maqedonia padrejtësisht është hequr tërësisht nga historia e përbashkët e shqiptarëve. Ky, sipas Buxhovit, është një krim historik dhe neve si historian objektiv na takon ta themi të vërtetën, sepse Maqedonia i takonte botës ilire, kurse Shkupi ishte kryeqyteti shpirtëror i shqiptarëve. Historia shqiptare pa Maqedoninë, pa Epirin dhe pa Dardaninë është histori koti, tha Jusuf Buxhovi dhe vuri në dukje se historiografia shqiptare duhet të lirohet, përpos nga diktati ideologjik, edhe nga diktati serbomadh. Për pasojë, ka ndodhur një shtrembërim i qëllimshëm i tezave mbi gjoja ekzistimin e shtetit mesjetar serb. Sipas Buxhovit, nuk ka pasur shtet mesjetar serb, kurse i ashtuquajturi "Zakonik Cara Dusana" është sajuar në shekullin e XIX.

Duke folur për veprën "Maqedonia nga antika deri te koha jonë" e autorit Jusuf Buxhovi, Besnik Rameti, shef i Departamentit të Historisë në ITShKSh nënvizoi se për Maqedoninë antike autori mbështetet tek veprat e autorëve antik si Homeri, Tukididi, Herodoti, Apiani, Polibi, Straboni, tek autorët mesjetar dhe tek Rilindasit tanë kombëtar.

Publicisti dhe studiuesi Emin Azemi vlerësoi se vepra historiografike e Jusuf Buxhovit ka hapur mundësi të shumta për debate e polemika, mirëpo ai kërkoi që paraprakisht duhet lexuar dhe studiuar kjo vepër, sepse ndodhë që individë të ndryshëm pa e lexuar dhe për motive krejt subjektive janë të prirur ta etiketojnë autorin dhe veprën e tij..

Edhe Ylber Sela, drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve ishte i mendimit se Jusuf Buxhovi para lexuesve po paraqitet me një vepër të rëndësishme e cila kërkon qasje serioze, sepse përpos fuqisë argumentuese, ofron edhe një regjistër të gjatë referencash shkencore, që e bëjnë këtë vepër të jetë rezistuese ndaj çfarëdo lloj kritike dhe paragjykimi.

Konsultë në Shkodër - drejt një strategjie të albanologjisë



Shkodër – A do të vazhdojë albanologjia me statusin e një qendre të kërkimit shkencor që i kërcënohet kohë pas kohe pavarësia? A është kjo shkencë në vendin e saj dhe a mbështetet sa duhet nga shteti? Çfarë duhet të bëjë vetë albanologjia për të mos qenë një shkencë lokale por evropiane? Nga këto çështje, më 26 tetor nisi konsulta “Drejt një strategjie të albanologjisë” e mbajtur në Shkodër në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, me pjesëmarrjen e tri qendrave albanologjike të Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit.

Këto pyetje u shtruan fillimisht nga prof. dr. Luan Përzhita, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike, por në vazhdim doli se ndajnë të njëjtat shqetësime edhe Instituti Albanologjik i Prishtinës bashkë me Institutin e Historisë “Ali Hadri”, krahas Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup përfaqësuar nga dr. Skender Asani dhe prej Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës e RMV-së po në Shkup përfaqësuar nga prof. dr. Ylber Sela. Veçanërisht këtyre dy strukturave albanologjike në Shkup u duhet të përpiqen dyfish për statusin e një etnie që kërkon të ruajë identitetin e vet shqiptar.

Me këtë rast, drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, tha se ka një tendencë burokratike për zbehjen e rolit të shkencave albanologjike në avancimin dhe konsolidimin e çështjeve që lidhen me korpusin e temave e problemeve identitare. Për rrjedhojë, jo vetëm që është tepër shqetëuese tendenca për ngulfatjen e zërave që artikulojnë çështje identitare, por është edhe absurde që nga albanologjia të kërkohet të bëhet zorrë qorre e Akademive tona të Shkencave e Arteve.

Ky shqetësim vie në shprehje sidomos në Shkup, pasi që atje thyhen shtizat e betejave identitare, ku ITShKSh-ja i ka zhvilluar me sukses ato beteja, duke u përfshi në një treg më të gjerë idesh e projektesh. "Instituti ynë ka dalë shumë fuqishëm mbi sipërfaqen e amullisë ekzituese dhe kjo me siguri nuk iu konvenon atyre që duan status quo. Ata nuk duan që idetë shkencore t'iu prijnë proceseve shoqërore, prandaj të vetmin instrument që tani për tani përdorin është të disiplojnë institutet, madje edhe t'i lënë pa buxhet, siç ka ndodhur me Institutin tonë, dhe pastaj t'i fusin ato nën tutelën e Akademive të Shkencave dhe Arteve. Këto të fundit, që është një realitet i ngjashëm edhe në Tiranë dhe në Prishtinë, ka kohë që nuk po e kryejnë misionin e tyre bazik dhe për të kompenzuar këtë pasivitet, tani kanë shpikur integrimin, gjegjësisht, shkrirjen e instituteve nën ombrellën e akademive", u shpreh Asani.

Sipas Asanit, instutet shkencore tash më kanë krijuar fizionominë dhe autoniminë e tyre të veprimit. Me projekte konkrete në terren dhe me botime e konferenca të ndryshme shkencore, institutet tona janë shndërruar në asete kombëtare dhe si të tillë ato po e trasojnë edhe rrugën e mendimit të mirëfillt shkencor.

Konferenca “Ballkani midis integritit evropian dhe bashkëpunimit rajonal”



Shkup – Më 28 tetor, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, organizoi edicionin e katërt me radhë të konferencës shkencore ndërkombëtare “Ballkanologjia”, e cila sivjet temë boshte e kishte “Ballkanin midis integritit evropian dhe bashkëpunimit rajonal”.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, tha se duke qenë gjithmonë në hap me tendencat evropiane të zhvillimit të mendimit dhe projektimit të ideve konkrete, edhe ITShKSh përmes kësaj konference shkencore synon të nxjerr në pah aspektet humane të përafritimit në mes të popujve, duke nxjerrë në treg konkurrencën e dijes dhe hulumtimit shkencor. Deri më tani, përmes departamenteve tona si dhe përmes botimeve e aktiviteteve të ndryshme, ne si Institut jemi munduar të sjellim një qasje të re dhe krejt origjinale në tejkalimin e kontradiktave në mes të shoqërive, popujve dhe shteteve, tha Asani.

Në fjalën përshëndetëse, ministri i Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha se “Ballkani Perëndimor ose siç dua ta potencoj e që mendoj se është emërim më adekuat Evropa Juglindore, nuk është ishull i izoluar, por gjendet në zemrën e Evropës. Të gjitha lidhjet tona, të gjitha rrugët tona kryqëzohen me BE-në, procesi i eurointegritimit dhe procesi i bashkëpunimit rajonal plotësohen dhe çojnë drejt qëllimit të njëjtë, anëtarësimin e rajonit në BE”, u shpreh Osmani.

Fjalë përshëndetëse pati edhe drejtori i Agjencisë për Përdorimin e Gjuhëve në Maqedoninë e Veriut, Ylber Sela, si dhe pasardhësi i Hasan Prishtinës, Mehmet Prishtina.

Më pas u bë promovimi i përmbledhjes shkencore “Ballkanologjia III”, për të cilën referoi koordinatori i konferencës dhe kryeredaktori i këtij botimi Sefer Tahiri. Më pas, në kuadër të konferencës shkencore “Ballkani midis integritimit evropian dhe bashkëpunimit rajonal”, u shtjelluan tema tejet të rëndësishme dhe aktuale.

Kështu, referuesi i parë që u paraqit me kumtesën e tij ishte Sylë Ukshini, i cili përmes një analize të detajuar shtjelloi Minishengenin ballkank si instrument politik të Serbisë për anashkalimin e Kosovës. Konferenca vijoi me kumtesën virtuale të studiuesit, Anton Pançev nga Universiteti i Sofjes “Shën Klimenti i Ohrit”, i cili shtjelloi “Ideologjitë e vjetra si pengesë për integrim në BE”. Studiuesi i radhës, profesori nga Kosova, gjegjësisht nga Instituti Shqiptar i Gjeopolitikës, Sadri Ramabaja u paraqit me temën “Projekti i Novisadit alias “Ballkani i Hapur” dhe gjeopolitika postmoderne serbe”. Studiuesja dhe profesoresha nga Universiteti “Vizion” në Gostivar, Vesna Popovska, u paraqit me kumtesën e saj me titull “Pan evropianizmi kundrejt euroskepticizmit - përfitimet dhe sfidat nga qëndrueshmëria e agjendës evropiane në rajon”. Studiuesi dhe Besnik Rameti nga ITShKSh-ja, u paraqit me kumtesën “Ndikimi i projekteve hegjemoniste ndaj vonimit të proceseve integruese të vendeve të Ballkanit”. Më tutje, Ana Çupevska nga Universiteti “Kiril dhe Metodi”, foli në temën “Paradigma bashkëkohore e politikës së jashtme për ndërtimin e miqësisë në marrëdhëniet ndërkombëtare”. Konferenca vazhdoi punimet me kumtesën e prezantuar nga z. Isamedin Azizi nga ITShKSh-ja, me titull “Tendencat e bashkëpunimit rajonal të organizatave revolucionare në Ballkan”. Ramiz Zekaj, studiues nga Instituti i Edukimit, Trashëgimisë e Turizmit, paraqiti kumtesën “Marrëdhëniet Ndërfetarë në Ballkan dhe Multikulturalizmi në BE”. Më tutje, në kuadër së seancës së parë të konferencës, u paraqit Rubin Zemon

nga Qendra për Hulumtime të Avancuara, i cili shtjelloi kumtesën “Ballkani midis koncepteve për shtete kombëtare dhe shoqëri qytetare”. Referuesi i fundit në sesionin e parë ishte drejtori i Aleancës Franceze në Tetovë, Stephane Aucante, me kumtesën “Pallati i ëndrrave i Ismail Kadaresë, ose makthi komunist sipas një Evrope të caktuar”.

Sesioni i dytë i konferencës nisi me debatin mes pjesëmarrësve për temat e shtjelluara në sesionin e parë. Kështu, Rubin Zemon, Sylë Ukshini, Emin Azemi, Sadri Ramabaja dhe Skender Asani, e begatuan këtë pjesë të konferencës përmes ndërhyrjeve të tyre frytdhënëse, sugjerimeve dhe shtruarjes së mendimeve.

Pasoi kumtesa e parë me radhë, në sesionin e dytë të Minir Ademit nga ITShKSh-ja, si koautorë së bashku me Avni Avdiun nga Universiteti “Nëna Terezë” në Shkup, që trajtuan temën “Open Balkan: alternativë apo kurthi i radhës për shqiptarët...?!”. Më tutje, Ardian Ramadani nga ITShKSh-ja trajtoi temën “Panballkanizmi dhe Minishengeni Balkanik (Ballkani i Hapur) përballë europianizmit”. Liridona Veliu nga Dublin City University, në koautorësi me Adriana Cuppuleri, paraqiti kumtesën “Rusia në Ballkanin Perëndimor: Një studim i fuqisë së butë”. Studiuesi nga ITShKSh, Isamet Bakiu, paraqiti kumtesën “Integrimi i rajonit dhe roli i shqiptarëve në përplasjet mes fuqive të mëdha në Ballkan”. Konferenca vazhdoi punimet me kumtesën e Murat Aliut nga Universiteti “Nënë Tereza në Shkup, me titull “Nacionalizmi etnik si peng i integritetit europian: rasti i Maqedonisë së Veriut”. Me një video-prezantim, Kosovar Basha nga Instituti i Historisë në Prishtinë, paraqiti kumtesën “Konteksti historik i bashkëpunimit politik dhe shkencor midis Kosovës dhe Shqipërisë në vitin 1968”. Më tutje, përmes një video-prezantimi, Miftar Kurti, nga Instituti i Historisë në Prishtinë, paraqiti kumtesën “Roli dhe kontributi i Francës për paqen dhe lirinë e Kosovës”. Pasoi më tej kumtesa e Besnik Eminit nga ITShKSh-ja me titull “Qendra e Studimeve Ballkanike dhe bashkëpunimi kulturor në kuadër të vendeve të Ballkanit”. Dhe referuesi i fundit, Rini Useini, nga ITShKSh, paraqiti kumtesën “Shoqatat etnokulturore - ura ndërlidhëse midis antropologëve në Ballkan e më gjerë”.

Në fund, pas prezantimit të kumtesave, pasoi debati i shkurtër, ku me vërejtjet dhe ndërhyrjet e tyre i dhanë frymë dhe gjallëri konferencës disa studiues të pranishëm. Punimet e kësaj konference do të botohen në librin e radhës “Ballkanologjia 4”.

Konferencë shkencore kushtuar gjuhëtarit të shquar Qemal Murati



Shkup - Më 4 nëntor, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup u mbajt konferenca shkencore me titull “Kontributi i prof. dr. Qemal Muratit për gjuhësinë shqiptare”, ku referuan gjithsej 20 kumtues, të cilët dhanë vlerësimet e tyre shkencore për veprimtarinë shkencore të këtij gjuhëtarit të shquar.

Konferenca u hap me fjalët përshëndetëse të drejtorit të ITShKSH-së, Skender Asani, i cili e vlerësoi lart punën e madhe që e ka bërë prof. Qemal Muratit për Institutin. Pas përfundimit të fjalimit, ai e nderoi prof. Qemalin me një mirënjohje për veprimtari jetësore.

Fjalë përshëndetëse, që përfundoi me një dekoratë për prof. Qemalin, pati edhe nga rektori i Universitetit “Fan Noli” të Korçës, prof. Dhimitër Bello.

Në pjesën solemne të pranishmëve iu drejtua edhe drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës, Dr. Ylber Sela, i cili po ashtu e nderoi prof. Qemalin me një dhuratë simbolike kujtimi.

Pastaj vazhduan dy sesionet shkencore, në të cilat referuan studiuesit Emil Lafe, Xhevat Lloshi, Rami Memushaj, Ali Jashari, Avzi Mustafa, Dimitar Pandev, Valter Memisha, bardhosh Gaçe, Dhimitër Bello, Shefkije Islamaj, Nexhip Mërkuri, Rusana Hristova-Bejleri, Kujtim Kapllani, Mirushe Hoxha, Viktor Bakillari, Valbona Toska, Artur Lamaj, Hidajete Azizi, Zeqirija Ibrahim, Jolanda Lila dhe Idaetet Sinani.

Konferenca u mbyll me fjalën falënderuese të prof. Qemal Muratit, si dhe leximin e konkluzioneve të kësaj konference.

Maqedonia e Veriut bëhet anëtare e plotë e IHRA-s, meritot ITShKSh-ja



INTERNATIONAL HOLOCAUST REMEMBRANCE ALLIANCE

Shkup / Selanik – Republika e Maqedonisë së Veriut është pranuar si anëtare e plotë e Aleancës Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit (IHRA). Në kuadër të kryesimit grek me Aleancën Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit (IHRA), nga data 2-10 nëntor 2021, u mbajtën mbledhjet plenare (online #IHRAfromThessaloniki), në të cilën njëzëri u mor vendimi për pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut si anëtare e plotfuqishme e 35-të e IHRA.

Merita kryesore për këtë anëtarësim i takon Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, i cili është ndër institucionet e rralla në rajon që ka një strategji dhe një orientim në kultivimin e programeve studimore e edukuese në trajtimin e Holokaustit. Në kuadër të ITSHKSH tash më tri vjet funksionon Departamenti për kujtimin dhe edukimin e Holokaustit, kurse në strategjinë e këtij Departamenti përfshihen një mori projektesh e aktiviteteve.

Qeveria e Maqedonisë së Veriut ia kishte besuar këtij Departamenti botimin e Doracakut për edukimin për holokaustin, në katër gjuhë (shqip, maqedonisht, serbisht dhe turqisht), të cilin projekt në afat rekord instituti e realizoi. Doracaku katër gjuhësh për mësimet nga Holokausti, përmes përparimit dhe promovimit të arsimit, kujtimit dhe studimit të holokaustit, nderon viktimat, por gjithashtu gjeneratat e reja do të mësojnë për pasojat e krimit më të madh

mbi njerëzimin. Në këtë mënyrë është krijuar baze e fortë për krijimin e infrastrukturës shkencore dhe hulumtuese, përfshi edhe botimin e memoareve të mbijetuarve të Holokaustit, të cilat ITShKSh i ka marrë përsipër dhe me sukses ia ka plasuar opinionit publik. Pastaj është botuar libri tregjuhësh “Legjislacioni bazik mbi antisemitizmin i Mbretërisë Bullgare” – një përmbledhje dokumentesh nga autorët: Skender Asani, Nora Maliqi – Zylali dhe Vllado Popovski.

Puna e ITShKSh-së në promovimin e vlerave humane, që kanë pasur si fokusim kujtimin dhe edukimin e Holokaustit, nuk ka mbetur pa u vërejtur nga institucionet kredibile ndërkombëtare, përfshi edhe Departamentin Amerikan të Shtetit, i cili e kishte potencuar punën e ITShKSh -së në dy raportet vjetore të tij.

Përkundër këtyre kontributeve të ITShKSh,-së megjithatë delegacioni i Maqedonisë së Veriut i kryesuar nga ambasadori Jovan Tegovski, siç mësojmë jozyrtarisht, është cilësuar nga IHRA me mangësi për arsye se nuk shprehu mozaikun shumetnik të Maqedonisë së Veriut. Kjo vërejtje mbase do të duhej të merret parasysh në të ardhmen në mënyrë që në përbërjen e delegacionit të Maqedonisë së Veriut në IHRA të përfshihen edhe përfaqësues nga komuniteti shqiptar, pse jo edhe nga ITShKSh-ja.

IHRA është një organizatë ndërqeveritare e cila paraqet platform ku përfaqësues të qeverive të shteteve anëtare, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë shkëmbejnë ide dhe përvoja mbi politikat dhe aktivitetet specifike në fushën e përkujtimit të Holokaustit, edukimit dhe hulumtimit, dhe së fundmi në fushën e gjenocidit ndaj romëve. Përveç Maqedonisë së Veriut, IHRA ka një numër të madh shtetesh anëtare të BE-së (25), SHBA, Izrael, Kanada, Argjentinë, Australi etj., si dhe disa partnerë të përhershëm ndërkombëtarë – OKB/UNESCO, Këshilli i Evropës, OSBE/ ODIHR, Komisioni Evropian dhe të tjerë.

ITShKSh promovon ditarin dyvëllimësh të shkrimtarit Fejzi Bojku



Shkup – Më 12 nëntor në ITShKSh u promovua “Ditari” (dy vëllimësh) i shkrimtarit Fejzi Bojku. Me këtë rast drejtori i Institutit, Skender Asani, shprehu kënaqësinë që një njeri i shquar i letrave shqipe, siç është shkrimtari Fejzi Bojku, ka arritur që të sistemojë kujtimet e tij në një ditar, i cili është edhe dëshmi e një kohe të errët për shqiptarët.

“Kontinuiteti i zhvillimit tonë kulturor e shoqëror nuk ka mundur të ndodhë edhe pa kontributin e intelektualëve e krijuesve. Në mesin e tyre është edhe shkrimtari Fejzi Bojku, vepra e të cilit ka shprehë vitalitetin dhe kreativitetin e shpirtit tonë krijues nëpër dekada”, nënvizoi Asani.

Duke u ndërlidhur me rëndësinë që paraqet mbajtja e ditarit, shkrimtari Xhabir Ahmeti tha se ky ditar është edhe një mirënjohje për njerëzit që u kanë bërë ballë furtunave e presioneve të ndryshme politike duke qëndruar vertikalisht me të vërtetën dhe vetëm me të vërtetën, por edhe qortim për njerëzit të cilët kanë rënë para provokimeve, jo vetëm për ngjarjet që i përshkruan Fejziu e që lidhen me jetën e tij dhe veçmas me proceset jo të lehta

politike të cilat e kanë ndjekur si hije “Flakën e vëllazërimit”, por ditari paraqet edhe një emanacion të gjërave të këqija dhe të qëndresës, në të njëjtën kohë.

Disa karakteristika të këtij ditari u veçuan edhe nga Emin Azemi i cili tha se pak kujt i kishte shkuar ndërmend se shkrimtari Fejzi Bojku në heshtje po shkruante edhe një letërsi tjetër. Kujtimet e tij që tani kanë marrë formën e ditarit për shumë çka i ngjajnë letërsisë dokumentare dhe memoaristikës kulturtologjike ndër ne.

Një komunikim mjaft i ngrohtë me të pranishmit në këtë promovim u krijua edhe me fjalët e vet autorit Fejzi Bojku, i cili pasi faleminderoi të gjithë ata që i kishin mundësuar që ky projekt të realizohet me sukses tha se ai ishte munduar të sistemoj kujtimet për një periudhë kohore kur ai kishte qenë bartës aktiv i angazhimeve profesionale në revistat për fëmijë dhe në vet gazetën “Flaka e Vëllazërimit”. Bojku tha se nuk kishte edhe e lehtë përballja me sfidat e kohës, prandaj atij i është dashur të mbaj një ekuilibër shpirtëror e njerëzor ndaj ngjarjeve e fenomeneve të kohës. Ai me këtë rast tregoi edhe për një angazhim mjaft të madh rreth përgatitjes së një monografie për gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, punë kjo që atë e kishte lidhur për disa muaj me arkivin e kësaj gazete. Ai u tregua i gatshëm që gjithë ky material arkivor të bëhet pjesë e fondit të ITShKSh-së, ku në të ardhmen mund të realizohet ndonjë projekt me karakter dokumentar rreth kësaj gazete.

Tirana, Prishtina dhe Shkupi, drejt një strategjie të përbashkët për albanologjinë



Shkup – Pas Shkodrës, në vigjilje të “Ditëve të Alfabetit”, Shkupi mblodhi albanologët shqiptarë në përpjekjen për të miratuar një strategji të përbashkët bashkëpunimi.

Skender Asani - drejtor i ITShKSh, Luan Përzhita - rektor i ASA (Tiranë) dhe Hysen Matoshi - drejtor i Institutit Albanologjik (Prishtinë), u dakorduan që të finalizojnë përgatitjet për një takim përmbyllës në Tiranë më 15 dhjetor, në kuadër të Ditëve të Albanologjisë, ku do të nënshkruhet Memorandumi i bashkëpunimit në mes të tri qendrave tona albanologjike.

Bashkëpunimi institucional në fushën e albanologjisë është i domosdoshëm për arsye se sfidat janë të shumta kurse ato mund të tejkalohen vetëm me një bashkërendim të mirëfilltë të projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta, u konstatua në këtë takim që u mbajt në ITShKSh në Shkup më 14 nëntor.

Abanologjia si fushë nuk është e pa lëruar, por është mjaft e copëzuar, falë qasjes së gabuar ndaj saj, ku për pasojë ka ndodhur që për një temë a figurë të

njëjtë të organizohen konferenca të shumta albanologjike në Tiranë e Prishtinë. Kjo është edhe arsye që në të ardhmen të evitohen këto dobësi dhe të përqendrohen kuadrot e albanologjisë në ato aktivitete e projekte që do të jenë fryt i një bashkërendimi paraprak.

Në takimin e Shkupit u dakordua shpallja e një kalendari të aktiviteteve të përbashkëta për vitin e ardhshëm, kurse si pikë kryesore në atë kalendar do të jetë shënimi i 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Albanologjia e mijëvjeçarit të ri - do të jetë sfida kryesore e qendrave tona albanologjike në Tiranë, Shkup e Prishtinë dhe, siç u tha në këtë takim, ITShKSh është një tregues i ndryshimeve të qasjes ndaj albanologjisë, i cili po luan një rol të rëndësishëm në adaptimin e albanologjisë kushteve e rrethanave të reja globalizuese. Në këtë drejtim u përmend Konferenca e Ballkanologjisë e cila organizohet tash e pesë vite, në të cilën, siç potencoi drejtori Asani, ITShKSh-ja është dëshmuar me projekte konkrete në adaptimin e studimeve albanologjike të fushave të tjera të përafërta, siç është Ballkanologjia, ku me pjesëmarrjen e tyre kanë qenë aktiv studiues të ndryshëm nga rajoni dhe Evropa.

Manifestimi tradicional “Ditët e Alfabetit”-2021, kushtuar arbëreshëve



Shkup – Më 14 nëntor në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, filloi edicioni i tretë i manifestimit tradicional kulturor-shkencor “Ditët e Alfabetit”, me temën qendrore: “Gjuha, letërsia, kultura dhe tradita arbëreshe”.

Në hapje të manifestimit, drejtori i ITShKSh-së Skender Asani, tha se neve si studiues na takon të hedhim më shumë dritë mbi specifikat e mbijetesës arbëreshe nëpër shekuj. “Na takon të zërthejmë edhe më tepër vitalitetin e arbëreshëve, të cilët për më shumë se gjashtë shekuj e ruajtën identitetin e tyre nëpërmjet përdorimit të gjuhës shqipe, traditave, zakoneve, kulturës e mënyrës së jetesës, besimit e riteve fetare”, tha Asani. Sipas tij, ITShKSh-ja me plot vetëdije iu ka qasë temës bosht që lidhet me letërsisë, gjuhën dhe traditën arbëreshe me qëllim të sensibilizimit të opinionit shkencor dhe jo vetëm, që ky komunitet i ynë të shpëtojë nga tendencat e asimilimit që po

ndodhin si rezultat i kontaktit me vendasit por edhe i globalizimit në çdo aspekt të veprimtarisë njerëzore.

Fillimin e këtij manifestimi e përshëndeti zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së RMV-së dhe ministri i Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, Artan Grubi. Ai tha se përmes këtyre manifestimeve që kanë vënë vulë në krijimin e identitetit shqiptar, ITShKSh në përpikshmëri po e përmbushë misionin për të cilin është themeluar në frymën e Marrëveshjes së Ohrit.

Më pas, fjalën e morën rektori i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, Luan Përzhita, dhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Hysen Matoshi, me të cilët ITShKSh-ja kultivon raporte të ngrohta bashkëpunimi në kuadër të trekëndësisht albanologjik Tiranë – Prishtinë – Shkup.

Fjalë rasti në hapje të këtij manifestimi patën edhe drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, Ylber Sela dhe drejtori i Agjencisë së Arkikave të Kosovës, Bedri Zyberaj.

Kryeredaktori i edicionit “Ditët e Alfabetit – II”, Sevdail Demiri, promovoi përmbledhjen e botuar me materialet e edicionit të dytë të këtij manifestimi, i cili vitin e kaluar iu kushtua iluministëve shqiptare.

Ndërsa në fund, soprano Besiana Mehmeti, e shoqëruar në piano nga Shkëlzen Baftjari, interpretoi këngën më të moçme shqiptare “Moj e bukura More”, e cila rrënjët i ka thellë në gjenezën arbëreshe.

Në “Ditët e Alfabetit -2021” në vijim do të ketë aktivitete të njëpasnjëshme deri më 22 nëntor, me ç’rast nga studiuesit e ndryshëm do të shtjellohen temat: “Letërsia arbëreshe në rrjedhë të shekujve”, “Gjuha arbëreshe, dëshmia kryesore e mbijetimit”, “Françesko Altimari studiues i gjuhës dhe i letërsisë arbëreshe”, “Matteo Mandala studiues i letërsisë dhe i filologjisë arbëreshe”, “Anton Nikë Berisha studiues i letërsisë së arbëreshëve të Italisë”, “Muzika arbëreshe”, dhe surpriza tjera.

Letërsia arbëreshe në rrjedhë të shekujve në “Ditët e Alfabetit”



Shkup – “Letërsia arbëreshe në rrjedhë të shekujve” ishte tema e ditës së 15 nëntorit në manifestimin tradicional kulturor–shkencor “Ditët e Alfabetit” në ITShKSh, me ç’rast referuan studiuës të njohur të letërsisë shqiptare.

Në fjalën e hapjes, udhëheqësi i Departamentit të Letërsisë Shqipe në ITShKSh, Emin Azemi, tha se arbëreshët i mbajti gjallë letërsia, qoftë ajo gojore apo e shkruar, kurse figurat historike, siç ishte ajo e Skënderbeut, për arbëreshët e Italisë përveç që nënkuptonin atdheun e të parëve, ato ishin edhe bërthama tematike e fabulare e krijimeve të tyre artistike. Kultura arbëreshe në përgjithësi dhe letërsia në veçanti për botën shqiptare paraqet kalendarin më të ndritshëm kulturologjik e emancipues. Letërsia artistike dhe gazetaria fillin e ka tek arbëreshët me poemën Këngët e Milosaos të De Radës dhe me të parën gazetë shqiptare “L’Albanese d’Italia”, gjithashtu e De Radës, në të cilën ai shprehu pikëpamjet e tij për ngjarjet e kohës, u shpreh Azemi.

Më tutje, studiuesi i njohur Anton Nikë Berisha nga Universiteti i Kalabrisë, foli në temën “Rreth letërsisë së arbëreshëve të Italisë”, Hamit Xhaferi nga Universiteti i Evropës Juglindore iu qas temës “Mbi disa veçanti të letërsisë arbëreshe”, Kamber Kamberi nga Universiteti i Gjakovës foli në temën: “Mbi krijimtarinë e Françesk Anton Santorit”. Studiuesi nga Universiteti i Shkupit Zeqirja Neziri referoi në temën: “Gjella e Shën Mëris Virgjër” (1762) e Jul Varibobës, Labinot Berisha në temën: “Neumenia” e Anton Santorit, tragjedia e parë në gjuhën shqipe (botimi i Prishtinës)”, dhe Arben Veselaj paraqiti kumtesën “De Rada, një pamje johistoriciste”. Studiuesi Arben Fetoshi pati një qasje të zgjeruar rreth librit “Triptikon arbëresh” të autorit Arben Veselaj.

Dhe krejt në fund, këngëtari i njohur Ilir Shaqiri, solli emocione të veçanta me interpretimin e këngës më të re nga repertori i tij me titull “Baladë për Zef Kakocën”, që i kushtohet kantautorit dhe artistit të madh arbëresh Zef Kakoca, i cili kohë më parë iku në amshim.

Në “Ditët e Alfabetit -2021” në vijim do të ketë aktivitete të njëpasnjëshme deri më 22 nëntor, me ç’rast nga studiues të ndryshëm do të shtjellohen temat: “Gjuha arbëreshe, dëshmia kryesore e mbijetimit”, “Françesko Altimari studiues i gjuhës dhe i letërsisë arbëreshe”, “Matteo Mandala studiues i letërsisë dhe i filologjisë arbëreshe”, “Anton Nikë Berisha studiues i letërsisë së arbëreshëve të Italisë”, “Muzika arbëreshe”, etj.

Gjuha arbëreshe, dëshmi e mbijetesës në “Ditët e Alfabetit”



Shkup – Tema kryesore e ditës së tretë (16 nëntor) të manifestimit tradicional kulturor–shkencor “Ditët e Alfabetit” në ITShKSh, ishte “Gjuha arbëreshe, dëshmia kryesore e mbijetimit”, me ç’rast studiues të ndryshëm shpërfaqën fuqinë mahnitëse të kësaj gjuhe, e cila mëse gjashtë shekuj ka arritur ta mbajë gjallë shpirtin arbëresh.

Në fjalën e hapjes, udhëheqësja e Departamentit të Gjuhës Shqipe në ITShKSh, Hidajete Azizi, tha se në historinë e përpjekjeve titanike të intelektualëve dhe patriotëve për të ruajtur gjuhën tonë të lashtë do të jetë i pashmangshëm edhe pikësynimi: një komb–një gjuhë. Prijatarë në këtë përpjekje të madhe e të mundimshme për një alfabet të përbashkët do të jenë pikërisht arbëreshët e Italisë, në krye me Jeronim de Radën. “Në këtë rast dua të kujtoj që deri më tani, Instituti ynë ka krijuar ura komunikimi me intelektualët arbëreshë, ndër të tjera, edhe përmes vizitës që i është bërë Institutit nga ana e një delegacioni

të arbëreshëve të Italisë, i udhëhequr nga studiuesi i njohur arbëresh, Francesco Altimari. Më pas, ky bashkëpunim është forcuar edhe me vizitën që i është bërë arbëreshëve të Italisë nga ana e Institutit tonë në vitin 2019 me qëllim të njohjes nga afër me kulturën dhe traditën arbëreshe”, u shpreh Azizi

Manifestimin e përshëndeti ministri i Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Jeton Shaqiri, i cili theksoi rëndësinë e këtij organizimi me qëllim të ruajtjes, studimit dhe kultivimit të vlerave të gjuhës së bukur shqipe, e cila tanimë ka statusin e saj zyrtar edhe në Maqedoninë e Veriut.

Studiuesi Mustafa Ibrahim, profesor i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, e parqiti kumtesën me titull: “Kontributi i arbëreshëve për alfabetin e shqipes në Kongresin e Manastirit”, duke u ndalur te disa personalitete të veçanta arbëreshe në kultivimin e shqipes.

Akademik Gjovalin Shkurtaç i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ka paraqitur temën: “Gjuha shqipe dhe shpirti i Arbrit në jetën dhe veprimtarinë e De Radës”.

Ndërsa, përmes video-prezantimit u paraqitën edhe kumtesat e studiueses nga Universiteti i Shkodrës Mimoza Priku: “Pasqyrimi i çështjeve të shqipes dhe të Shqipërisë në organin La Nazione Albanese”, Ardian Doka nga Universiteti i Tiranës me temën: “Çfarë e shpëtoi arbërishten?”, dhe Qemal Murati nga ITShKSh – Shkup paraqiti temën: “Bota dhe gjuha arbëreshe – një muze i gjallë i botës shqiptare”.

Në “Ditët e Alfabetit -2021” në vijim do të ketë aktivitete të njëpasnjëshme deri më 22 nëntor, me ç’rast nga studiues të ndryshëm do të shtjellohen edhe temat: “Françesko Altimari studiues i gjuhës dhe i letërsisë arbëreshe”, “Matteo Mandala studiues i letërsisë dhe i filologjisë arbëreshe”, “Anton Nikë Berisha studiues i letërsisë së arbëreshëve të Italisë”, “Muzika arbëreshe”, etj. Disa aktivitete do të zhvillohen edhe në ambientet e Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, e cila është mbështetëse e këtij manifestimi.

Françesko Altimari, në fokusin e interesimit shkencor



Shkup – Më 17 nëntor, në vazhdim të edicionit të sivjemë “Ditët e Alfabetit”, në kuadër temës bosht rreth letërsisë, gjuhës, kulturës dhe traditës së arbëreshëve të Italisë, u trajtua profili shkencor e intelektual i prof. Françesko Altimarit, njëra prej figurave më emblematike të botës arbëreshe. I pranishëm ishte edhe zv.ministri i Drejtësisë, Agim Nuhiu, i cili konfirmoi përkushtimin institucional ndaj aktiviteteve shkencore e kulturore të ITShKSh-së, të cilat organizohen në kuadër të manifestimit tradicional “Ditët e Alfabetit”.

Mbi rëndësinë e kësaj teme të përzgjedhur në fillim foli Hidajete Azisi, udhëheqëse e Departamentit të gjuhës shqipe në ITShKSh, e cila nënvizoi se prof. Françesko Altimari shquhet me aftësinë e tij për të krijuar ura të shumta komunikimi përmes opusit shumë të gjerë e kompleks shkencor nga fusha e filologjisë, jo vetëm arbëreshe por edhe të mbarë shqipes, ai do të shquhet si

një model i një filologu e gjuhëtari bashkëkohor, jo vetëm në kohë, por edhe në mendësi.

Mbi profilin shkencor e intelektual të prof. Altimarit, me një kumtesë përmbajtësore u paraqit prof. Anton Nikë Berisha, i cili vuri në dukje se është krejtësisht e natyrshme që Altimari vëmendjen kryesore në punën e vet ia kushtoi studimit të gjuhës së arbëreshëve të Italisë, përkatësisht të folmeve të saj. Ky përcaktim lidhet me faktin se këto të folme paraqesin një stad të hershëm të gjuhës sonë dhe se njohja e tyre nënkupton njohjen e disa veçantive të rëndësishme të shqipes në përgjithësi në një periudhë më të hershme, të ruajtur në forma të ndryshme edhe sot e gjithë ditën në të folmet e ngulimeve arbëreshe, tha prof Berisha.

Mbi Sistemin shkencor të studiuesit Françesko Altimari në rindërtimin dhe ribotimin e tekstit letrar, me një kumtesë interesante u paraqet prof. Floresha Dado nga Tirana. Ajo u ndal sidomos në metodologjinë rreth studimit të teksteve të letërsisë arbëreshe në një kontekst evropian dhe me gjerë. Me këtë rast ajo vlerësoi punën shkencore të prof. Altimarit në përgatitjen cilësore të kompletit të De Radës, që mund të shërbejë edhe si një model për të tjerët se si mund të studiohen shkrimtarët e traditës.

Për figurën komplekse të prof. Françesko Altimarit, me një kumtesë përmes video-lidhjes u paraqit edhe prof. Matteo Mandala nga Universiteti i Palermos, i cili vuri në dukje se Ak. Prof. Francesko Altimarin mund ta konsiderojmë me plot të drejtë dhe pa druajtje gabimi, novatorin më të suksesshëm në albanologjinë bashkëkohore.

Mateo Mandala, mjeshtër i letërsisë dhe i filologjisë arbëreshe



Shkup – Në kuadër të manifestimit tradicional kulturor–shkencor “Ditët e Alfabetit” në ITShKSh, më 18 nëntor u mbajt sesiioni shkencor kushtuar njëres nga figurat qendrore të letërsisë dhe i filologjisë arbëreshe, Matteo Mandala.

Në fjalën e hapjes, udhëheqësja e Departamentit të Gjuhës Shqipe në ITShKSh, Hidajete Azizi, tha se manifestimi tradicional “Ditët e Alfabetit” me temë qendrore për këtë vit “Gjuha, letërsia, kultura dhe tradita arbëreshe”, i organizuar me rastin e 113 vjetorit të Kongresit të Manastirit, ka për qëllim që të kontribuojë për njohjen, për pasurimin e prurjeve shkencore dhe krijimin e një komunikimi më të afërt me kulturën dhe traditën e krijuar ndër shekuj nga arbëreshët e Italisë.

“Sesioni i sotëm shkencor, i katërti me radhë në kuadër të këtij manifestimi, i kushtohet prof. dr. Mateo Mandala, profesor në universitetin e Palermos dhe

për shumë vjet përgjegjës i seksionit të albanologjisë në këtë universitet. Meritat e tij për filologjinë arbëreshe në përgjithësi dhe për filologjinë moderne shqiptare, në veçanti, janë të shumta. Mbi bazën e këtyre meritave, do të vlerësohet si njëri ndër albanologët më të shquar të kohës dhe njëri ndër themeluesit e filologjisë moderne shqiptare. Prurjet origjinale të tij në këto fusha, do ta ngrenë në piramidat më të larta të mendimit shkencor shqiptar në qarqet akademike universitare”, tha Azizi.

Manifestimin e përshëndeti zëvendësministri i Transportit dhe Lidhjeve, Bekim Rexhepi, në emër të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut.

Studiuesi nga Kosova, Anton Nikë Berisha, referoi në temën: “Matteo Mandalà studiues i mirëfilltë dhe gjurmues i përkushtuar i trashëgimisë arbëreshe”, duke shkoqitur disa sekuenca me interes për veprën e madhe shkencore të prof. Mandalasë.

Përmes një video – prezantimit, prof. Françesko Altimari nga Universiteti i Kalabrisë në Kozencë, referoi në temën: “Prof. Matteo Mandalà filolog dhe studiues i letërsisë”, dhe Emin Azemi nga ITShKSh foli për “Disa vlerësime të prof. Matteo Mandalà rreth poemës Kënka e sprasme e Balës e Gavril Darës”.

Në fund, vetë prof. Matteo Mandalà nga Hora e Arbëreshëve të Italisë në Sicili, përmes një video-prezantimi falënderoi për respektin e bërë dhe interesimin e zgjuar të ITShKSh-së në Shkup për të trajtuar këto tema të gjuhës, letërsisë, kulturës dhe traditës arbëreshe.

Profili shkencor e letrar i Anton Nikë Berishës



Shkup – Personaliteti shkencor, arsimor dhe letrar i Anton Nikë Berishes, ishte tema e sesionit shkencor të manifestimit “Ditët e Alfabetit”, zhvilluar më 19 nëntor në ambientet e Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, e cila është edhe mbështetëse e këtyre aktiviteteve.

Drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, në fjalën e tij tha se ndjehet i gëzuar që emri dhe vepra e prof. Berishës po bëhen shkas i punës sonë në kuadër të sesionit mbi gjuhën, letërsinë, kulturën dhe traditën e arbëreshëve të Italisë. “Me prof. Berishën na bashkon ideali për të nxjerr nga harresa vlerat tona shpirtërore, siç është edhe rasti me arbëreshët e Italisë. Ky angazhim yni është kambanë alarmi për institucionet tona për një mobilizim më të madh në rikthimin e vëmendjes ndaj botës arbëreshe”, u shpreh Asani.

Drejtori i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe, Ylber Sela, tha se institucioni që ai drejton po ndjekin rregullisht këto aktivitete kulturore – shkencore, dhe natyrisht se edhe ky i sotmi që i kushtohet studiuesit të njohur Anton Nikë Berisha, është një kontribut i rëndësishëm për të hedhur dritë mbi figurën e

këtij studiuesi që është marrë në mënyrë të veçantë me letërsinë dhe kulturën arbëreshe.

Në emër të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, manifestimin e përshëndeti zëvendësministri i Mbrojtjes, Bashkim Hasani.

Më tej, në pjesën shkencore, studiuesi arbëresh Françesko Altimari nga Universiteti i Kalabrisë në Kozencë të Italisë, përmes një video-prezantimi u paraqit me kumtesën: “Kontributi i Anton Nikë Berishës në studimin e letërsisë së arbëreshëve të Italisë”. Studiuesi dhe shkrimtari nga Shqipëria Bardhosh Gaçe, referoi në temën: “Anton Nikë Berisha dhe studimet e tij për letërsinë gojore arbëreshe”, shkrimtari nga Kosova Prend Buzhala pati temën: “Anton Nikë Berisha njohës dhe studiues i mirëfilltë i letërsisë së arbëreshëve të Italisë”, dhe Emin Azemi nga ITShKSh-ja me temën: “Profili shkencor e krijues i Anton Nikë Berishës”.

Krejt në fund, vetë Anton Nikë Berisha falënderoi Institutin dhe udhëheqjen e tij për nderimin e bërë, jo vetëm ndaj tij, por në përgjithësi ndaj kulturës dhe kauzës arbëreshe, e cila nga dita në ditë fatkeqësisht po zvetënohet.

Kënga dhe vallja arbëreshe ndër shekuj



Shkup – Muzika e pasur arbëreshe, më 20 nëntor ishte në fokusin e studiuësve në kuadër të manifestimit tradicional kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit” në ITShKSh – Shkup.

Në fjalën e hapjes, udhëheqësi i Departamentit të Etnologjisë në ITShKSh, Rini Useini, tha se me anë të këngëve dhe valleve, nëpërmjet riteve dhe manifestimeve, nëpërmjet haresë së përditshme apo edhe të krijimeve të reja muzikore, arbëreshët e kanë ruajtur më së miri identitetin e tyre të veçantë. “Arbëreshët shquhen për kolektivizmin e tyre, ata bashkëfestojnë dhe bashkëjetojnë me muzikën e traditën, dhe janë koshientë që tradita e tyre është shumëshekullore dhe atë e ruajnë në formën më të mirë. Kudo që të shkosh në hapësirën ku ka arbëresh e shikon se muzika është pjesë e jetës së tyre të përditshme”, tha Useini.

Më tej studiuesit paraqitën kumtesat e tyre për larminë dhe madhësinë e këngës dhe valles arbëreshe. Studiuesi Sami Piraj, prezantoi kumtesën me temë: “Bartja e frymës së muzikës arbëreshe në arealin muzikor shqiptar”. Studiuesja nga Kosova, Rreze Kryeziu, përmes një video-prezantimi paraqiti temën: “Muzika arbëreshe përmes krijimtarisë së kompozitorit Shime Deshpali”, me rastin e 40 vjetorit të vdekjes së kompozitorit. Më tej, studiuesja dhe soprano Besiana Mehmedi, referoi në temën: “Roli i muzikës në ruajtjen e gjuhës dhe traditave tek arbëreshët”, dhe Ermal Mehmeti e Jeta Starova – Mehmeti u prezantuan me temën: “Kultivimi i këngës arbëreshe”, ndërsa me violinë dhe flaut interpretuan një melodi arbëreshe.

Manifestimi “Ditët e Alfabetit -2021”, gjatë ditës vijuese aktivitetet i zhvendosi në Manastir, konkretisht në Muzeun e Alfabetit të Gjuhës Shqipe

Në Muzeun e Alfabetit bartet “kauza arbëreshe për shqipen”



Manastir – Në Muzeun e Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir, më 21 nëntor u zhvillua aktiviteti i parafundit në kuadër të manifestimit tradicional kulturor – shkencor “Ditët e Alfabetit”, organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup.

“Kauza arbëreshe për gjuhën shqipe dhe albanologjinë”, ishte tema ndërlidhëse e ditës së sotme, ku bashkë me vlerësimin e punës kolosale të arbëreshëve për gjuhën e bukur shqipe, u theksua edhe nevoja që ky komunitet të vlerësohet dhe përkrahët në përpjekjet titanike për ruajtjen e gjuhës dhe traditës së lashtë arbëreshe.

Me këtë rast, para të pranishmëve folën: drejtori i Muzeut të Alfabetit të Gjuhës Shqipe në Manastir – Zait Aliu, drejtori i ITShKSh në Shkup – Skender

Asani, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës Shqipe – Ylber Sela, kryeredaktori i edicionit ‘Ditët e Alfabetit’ në ITShKSh – Sevdail Demiri, dhe studiuesi Niko Kotherja.

Arbëreshët historikisht janë pikë e fortë e orientimit properëndimor dhe proevropian të kombit shqiptar, ndërsa gjuhën dhe traditën e tyre të lashtë, e kanë ruajtur e kultivuar edhe falë mendjendriturve të kombit, të cilët sot e 113 vjet më parë, pikërisht në Manastir përcaktuan dhe unifikuan shkronjat shqipe me bazament latin.

Aktiviteti i fundit i manifestimit të sivjetmë “Ditët e Alfabetit – 2021”, u zhvillua ditën e hënë, më 22 nëntor në ITShKSh – Shkup, me një solemnitet për 113-vjetorin e Kongresit të Manastirit dhe 14-vjetorin e ITShKSh-së, me praninë edhe të ambasadorëve të vendeve mike.

Ditëlindja e Alfabetit dhe e Institutit në një festë!



Shkup – Më 22 nëntor u mbajt solemniteti qendror i manifestimit kulturor-shkencor “Ditët e Alfabetit”, me rastin e shënimit të 113-vjetorit të Kongresit të Manastirit dhe 14- vjetorit të themelimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Në fjalën e hapjes, drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, tha se Kongresi i Alfabetit, mbajtur nga 14 – 22 nëntor 1908 në Manastir, e oksidentalizoi kulturën e shkrimit shqip, si një mundësi e favorshme për ta shkëputur rrjedhën e historisë nga anarkia e shkronjave me alfabete të ndryshme në një alfabet unik. “Duke kujtuar Kongresin e Alfabetit të mbajtur më 14 – 22 nëntor 1908, nervi i reagimit shkencor e kulturor bëhet më i prekshëm ndaj detyrimeve tona shoqërore e institucionale për gjuhën shqipe, si instrument mjaft i rëndësishëm në rrafshin e komunikimit shoqëror. Uroj që në vitet në vijim kultura e gjuhës dhe e komunikimit në mes të njerëzve të zgjerojnë dioptrinë e vrojtimit në ato pika ku e përbashkëta shkrihet në shtratin kohor të së ardhmes”, tha veç tjerash drejtori Asani.

“Ditët e Alfabetit” si manifestim tradicional shkencor e kulturor po vjen duke e marrë fizionominë e mirëfilltë edhe në saje të mbështetjes institucionale. Zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë dhe ministër i Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive, Artan Grubi, e përfshëndeti manifestimin, duke uruar gjithë shqiptarët për këtë festë kombëtare, dhe veçanërisht punonjësit e Institutit për ditëlindjen e këtij institucioni të rëndësishëm shkencor dhe kulturor në vend. “Tashmë 14 vite me radhë po e dëshmojmë edhe në mënyrë institucionale, përmes institucioneve tona që me përpikmëri realizojmë hulumtime shkencore, aktivitete arsimore dhe kulturore për të promovuar vlerat identitare të shqiptarëve të këtij vendi”, tha Grubi.

Me fjalë përshëndetëse në këtë solemnitet, të pranishmëve iu drejtuan edhe përfaqësues të lartë diplomatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si: zëvendësshefi i Misionit në Ambasadën e SHBA-së në Shkup – Eric Meyer, ambasadori i Francës – Cyrille Baumgartner, ambasadori i Italisë – Andrea Silvestri, ambasadori i Izraelit – Dan Orian, dhe ambasadori i shtetit amë Shqipërisë – Fatos Reka.

Të pranishmit i përshëndeti edhe profesor Anton Nikë Berisha – në emër të Universitetit të Kalabrisë dhe Pelermos, ku ende studiohet gjuha e kultura arbëreshe. Të pranishëm ishin edhe delegacioni nga Universiteti i Prizrenit, me në krye rektorin Samedin Krrabaj.

Gjatë nëntë ditëve, nga 14 e deri më 22 nëntor 2021, në manifestimin “Ditët e Alfabetit”, u shtjellua tema: gjuha, letërsia, kultura dhe tradita arbëreshe, e cila zgjoi interesim të madh jo vetëm në mesin e komunitetit arbëresh, por edhe të studiuesve të shumtë që morën pjesë me kumtesat e tyre nëpër sesionet e veçanta shkencore.

ITShKSh sublimon aktivitetet në festën e Pavarësisë në Vlorë



Tiranë / Shkup – Dita e Flamurit sublimoi edhe aktivitetet e shumta të ITShKSh-së, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtij institucioni në krye me drejtorin Skender Asani, në disa manifestime që lidheshin me këtë ditë të shenjtë të kombit tonë, që u zhvilluan më 28 dhe 29 nëntor.

Kështu, në Tiranë u përmbyll “Viti i Naimit” në një aktivitet promovues organizuar nga intelektualë dhe nga Kryegjshata botërore e bektasinjëve. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e ITSHKSH-së, kurse drejtori Asani me një fjalë përshëndetëse foli për kontributin dhe ndikimin e Naim Frashërit në kulturën shqiptare dhe njëherësh prezantoi edhe disa nga shtyllat më të rëndësishme të organizimit dhe profilimit të ITSHKSH-së.

Ceremonia zyrtare e shënimit të Ditës së Pavarësisë filloi paraditen e 28 nëntorit në Vlorë dhe bashkë me delegacionin e lartë qeveritar të Shqipërisë, lule të freskëta pranë monumentit të firmëtarëve të Pavarësisë së Shqipërisë

vendosën edhe përfasëuesit e ITShKSh-së. Këtij aktiviteti i parapriu pritja që na u bë tek kryebashkiaku i Vlorës Dritan Leli, të cilit i sollëm urimet vëllazërore nga Shkupi për këtë ditë të shënuar të kombit tonë!

Aspirata lirishtetërore e shqiptarëve nuk do të ishte e plotë pa mbështetjen e fuqishme të Amerikës. Kështu, në Vlorë, në këtë ditë të shenjtë të Pavarësisë, rrugët u bënë bashkë me ambasadorën e SHBA në Shqipëri, Shkëlqesinë e saj Juri Kim, e cila kishte ardhur për ta nderuar kujtimin ndaj kësaj feste tonë kombëtare. Ambasadores Kim, drejtori Asani i shprehu faleminderimet e singerta për gjithë përkushtimin amerikan ndaj çështjes shqiptare sot dhe në të kaluarën.

Aktivitetet në Vlorë u kurorëzuan me një prezantim të emisioneve të përzgjedhura "Autokton" të autores Anila Ahmataj, realizuar edhe në bashkëpunim me ITShKSh. Historia dhe dokumentariteti gërshetohen në këto emisione që patën si produkt edhe kontributin e ITShKSh-së si një nga institucionet shkencore që gjithnjë e më tepër po konsiderohet një referencë vërtetësie. Me këtë rast, drejtori Asani i njoftoi të pranishmit me tendencën që Instituti të bëhet një qendër mirëfillt e studimeve albalogjike, ku do të ketë hapësirë edhe për një konkurrencë në tregun e gjerë të ideve e mendimeve shkencore.

Krejt në fund, në sallën e Kinemasë së posarenovuar të qytetit të Vlorës, u bë edhe dorëzimi i bustit të Isa Boletinit, donacion i Mehmet Prishtinës.

Delegacioni i ITShKSh-së u prit nga kreu i BFI-së



Shkup – Më 1 dhjetor në selinë e Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, qëndroi në një vizitë zyrtare drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Skender Asani me bashkëpunëtorët e tij, Sevdail Demiri – kryetar i Këshillit të ITShKSh-së dhe hfz. Sabaatin Nuhiu – punëtor i Institutit. Ata u pritën nga kryetari i BFI-së – Reisul Ulemaja Shaqir Fetahu, i shoqëruar nga sekretari Irsal Jakupi, dhe shefi i Kabinetit Abdulkerim Iseini.

Të dy palët zhvilluan një bisedë të ngrohtë dhe profesionale për një bashkëpunim të mirëfilltë në mes dy institucioneve me peshë dhe ndikim të madh në sfera të ndryshme të hulumtimit shkencor.

Në veçanti u diskutua për zhvillimin e Departamentit të marrëdhënieve shqiptare-osmane në ITShKSh, si dhe kontributit të madh që ka dhënë ndër shekuj feja islame edhe në ndërtimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve.

Po ashtu, u ra në ujdi për një përkushtim më të theksuar të dy institucioneve në periudhën e ardhshme për realizimin e projekteve të përbashkëta, si botime dhe konferenca shkencore me interes të dyanshëm.

Drejtori Asani u prit nga ipeshkvi i Kosovës Dodë Gjergji



Prishtinë – Më 3 dhjetor, drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani me bashkëpunëtorë qëndroi në selinë e Ipeshkvisë së Kosovës në Katedralen ‘Nënë Tereza’ në Prishtinë, ku takua me Imzot Dodë Gjergjin – Ipeshkëv i Kosovës.

Të dy bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime lidhur me të kaluarën e shqiptarëve, veçanërisht atyre të Shkupit, një pjesë e të cilëve janë pjesë e komunitetit katolik, të cilit i takonte edhe familja e Gonxhe Bojaxhiut – Nënë Terezës.

Drejtori Asani e informoi ipeshkvin Gjergji lidhur me hapjen dhe zgjerimin e Institutit ndaj të gjitha komuniteteve fetare, që kanë kontribuar ndër shekuj në ndërtimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve. Me theks të veçantë u bisedua rreth Departamentit për trashëgiminë e Gonxhe Bojaxhiut – Nënë

Terezës në kuadër të ITShKSh-së, përmes të cilit do të ruhet dhe rivlerësohet kontributi i familjes Bojaxhiu në Shkup.

Të dy palët u dakorduan që në të ardhmen të bëjnë një agjendë aktiviteteve me interes të dyanshëm.

Në takim morën pjesë edhe kryetari i Këshillit të ITShKSh-së, Sevdail Demiri, udhëheqësi i Departamentit të Historisë në ITShKSh, Besnik Rameti, si dhe drejtuesi i revistës fetare – kulturore të Kishës Katolike në Kosovë – “Drita”, Don Fatmir Koliqi.

Në fund, ipeshkvi Gjergji ia dhuroi drejtorit Asani triologjinë e posabotuar me rrëfime “Kthimi”.

Dy promovime në Prishtinë të librit me 200 këngë të Ilir Shaqirit



Prishtinë – Më 6 dhjetor në Prishtinë, botimi më i ri i ITShKSh-së nga sfera e kulturës muzikore: “200 Këngë nga opusi muzikor i kantautorit Ilir Shaqiri”, me autor dr. Korab Shaqirin, përjetoi dy promovime.

Fillimisht libri u promovua në Kolegjin UBT, ku në emër të botuesit foli kryetari i Këshillit të Institutit, Sevdail Demiri, i cili para të pranishmëve tha se kjo vepër përbën një nga thesaret më të çmuara të trashëgimisë tonë kulturore-artistike në rrafsh kombëtar e cila sublimohet në veprimtarinë e bujshme prej disa dekadave të mjeshtrit të madh të këngës shqipe, Ilir Shaqiri.

Rreth vlerave letrare dhe artistike të librit, folën redaktori Arben Veselaj dhe recensentja Kristina Përkola, të cilët vlerësuan lartë këtë libër për fushën e letërsisë dhe muzikologjisë njëkohësisht. Ndërsa, aktivitetin e përshëndeti edhe rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi.

E nën emocion, autori Korab Shaqiri, tha se ky libër do t'iu shërbejë muzikantëve jo vetëm vendorë por edhe ndërkombëtarë, për të njohur këtë lloj krijimtarie letrare e muzikore që është krijuar në një kohë shumë të rëndësishme për vendin tonë.

Kantautori Ilir Shaqiri, tha se ndjehet i nderuar me rastin e promovimit të këtij libri, dhe se me këtë libër përpos këngëve po vihen në pah edhe ata që i kanë krijuar ato, duke përfshirë autorët e poezisë, muzikës, e orkestracionit.

Ndërsa, në mbrëmje, para një auditori tjetër të zgjedhur, ky libër pati edhe promovimin e dytë – në ambientet e Librarisë “Dukagjini”. Në fjalën e rastit, drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, tha se kjo vepër që botohet me siglën e Institutit tonë, është fryt i një bashkëpunimi kreativ me artistin e madh Ilir Shaqiri. “Ne si Institut po hapemi ndaj vlerave dhe prurjeve të krijuesve dhe autorëve që kanë shënuar epokën e rizgjimit kombëtar të shqiptarëve, ku kënga ishte leva e fuqishme e ngritjes morale të kombit tonë”, u shpreh Asani.

Edhe gjatë promovimit në Librarinë “Dukagjini”, morën pjesë artistë, shkrimtarë dhe figura tjera publike.

Ky libër iu bë dhuratë nga biri i tij Korabi, këngëtarit të madh Ilir Shaqiri, pikërisht për ditëlindjen e tij.

Në Shkup-Prishtinë-Tiranë, 100-vjetori i kryeministrit të Hasan Prishtinës



Shkup-Prishtinë-Tiranë – Në tri kryeqendrat shqiptare Shkup – Prishtinë – Tiranë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë në Tiranë, në bashkëpunim me Mehmet Prishtinën, më 6 dhe 7 dhjetor 2021, e shënuan 100-vjetorin e Hasan Prishtinës si Kryeministër i Shqipërisë.

Aktiviteti kryesor ishte ekspozita e përbashkët me temë “Hasan Prishtina në dokumentet arkivore”, e cila fillimisht u prezantua në ambientet e Ministrisë për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive në Shkup, ku mori pjesë edhe zëvendëskryeministri i Parë i Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi.

Ekspozita në fjalë u prezantua edhe në galerinë e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në Prishtinë, me pjesëmarrjen aktivistëve dhe familjeve të shquara atdhetare nga Kosova. Fjalë rasti patën drejtori i Institutit, Skender Asani, drejtori i Arkivave shqiptare Ardit Bido, Mehmet Prishtina, etj. Ata paraqitën

dromca nga jeta dhe veprimtaria e madhe kombëtare e kryeministrit të parë të Shqipërisë – Hasan Prishtina, i cili vinte nga trojet shqiptare që kishin mbetur jashtë kufijve artificial të Shqipërisë.

Ndërsa, më 7 dhjetor, aktiviteti u shtri në Muzeun Historik Kombëtar të Republikës së Shqipërisë në Tiranë, e cila drejtohet nga studiuesi Dorian Koçi, ku edhe u prezantua kjo ekspozitë në prani të personave eminentë dhe mediave të shumta shqiptare.

Njëkohësisht, gjatë këtij eventi në Tiranë u nënshkrua edhe një aneks marrëveshje ndaj Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup (nënshkruar më 15.12.2017 në Pogradec). Aneks marrëveshja e nënshkruar mes drejtorëve Bido dhe Asani, parasheh që të dyja palët të bashkëpunojnë në realizimin e projekteve hulumtuese disavjeçare, si: “Historia e trevave lindore shqiptare” dhe “Zhvillimet kulturore e historike të shqiptarëve të Maqedonisë gjatë shekullit XIX-XX”, të cilat udhëhiqen nga ITShKSh–Shkup.

Ndryshe, atdhetari Hasan Prishtina ishte kryeministri i tetë me radhë i shtetit shqiptar, në kohë të turbullta të historisë, i cili në këtë post qëndroi nga 7 deri më 12 dhjetor të vitit 1921.

Ekspozitë dhe 100 libra shqipe të Institutit për Ulqinin



Ulqin – Sot Më 14 dhjetor, në Ulqin u zhvilluan dy aktivitete kulturore në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të Hasan Prishtinës – Kryeministër i 8-të i Shqipërisë londineze.

Bashkë me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe z. Mehmet Prishtinën, u hap ekspozita me fotografi dhe dokumente nga jeta dhe vepra e Hasan Prishtinës. Ndërsa njëkohësisht, ITShKSh nga Shkupi i dhuroi librarisë së qytetit të Ulqinit 100 tituj veprash nga fondi i vet botues.

Drejtori i Institutit, Skender Asani, theksoi rëndësinë që vëmendja e komunitetit shkencor dhe kulturor shqiptar duhet të përqendrohet edhe në pjesët periferike të trungut shqiptar, siç është Ulqini, ku nevoja për ushqim shpirtëror është më e madhe se çkado tjetër.

Mikpritës i këtyre aktiviteteve ishte Këshilli Nacional i Shqiptarëve të Malit të Zi, i udhëhequr nga z. Faik Nikaj.

Këto aktivitete zgjuan vëmendjen e mediave dhe të intelektualëve të Ulqinit, kurse bashkëpunimi në mes të Shkupit dhe Ulqinit do të thellohet në fushat e albanologjisë dhe kulturologjisë.

U nënshkrua strategjia e re e bashkëpunimit të tri qendrave albanologjike



Tiranë – Pas disa konsultimeve paraprake që u bënë në Shkodër, Prishtinë dhe Shkup, më 16 dhjetor në Tiranë u nënshkrua memorandumi i ri i bashkëpunimit mes qendrave albanologjike të Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit. Kështu, në aktin e nënshkrimit të Strategjisë së bashkëpunimit, hodhën firmat e tyre drejtori i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë – Luan Përzhita, drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës – Hysen Matoshi dhe drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup – Skender Asani.

Ky memorandum erdhi si një nevojë e bashkërendimit të aktiviteteve të këtyre tri qendrave kryesore albanologjike në rajon, të cilat zotohen për një varg angazhimesh të përbashkëta në fushën e shkencave albanologjike.

Drejtori i ITShKSh, Skender Asani, tha se Instituti ynë do të jetë bartëse kryesore e projekteve mbi historinë dhe identitetin kombëtar në trevat lindore

shqiptare. “Me këtë, Shkupit po ia rikthejmë kuptimin dhe lavdinë e dikurshme, duke integruar albanologjisë shqiptare në një strategji të re bashkëpunimi. Shpresojmë që tash e në të ardhmen shkenca dhe kultura t’i prijë politikës me projekte integruese në botën shqiptare”, tha Asani.

“Ne si ITShKSh po integrohemi në këtë strategji bashkëpunimi me një histori të pasur suksesesh dhe shpresojmë që përvojën që do ta sjellim, do të jetë e barasvlershme me pritjet që ne i kemi nga qendrat albanologjike në Tiranë dhe në Prishtinë, që edhe përvojat e tyre të mbindërtohen në strategjinë tonë të përbashkët. Shkupi historikisht ka qenë jo vetëm një qytet i udhëkryqeve dhe civilizimeve, por ka qenë edhe një organ tepër vital në trupin e madh të etnisë shqiptare me shekuj të tërë. Sa herë që erërat e sërta preknin këtë organ, efektet anësore arrinin edhe në pjesët tjera të etnisë sonë, prandaj Shkupi bashkë me Manastirin, për një kohë bukur të gjatë luajti rolin e piemontit shpirtëror të shqiptarëve”, u shpreh Asani.

Ndryshe, Akademia e Studimeve Albanologjike e Tiranës, nga 15 deri më 17 dhjetor organizoi edicionin e XII-të të “Ditëve të Albanologjisë”, me temën boshte: “Albanologjia e mijëvjeçarit të ri”, me pjesëmarrës të shumë studiuesve të albanologjisë nga e mbarë bota.

Krishtlindjet kremtohen shqip edhe në Shkup



Shkup – Festa e Krishtlindjeve është një nga kremtet më të rëndësishme në kalendarin festave të krishtera. Ajo kremtohet dhe festohet çdo 25 dhjetor dhe në të kujtohet lindja e Jezu Krishtit. Pas Pashkëve është festa më e rëndësishme për të krishterët. Por përveç anës shpirtërore e fetare, ajo vjen në mbarë botën si një nga festat më të bukura dhe më të pëlqyera nga të gjithë. Veç kësaj, kjo festë lidhet edhe me një nga figurat më emblematike dhe më planetare, emrin e së cilës e mban edhe Departamenti i trashëgimisë së Gonxhe Bojaxhiut – Nënë Tereza në kuadër të Institutit. Prandaj, ITShKSh në Shkup është përcaktuar që prej sivjet ta shënojë këtë ditë dhe ta bëjë një festë tradicionale në kalendarin e ngjarjeve që do të përmbyllin vitin.

Më 23 dhjetor, ITShKSh-ja organizoi një pritje solemne edhe për të nderuar kujtimin ndaj të gjitha atyre familjeve fisnike dhe personaliteteve shqiptare katolike të Shkupit, përfshirë edhe udhëheqësit shpirtëror siç ishin: Pjetër Bogdani, Ndue Bytyçi, Lazër Mjeda, Zef Rama, Gaspër Gjini etj., të cilët me kontributin e tyre emancipues ishin vertikalka shpirtërore e këtij kryeqyteti dardan.

Skender Asani, drejtor i ITShKSh-së theksoi se është një kënaqësi që po organizohet kjo ceremoni solemne festën e Krishtlindjeve, por edhe për të kujtuar një traditë që dikur ishte pjesë e jetës sonë urbane këtu në Shkupin e Pjetër Bogdanit, Nënë Terezës e Hasan Prishtinës.

“Më vjen shumë mirë që ITShKSh sivjet, dhe besoj edhe në vitet në vijim, po bëhet një pikëtakim i ngrohtë i njerëzve që duan të jenë pranë njeri tjetrit të frymëzuar edhe nga dashuria për Jezu Krishtin, por edhe për të reflektuar mbi mundësitë tona që për një çast të lëmë mënjanë meritë, urrejtjet dhe hatërmbejtjet në favor të një energjie përbashkuese midis atyre që duan të jetojnë dinjitetshëm në këtë botë të trazuar nga sfidat e shumta që po na godasin”, nënvizoi Asani.

Në kremtimin e Krishtlindjeve në ITSHKSH ishte i pranishëm edhe Don Lush Gjergji nga Ipeshkvia e Kosovës. Ai përgëzoi ITSHKSH-në për iniciativën që 23 dhjetori të jetë ditë tradicionale e kremtimit të Krishtlindjeve dhe vuri në dukje nevojë për të qenë bashkë në ide e projekte që sjellin progres për të gjithë njerëzit.

Intelektualja dhe diplomatja Adelina Marku pasi shprehu mbështetjen për një nismë të tillë tha se nuk kishte pasur shumë njohuri për familjet katolike shqiptare të Shkupit, por për to kishte mësuar shumë nga kërkimet e ITShKSh-së. “Mbamendjen e kam që nga fëmijëria, konkretisht nga trashëgimia kulturore e familjes. Mund të flas për origjinën e mbiemrit tim që është i krishterë dhe shqiptarë. Fëmijëria ime ka një kujtesë të strukturuar mirë për atë që unë sot e quaj liri origjine, fetare e kulturore. ITShKSh do të ishte mirë që të vazhdojë të fokusohet në afirmimin e trashëgimisë sonë kulturore, duke filluar me ndriçimin e të kaluarës së Kishës Mbigur (si Bigorksi) në rrethin e Dibrës dhe antropologjinë e varreve të fisit Marku në fshatin Bohmovë, varre këto që flasin për larushinë tonë fetare, që mbajnë mbishkrime myslimane kurse kanë një arkitektoni të krishterë”, tha Marku.

Në këtë aktivitet foli edhe gazetarja Dijana Toska, e cila u përqendrua në madhësinë planetare të Nënë Terezës – kësaj gruaje me shpirt të madh. Sipas saj, Nënë Tereza nuk e kërkoi lavdinë, por atë ia dhanë të varfrit e saj. Ajo ndërmjetësoi një armëpushim midis ushtrisë izraelite dhe guerilëve palestinez për të shpëtuar 37 fëmijë të bllokuar në një spital dhe mori epitelin e gjeneralit të paqes, ajo ndërtoi Shanti Nagarin, qytetin e paqes, u dekorua me çmimet më prestigjioze në botë për promovimin e njerëzimit, paqes dhe

vëllazërimin midis popujve, u shpall Doktor Nderi, mori edhe Çmimin Nobel për Paqë. Poezitë e saja janë vetë paqja në botë, janë Kombet e Bashkuara që i japin dritë unit universal”, nënvizoi Toska.

Këtë aktivitet e nderoi edhe kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut, Reisul ulema hfz. Shaqir Fetahu, si dhe personalitete tjera të jetës publike.

Përkujtohet jeta dhe vepra e historianit Naim Halimi



Shkup – Në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më 27 dhjetor u mbajt një tubim përkujtimor në nderim të jetës dhe veprës së historianit prof. dr. Naim Halimi, i cili kohë më parë u nda nga jeta në moshën 66-vjeçare.

Udhëheqësja e tubimit, Shejnaze Ajdini – Murtezi, paraqiti një jetëshkrim të prof. dr. Naim Halimit, nga fshati Shtrazë i Kumanovës, doktor i shkencave historike. Ai disa vjet punoi në arsimin fillor në Kumanovë, ndërsa pas doktorimit ishte ligjërues dhe prorektor në Universitetin e Tetovës. Që nga viti 2009 e deri në fund të jetës punoi në ITShKSh – Shkup, në departamentin e Historisë, ku mori pjesë në shumë konferenca shkencore dhe botoi disa libra. Viteve të fundit ishte angazhuar si ligjërues edhe në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Drejtori i ITShKSh-së, Skender Asani, vuri në pah punën dhe angazhimin e madh të prof. Naimit në zhvillimin dhe konsolidimin e Institutit, në momentet kur ky institucion kishte më së shumti nevojë, në hapat e tij të parë.

Më pas një referat e paraqiti kolegu shumëvjeçar dhe bashkëveprimtar i afërt prof. Naimit në katedrën e historisë së Universitetit të Tetovës, prof. dr. Zeqirja Idrizi.


Evokime kujtimesh pati edhe Etem Xheladini, kolegë i punës në Sh.F. “Naim Frashëri” në Kumanovë dhe bashkëveprimtar i pandashëm në disa dekada me prof. Naimin, jo vetëm në shkollë, por edhe duke kontribuar pareshtur edhe në sektorin joqeveritar. Po ashtu fjalë rasti pati edhe kolegu Zeqirja Ibrahimimi – bashkëpunëtor i lartë shkencor i Institutit.


Një referat paraqiti edhe prof. dr. Sevdail Demiri – kryetar i Këshillit të ITShKSh-së ku ishte anëtar edhe vetë prof. Naimi, si kolegë dhe bashkëpunëtor i ngushtë në Departamentin e historisë, me të cilin botuan edhe një vepër të përbashkët për trashëgiminë kulturore të trevës së Kumanovës.


Në emër të familjes, të pranishmit i përshëndeti dhe i falënderoi Mirlinda Halimi – e bija e prof. Naim Halimit, inspektore e farmacisë. Ndërsa, drejtori i Instituti, Skender Asani, i ndau Mirënjohje post mortum Prof. dr. Naim Halimit me motivacion: “Për kontributin e veçantë në sferën e arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare. Për konsolidimin dhe zhvillimin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup”. Plaketën e mirënjohjes e pranoi i biri Jeton Halimi – magjistër i historisë.


Naim Halimi është autor i botimeve shkencore, si: “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në trevën e Karadakut (1908-1912)”, Kumanovë, 2001; “Studime historike dhe etnologjike në trojet tona etnike”, ITSHKSH, Shkup, 2017, dhe “Thesare kulturore dhe natyrore të trevës së Kumanovës”, në bashkautorësi me Sevdail Demirin, ITSHKSH, Shkup, 2019. Në dorëshkrim i pati edhe disa vepra të rëndësishme të historiografisë, si: “Historia e popullsisë së Kumanovës (1600-2000) – disa personalitete të shquara shqiptare”; “Shpërnguljet e shqiptarëve nga Kumanova”, “Shqiptarët e Maqedonisë në vitet e demokracisë”, monografi për Shtrazën, etj.


BOTIMET E VITIT 2021













INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE
TË SHQIPTARËVE – SHKUP

KALENDARI ALBANOLOGJIK -IV-
(Përmbledhje e aktiviteteve të vitit 2021)

Përgjegjës i botimit: Sevdail Demiri

Redaktore gjuhësore: Florentina Fetahi

Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print - Shkup

Tirazhi: 500 copë

Ky libër botohet me vendimin e Këshillit të ITShKSh–Shkup, nr. 0201-33/2, të datës 29.01.2021, si pjesë e programit të punës së Institutit për vitin 2021.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски",
Скопје

001.32:316.7(=18:497.7)"2021"

KALENDARI albanologjik 4 : (përmbledhje e aktiviteteve të vitit
2021) / [përgatiti për botim Sevdail Demiri]. - Shkup : Instituti i
trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2022. - 160 стр. :
фотографии ; 25 см

ISBN 978-608-4897-50-7

а) Институт за духовно и културно наследство на албанците (Скопје) --
Активности -- 2021